



Republika e Kosovës-Republika Kosova-Republic of Kosovo
Autoriteti Rregullativ i Hekurudhave
Regulativni Autoritet Železnica
Railway Regulatory Authority



Raport Vjetor 2016



Autoriteti Rregullativ i Hekurudhave; Rr.Rrustem Statovci nr.29, Prishtinë; Tel:038 220 040; Fax:038 22 33 44;
web:www.arh-ks.org



Të arriturat e Autoritetit Rregullativ të Hekurudhave për vitin 2016

Të arriturat e Autoritetit Rregullativ të Hekurudhave për vitin 2016



Përmbajtja

1.	PËRMBAJTJA.....	3
	SHKURTESAT.....	6
	PËRMBLEDHJA EKZEKUTIVE.....	8
	KORNIZA LIGJORE.....	11
	0.1. Baza ekzistuese ligjore që rregullon ARH-në dhe fusheveprimi i tij.....	11
	0.2. Përmirësimi i bazës ligjore në periudhën raportuese.....	12
	0.3. Vështirësitë ligjore që ka hasur ARH në përmbushjen e misionit të vet.....	12
1.	PËRSHKRIMI I INSTITUCIONIT.....	13
	1.1. Misioni/Vizioni	13
	1.2. Kompetencat e ARH-së sipas Ligjit.....	14
2.	ORGANIZIMI INSTITUCIONAL	15
	2.1. Struktura organizative e ARH-së	15
	2.1.1. Bordi mbikëqyrës i ARH-së.....	17
	2.1.1.1. Mandati.....	17
	2.1.1.2. Kompetencat.....	17
	2.1.1.3. Funksionalizimi.....	17
	2.1.2. Ekzekutivi.....	17
	2.1.2.1. Drejtori i Përgjithshëm i ARH-së.....	18
	2.1.2.2. Menaxhmenti i mesëm.....	18
	2.1.2.3. Burimet njerëzore.....	18
	2.1.2.3.1. Numri i punëtorve dhe nevojat për punëtor të rinj.....	18
	2.1.2.3.2. Pagat e personelit të ARH-së.....	18
	2.2. Sistemi për menaxhim të cilësisë.....	19
	2.2.1. Të përgjithshme.....	19
	2.2.2. Sistemi dhe struktura e dokumenteve të cilësisë.....	19
	2.2.3. Standardet e cilësisë.....	19
	2.2.4. Politika e cilësisë.....	20
	2.2.5. Manuali i cilësisë.....	20
	2.3. Trajnimet.....	20
	2.4. Asetet.....	24
	2.4.1. Lokacioni i ARH-së.....	24
3.	PËRSHKRIMI I FUSHËS QË E MBULON ARH.....	25
	3.1. Përshkrimi i shkurtër i fushës që mbulon ARH.....	25
	3.2. Planifikimi dhe realizimi i punës 2016.....	25
4.	PUNA GJATË VITIT RAPORTUESE.....	29
	4.1. DEPARTAMENTI I LICENCIMI.....	29
	4.1.1. Detyrat dhe përgjegjësitë.....	29
	4.1.2. Aktivitetet e Departamentit të Licencimit.....	29
	4.1.2.1. Liberalizimi i tregut.....	29
	4.1.2.2. Licencimi i Makinistëve.....	31
	4.1.2.3. Inspektimi i makinistëve.....	32
	4.1.2.4. Regjistri i Licencave.....	32
	4.1.2.5. Monitorimi i Licencave.....	33
	4.2. DEPARTAMENTI LIGJOR.....	34
	4.2.1. Detyrat dhe përgjegjësitë e Departamentit Ligjor.....	34
	4.2.2. Aktivitetet e Departamentit Ligjor.....	34
	4.3. DEPARTAMENTI I SIGURISË.....	37



4.3.1.	Detyrat dhe përgjegjësitë.....	37
4.3.2.	Aktivitetet e Departamentit të Sigurisë.....	37
4.3.2.1.	Përgatitja e raportit vjetor të Sigurisë.....	38
4.3.2.2.	Përgatitja e një pjese të legjislacionit sekondar.....	38
4.3.2.3.	Shqyrtimi i aplikacionit për dhënien e certifikatës së sigurisë për operatorin privat Railtrans dhe organizimi i misionit të ekspertit për shqyrtimin e aplikacionit për certifikatë të sigurisë të kompanisë Railtrans.....	39
4.3.2.4.	Shqyrtimi i aplikacioneve për dhënien e autorizimit për futjen në shërbim të mjeteve lëvizëse të kompanive Infrakos, Trainkos dhe Railtrans.....	42
4.3.2.5.	Organizimi i misionit të eksperteve për procedurat e dhënies së autorizimit për futjen në shërbim të mjeteve lëvizëse dhe infrastrukturës.....	43
4.3.2.6.	Përgatitja e Raportit Vjetor të Sigurisë për vitin 2015.....	43
4.3.2.7.	Inspektimi i infrastrukturës hekurudhore në menaxhim të Infrakos-it.....	45
4.3.2.8.	Inspektimi i mjeteve lëvizëse hekurudhore në menaxhim të Infrakos-it.....	45
4.3.2.9.	Inspektimi i mjeteve lëvizëse hekurudhore në menaxhim të Trainkos-it.....	46
4.3.2.10.	Inspektimi i mjeteve lëvizëse hekurudhore në menaxhim të Ferronikelit.....	57
4.3.2.11.	Pjesëmarrja në trajnime të organizuara nga institucionet vendore dhe nga partnerët evropian.....	60
4.4.	DEPARTAMENTI I INTEROPERABILITETIT	61
4.4.1.	Detyrat dhe përgjegjësitë.....	61
4.4.2.	Aktivitetet e Departamentit të Interoperabilitetit.....	62
4.4.2.1.	Mjetet hekurudhore me pronësi të pa definuar.....	62
4.4.2.1.1.	Kontrollimi i regjistrit MPPD dhe regjistrit NVR.....	62
4.4.2.1.2.	Procesi i inspektimit të mjeteve me pronësi të pa definuar.....	63
4.4.2.1.3.	Shënjimi i numrit identifikues rendor.....	64
4.4.2.2.	Regjistri nacional i mjeteve lëvizëse hekurudhore.....	64
4.4.2.3.	Azhurnimi i regjistrit të mjeteve lëvizëse NVR.....	65
4.4.2.4.	Shënjëzimi i mbajtësit të mjetit lëvizës VKM.....	66
4.4.2.5.	Azhurnimi i marrëveshjeve ndërkombëtare.....	66
4.4.2.6.	Misioni i Eksperteve për Infrastrukturë organizuar nga TAIEK.....	69
4.4.2.7.	Libri i rregullave për makinistë.....	70
4.4.2.8.	Specifikimet Teknike për Interoperabilitet STI.....	70
4.4.2.9.	Specifikacionet Teknike për Interoperabilitet STI.....	70
4.4.2.9.1.	STI për nënsistemin e infrastrukturës.....	70
4.4.2.9.2.	Specifikacionet Teknike për Interoperabilitet për nënsistemin e operimit dhe menaxhimit të trafikut.....	71
4.4.2.10.	Inspektimi i Regjistrit të mjeteve lëvizëse.....	75
4.4.2.11.	Shënim i Numrit Evropian në Mjetin Lëvizës.....	75
4.4.3.	Identifikimi i sfidave të Departamentit për Interoperabilitet.....	76
4.4.4.	Objektivat e Departamentit të Interoperabilitetit.....	78
4.5.	DEPARTAMENTI I RREGULLIMIT TË TREGUT	78
4.5.1.	Detyrat dhe Përgjegjësitë.....	78
4.5.2.	Aktivitetet e Departamentit të Rregullimit të Tregut.....	79
4.5.2.1.	Ekspozeu i rrjetit.....	79
4.5.2.2.	Procesi i konsultimeve për ekspozen e rrjetit.....	79
4.5.2.3.	Shqyrtimi i ankesave nga operatorët hekurudhor.....	80
4.5.2.3.1.	Ankesa e Trainkos-it.....	80
4.5.2.3.2.	Ankesa e Railtrans-it.....	81
4.5.2.4.	Monitorimi i Tregut.....	82
4.5.2.5.	Workshopi për Rregullimin e Tregut Hekurudhor.....	82
4.5.2.6.	Rekomandimi i Departamentit të Rregullimit të Tregut për Ekspozen e Rrjetit.....	83
4.6.	DEPARTAMENTI I ADMINISTRATËS	85
4.6.1.	Detyrat dhe përgjegjësitë.....	85
4.6.2.	Aktivitetet e Departamentit të Administratës.....	85
4.7.	DEPARTAMENTI I FINANCAVE	87
4.7.1.	Detyrat dhe përgjegjësitë.....	87
4.7.2.	Aktivitetet e Departamentit të Financave.....	87
4.7.2.1.	Pasqyrat financiare.....	87
4.7.2.2.	Detajet e Shpenzimeve nga kategoritë e Pagat, Mallra dhe Shërbime, Shpenzime Komunale dhe Shpenzime Kapitale për vitin 2016 (Janar- Dhjetor 2016).....	92



4.8.	DIVIZIONI I PROKURIMIT.....	95
4.8.1.	Detyrat dhe përgjegjësitë.....	95
4.8.2.	Aktivitetet e Divizionit të Prokurimit.....	95
4.8.3.	Aktivitetet tjera në kuadër të përgjegjësisë dhe për institucionin e ARH-së.....	96
4.8.3.1.	Komunikimi me publikun dhe qasja në dokumentat publike.....	96
4.8.3.2.	Detyrat dhe përgjegjësitë.....	97
5.	RAPORTIMI RRETH ADRESIMIT TË REKOMANDIMEVE TË ZYRES SË AUDITORIT TË PËRGJITHSHËM.....	100
6.	SHTOJCAT.....	101
	SHTOJCË I.....	101
6.1.1.	Korniza ligjore e BE-së e aplikueshme për sektorin e Hekurudhave.....	101
6.2.	SHTOJCË II.....	102
6.2.1.	Përshkrimi i Hekurudhave të Kosovës.....	102
6.2.2.	Harta e Hekurudhave të Kosovës.....	103
6.3.	SHTOJCË III.....	104
6.4.	SHTOJCË IV	104
6.5.	SHTOJCË V.....	104



Shkurtesat

ARH	Autoriteti Rregullativ i Hekurudhave
MI	Ministria e Infrastrukturës
MF	Ministria e Financave
INFRAKOS	Infrastruktura e Hekurudhave të Kosovës
TRAINKOS	Operimi me Trena të Hekurudhave të Kosovës
RAILTRANS	Operator për transport të mallrave
SH.A	Shoqëria Aksionare
IRG-Rail	Indenpedent Regulatorys Group-Rail
BE	Bashkimi Evropian
AQP	Agjencia Qendrore e Prokurimit
KRPP	Komisioni rregullativ i prokurimit publik
BKK	Buxheti i Konsoliduar i Kosovës
OB	Organizatrat Buxhetore
ERA	European Union Agency for Railway (Agjensioni i Bashkimit Evropian i Hekurudhave)
SEETO	South-East Europe Transport Observatory (Observatori i Transportit të Evropës Juglindore)
OTIF	Organisation intergouvernementale pour les Transports Internationaux Ferroviaires (Organizimi Qeveritar për Transportet Ndërkombëtare Hekurudhore)
IPA	Instrumenti për Ndihmën e Para-Anëtarësimit
SMS	Safety Managment Sistem (Sistemi i Menaxhimit të Sigurisë)
NVR	National Vehicle Register (Regjistri Nacional i Mjeteve Lëvizëse)
UIC	International Union of Railway (Unioni Nderkombëtar i Hekurudhave)
ECM	Entity in Charge of Maintenance (Entiteti Përgjegjës për Mirembajtje)
CSM	Common Safety Method (Metodat e Përbashkëta të Sigurisë)
EC	European Comision (Komisioni Evropian)
TAIEX	Technical Assistance and Information Exchange instrument (Asistenca Teknike dhe Shkëmbimi i Informacionit)
TCDD	Türkiye Cumhuriyeti Devlet Demiryolları (Hekurudhat Shtetërore të Turqisë)
STI	Specifikimet Teknike për Interoperabilitet (Technical Specification for Interoperability)
NVR	Nacional Vehicle Register (Regjistri Nacional i Mjeteve Lëvizëse)
VKM	Vehicle Keeper Marking (Shenjëzimi i Mbajtjes të Mjetit Lëvizës)
CSI	Common Safety Indicator (Indikatorët e Përbashkëta të Sigurisë)



NSA	Nacional Safety Authority
KRPP	Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik
AQP	Agjensioni Qendror i Prokurimit
OSHP	Organi Shqyrtues i Prokurimit
NH	Ndërmarrje hekurudhore
HK	Hekurudhat e Kosovës



Përmbledhje ekzekutive



Ky është Raporti Vjetor me radhë që nxjerr menaxhmenti i ARH-së, si një rregullator i pavarur. Përmes këtij dokumenti prezantojmë të arriturat e ARH brenda periudhës janar-dhjetor 2016, me qëllim që të ofrojmë një pasqyrë të zhvillimeve në këtë fushë. Ai përshkruan gjerësisht aktivitetet e ARH-se në hallkat kryesore të funksionimit të saj (Licencim, Siguri, Interoperabilitet dhe Rregullim të tregut), përfshirë dhe sfidat përcjellëse përgjatë këtij viti.

ARH është themeluar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës si organ i pavarur, përgjegjës për rregullimin, mbikëqyrjen, organizimin e sektorit hekurudhor në Republikën e Kosovës. ARH ofron shërbime cilësore të sigurta, transparente dhe jo diskriminuese për ndërmarrjet hekurudhore dhe menaxherin e infrastrukturës në sektorin hekurudhor në Republikën e Kosovës dhe kompetencave të tjera të cilat i jepen në bazë të Ligjit Nr. 04/L-063 për Hekurudhat e Republikës së Kosovës i cili është në përputhje të plotë me legjislacionin dhe direktivat në fuqi të BE-së.

Raporti në tërësi ofron informacion mbi: bazën ligjore, përshkrimin dhe organizimin institucional, përshkrimin e fushës që mbulon ARH, punën gjatë vitit paraprak, raportin financiar, raportin rreth rekomandimeve të zyrës së auditorit të përgjithshëm si dhe anekset.

Duke qenë se ARH vepron si organ për: Licencim, Siguri, Interoperabilitet dhe Rregullim të Tregut, edhe përmbajtja e raportit elaboron me specifikisht progresin dhe arritjen e objektivave të saj kryesisht në këto fusha. Edhe gjatë vitit 2016 ARH ka vazhduar të ushtrojë funksionet e veta rregullatore në katër fusha kryesore:

Licencimi: Si organ përgjegjës për lëshimin e licencave për makinistët, ndërmarrjet hekurudhore si dhe amendamentimin, suspendimin dhe revokimin e këtyre, ka realizuar një sërë aktiviteteve me përkushtim dhe angazhim maksimal si: shqyrtimi i aplikacioneve të reja për licenca të makinistëve, shqyrtimi dhe përgjigja në kërkesat për licence për transport hekurudhor të mallrave, monitorimi i licencave të lëshuara, përfshirë inspektimet për makinistët e licencuar, draftimi i Rregullores për Taksa dhe Gjoha, hartimi i raporteve të veçanta për aktivitetet e



lartcekura, përditësimi i regjistrit të licencave dhe aktivitete të tjera në përputhje me legjislacionin që e rregullon këtë fushe.

Siguria – Organi përgjegjës për sigurinë hekurudhore është krijuar nën mbikëqyrjen e ARH për të siguruar që siguria hekurudhore është mbajtur dhe përmirësuar pas rindërtimit të sistemit hekurudhor në Kosovë. Bazuar në këtë gjithashtu me përkushtim ka realizuar aktivitetet prezantuar si në vijim:

Ka përfunduar procesin e mbikëqyrjes së implementimit të Sistemit për Menaxhimin e Sigurisë (SMS) nga ana e operatorit me trena Trainkos dhe menaxherit të infrastrukturës Infrakos, përgatitja e Raportit Vjetor të Sigurisë për vitin 2015, janë lëshuar autorizimet për futjen në shërbim të mjeteve lëvizëse hekurudhore, realizimet e inspektimeve të të gjitha linjave hekurudhore të cilat menaxhohen nga Infrakos si dhe inspektimet e të gjitha mjeteve lëvizëse në pronësi të Trainkos-it dhe Ferronikel-it përcjellur me raportet me rekomandime të sigurisë. Gjithashtu gjatë vitit 2016 për herë të parë ka lëshuar certifikatën e sigurisë për operatorin privat Railtrans, si dhe aktivitete të tjera që parashihen me Ligjin për Hekurudha.

Siguria është një vlerë thelbësore dhe çelësi për suksesin e rrjetit hekurudhor.

Interoperabiliteti: Organ i pavarur, përgjegjës në Kosovë për të siguruar që sektori hekurudhor përputhet me kërkesat për interoperabilitet, siç janë definuar nga direktivat dhe rregulloret e BE-së, me qëllim që Kosova të jetë pjesë e zonës Evropiane të interoperabilitetit hekurudhor. Si rezultat i përgjegjësisë të lartë dhe angazhimit maksimal paraqesim arrijtjet në vazhdim të këtij raporti:

Gjatë vitit 2016 është realizuar regjistrimi dhe modifikimi e mjeteve lëvizëse nga menaxheri i infrastrukturës dhe ndërmarrjet hekurudhore, inspektimi i regjistrimit të të gjitha mjeteve lëvizëse hekurudhore të cilat janë të regjistruara që nga 2012 deri në fund të vitit 2016 përcjellur me raportet e inspektimeve NVR. Gjithashtu është realizuar edhe inspektimi i regjistrit të mjeteve me pronësi të pa definuar, regjistrimi i kodit të VKM-së për operatorin privat Railtrans, azhurnimi i listës së marrëveshjeve ndërkombëtare dhe aktivitete të tjera paraqitur në pjesën e dedikuar për fushën e Interoperabilitetit.

Megjithatë arritja e Interoperabilitetit në kuptimin e kompleksitetit të saj mbetet edhe me tej sfiduese për ARH-në. Ne jemi përqendruar në përpjekjet tona për krijimin kushteve përmes se cilave mund të arrihet interoperabiliteti.

Rregullimi i Tregut Hekurudhor: Organ përgjegjës për të siguruar kushtet për hapjen e tregut hekurudhor në Kosovë, ka zhvilluar aktivitete të cilat vlerësohen në këtë fushë:



Organizimi i procesit të konsultimit për Ekspozeun e Rrjetit duke siguruar që Ekspozeu i Rrjetit të mos përmbajë klauzola diskriminuese jo transparente, shqyrtimi i ankesave të pranuara, sigurimi që qasja në binarë, stacione, depot e operatorëve që plotësojnë kushtet e domosdoshme të jetë e drejtë transparente dhe jo diskriminuese. Puna dhe angazhimi i rregullimit të tregut ka qenë e fokusuar në gatishmërinë e vazhdueshme që të merren masa kur është e nevojshme për të arritur këtë. Gjithashtu është bërë edhe monitorimi i tregut hekurudhor si dhe është përgatitur Raporti Vjetor i Monitorimit të Tregut dhe është dërguar në IRG-Rail. Rregullimi Tregut ka bashkëpunuar me organet e tjera rregullative të tregut hekurudhor, veçmas sa i përket Marrëveshjes së Komunitetit të Transportit ndërmjet partnerëve të SEETO-së dhe IRG - Rail në mënyrë që të lehtësohen dhe koordinohen kushtet rregullative të tregut hekurudhor me vendet e tjera.

Në rrafshin normativ, në pajtim me planin e punës për vitin 2016, ARH-ja ka përgatitur akte nënligjore për zbatimin të Ligjit për Hekurudha dhe në përputhje me standardet BE-së në fushën e hekurudhave.

ARH gjatë vitit 2016 ka përfituar tri projekte nga programet e asistencës teknike të përkrahura nga Komisioni Evropian përmes instrumentit TAIEX: „Punëtorja për rregullimin e tregut hekurudhor,, në nivel rajonal „Misioni i eksperteve për dhënien e autorizimit për futje në shërbim të mjeteve lëvizëse dhe infrastrukturës,, si dhe „Misioni i eksperteve për transpozimin dhe implementimin e Specifikacioneve Teknike për Interoperabilitet për nënsistemin e Infrastrukturës,,

Zyra e Auditorit të Përgjithshëm të Kosovës (ZAP) gjatë qershorit të vitit 2016 ka publikuar Raportin e Auditimit (nr. dokumenti 24.22.1-2015-08) për pasqyrat financiare të ARH-së për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2015. ZAP si konkluzion të përgjithshëm ka paraqit se disa aspekte të qeverisjes brenda ARH-së mund të përmirësohen,veçanërisht në lidhje me menaxhimin e rrezikut dhe cilësinë e raportimit menaxherial.

Ndarjet Buxhetore fillestare të ARH-së për vitin 2016 ishin 293,623.00 €, mirëpo më vonë sipas nevojave të nivelit qendror ky buxhet ka pasur shkurtime buxhetore ku si buxhet final pas shkurtimeve kemi pasur 203,348.52 €.

Gjatë këtij viti ARH ka shpenzuar 201,251.50 €, që do të thotë se është realizuar 98.9 % raporti shpenzim-buxhet final (si informatë,shkurtimeve buxhetore janë reflektuar si rezultat i pritjeve në vazhdimësi të aprovimit të Anëtarëve të Bordit i cili veç ndodhi në fundvit),ndërsa gjatë vitit 2017 ARH pritet të realizojë edhe të hyra nga taksat dhe gjobat të parapara sipas Ligjit të Hekurudhave.



Objektivat

ARH do të vazhdojë të jetë një rregullator aktiv dhe shumë i rëndësishëm në zhvillimin e sektorit të transportit hekurudhor në vend, duke siguruar vazhdimësinë e angazhimeve të ARH-së edhe për vitet e ardhshme. Jemi të bindur se në sajë të përpjekjeve tona të përbashkëta, për vitin e ardhshëm do të kemi rezultate shumë më të mira në sektorin e transportit hekurudhor në Republikën e Kosovës.

ARH edhe më tej vazhdon të këtë qëllim kryesor "Zhvillimin e një sistemi efikas dhe të sigurt të transportit hekurudhor, të integruar në rajon dhe në rrjetin e BE-së, që promovon zhvillimin ekonomik dhe cilësinë e jetës së qytetarëve".

Me respekt,
Shkelzen Qorri
U.D. Drejtor i Përgjithshëm



Korniza ligjore

ARH është organ i pavarur që rregullon dhe mbikëqyrë sektorin e hekurudhave në përputhje me legjislacionin në fuqi në Kosovë dhe me legjislacionin në fuqi të BE-së, të përshtatshëm për Kosovën në këtë sektor.

2.1. Baza ekzistuese ligjore që rregullon ARH-në

- Ligji për Hekurudhat e Kosovës Nr. 04/L-063
- Rregullore e Brendshme e ARH për Organizimin dhe Funksionimin e Brendshëm dhe Sistemimin e Vendeve të Punës
- Udhëzimi Administrativ Nr. 02/2012 për Licencimin e Ndërmarrjeve Hekurudhore
- Udhëzimi Administrativ Nr. 03/2012 për Licencimin e Menaxherëve të Infrastrukturës
- Udhëzimi Administrativ Nr. 04/2012 për Dhënien e Certifikatës dhe Autorizimit të Sigurisë për Ndërmarrjet Hekurudhore dhe Menaxherët e Infrastrukturës Hekurudhore
- Rregulloren Nr. 01/2012 për Licencimin e Menaxherëve dhe Ndërmarrjeve Hekurudhore
- Rregullore Nr. 03/2012 për Certifikatat e Sigurisë
- Rregullore Nr. 04/2012 për Autorizimin e Sigurisë
- Rregullore Nr. 05/ 2012 për Regjistrin Nacional të Mjeteve Lëvizëse Hekurudhore, dhe
- Rregullore Nr. 06/ 2012 për Regjistrimin e Infrastrukturës.
- Rregulloren Nr. 01/2013 për Ekspozeun e Rrjetit
- Rregulloren Nr. 02/2013 për Licencimin e Makinistëve.
- Rregullore Nr. 01/2014 për Modelin e Deklaratës së Konformitetit për Llojin e Autorizuar të Mjetit Hekurudhor.

SHTOJCË I Korniza ligjore e BE-së e aplikueshme për sektorin e Hekurudhave



2.2. Përmirësimi i bazës ligjore në periudhën raportuese

Gjatë vitit 2016 ARH ka draftuar këto Rregullore:

- Draft Rregullore për të Hyrat dhe Gjobat e ARH-së
- Draft Rregullore për të Drejtat e Udhëtarëve në Transportin Hekurudhor
- Draft Rregullore për Raportimin e Monitorimit të Tregut Hekurudhor
- Draft Rregullore për Ndërtim, Përmirësim, Rinovim, Vlerësim të Konformitetit dhe Autorizimin për Vendosjen në Shërbim të Mjetit Lëvizës, dhe
- Draft Rregullore për Metodën e Përbashkëta të Sigurisë (MPS), për Vlerësim dhe Llogaritje të Rrezikut.

2.3. Vështirësitë ligjore që ka hasur ARH në përmbushjen e misionit të vet

ARH gjatë vitit 2016 ka pasur vështirësi ligjore në përmbushjen e misionit të vet, për faktin se deri më datë: 28.10.2016 nuk ka pasur Bord Mbikëqyrës. Mbështetur në nenin 38 paragrafi 2 të Ligjit për Hekurudhat e Kosovës, Bordi i ARH-së i miraton të gjitha aktet nënligjore të institucionit. Menaxhmenti i ARH-së ka përgatitur disa draft Rregullore që ndërlidhem me punën profesionale të institucionit, të njëjtat nuk kanë hyrë në fuqi për shkak të mungesës së Bordit. Për ARH-në miratimi dhe zbatimi i kornizës ligjore, e cila ka të bëjë me punën profesionale dhe përmbushjen e misionit të institucionit, pamundësohet në mungesë të Bordit.

ARH identifikon dhe raporton vështirësitë për të cilat vlerëson se ndikojnë në zbatimin efektiv të Ligjit të Hekurudhave. Gjatë zbatimit, kemi hasur në disa paqartësi rreth kompetencave ndërinstytucionale, me theks të posaçëm mes Autoritetit Rregullativ të Hekurudhave dhe Ministrisë së Infrastrukturës si dhe mos përputhshmërisë me disa nga Direktivat e Bashkimit Evropian në fushën e transportit hekurudhor.

ARH raporton se deri në këtë periudhë nuk ka pasur ndonjë ndryshim në legjislacion të hekurudhave e cila do të kishte ndikuar në rritjen apo zvogëlimin e efikasitetit të institucionit të ARH-së.



2.3.1. Pengesat ligjore dhe procedurale

Njëra nga vështirësitë me të cilat është përballur ARH gjatë këtij viti është edhe përfundimi i mandatit të Kryeshefit Ekzekutiv më datë: 15.07.2017 dhe pamundësia e marrjes së një vendimi të ri nga ana e Bordit, pasi që akoma ky proces nuk kishte përfunduar nga ana e Kuvendit të Kosovës. Zgjedhja e kësaj çështje ndodhi menjëherë pas konstituimit të Bordit të ri. Kjo rrethanë ka ndikuar edhe në zhvillimet e proceseve në institucion në mungesë të vendimmarrjes kredibile.



Përshkrimi i ARH-së

Autoriteti Rregullativ i Hekurudhave është themeluar në bazë të Ligjit Nr. 03/L-076 dhe ka filluar të funksionoj nga prilli i vitit 2010, ndërsa tani ARH funksionon sipas Ligjit Nr. 04/L-063 për Hekurudhat e Republikës së Kosovës. ARH -ja është organ i pavarur që rregullon dhe mbikëqyrë sektorin e hekurudhave në përputhje me legjislacionin në fuqi në Kosovë dhe me legjislacionin në fuqi të BE-së, të përshtatshëm për Kosovën në këtë sektor. Ky ligj zbatohet për funksionimin, mirëmbajtjen dhe shfrytëzimin e Hekurudhave të Kosovës dhe infrastrukturës së saj, si dhe për të gjitha operimet e trenave që shfrytëzojnë këtë infrastrukturë.

3.1. Misioni/Vizioni

MISIONI

Misioni i ARH-së është rregullimi, mbikëqyrja dhe organizimi i sektorit hekurudhor në Republikën e Kosovës në këto fusha: Licencim, Siguri, Interoperabilitet dhe Rregullim të Tregut dhe kompetencave të tjera të cilat i jepen në bazë të këtij ligji.

VIZIONI

Vizioni i ARH-së është që të ofroj shërbime cilësore dhe të sigurta transparente dhe jo diskriminuese për Ndërmarrjet Hekurudhore dhe Menaxherin e Infrastrukturës në sektorin hekurudhor në Republikën e Kosovës.



3.2. Kompetencat e ARH sipas Ligjit

Sipas Ligjit për Hekurudha, Autoriteti Rregullativ i Hekurudhave rregullon dhe mbikëqyrë këto fusha:

Licencim

Departament i pavarur përgjegjës për lëshimin e licencave për makinistët, ndërmarrjet hekurudhore si dhe amendamentimin, suspendimin dhe revokimin e këtyre

Siguri

Departament i pavarur përgjegjës për sigurinë hekurudhore, për të siguruar që siguria hekurudhore është mbajtur dhe përmirësuar pas rindërtimit të sistemit hekurudhor në Kosovë, gjithashtu përgjegjës për lëshimin, amendamentimin, suspendimin dhe revokimin e Autorizimit të Sigurisë dhe Certifikatës së Sigurisë.

Interoperabilitet

Departament i pavarur, përgjegjës në Kosovë për të siguruar që sektori hekurudhor përputhet me kërkesat për interoperabilitet siç janë definuar nga direktivat dhe rregulloret e BE-së, me qëllim që Kosova të jetë pjesë e zonës Evropiane të interoperabilitetit hekurudhor.

Rregullimi i Tregut

Departament i pavarur përgjegjës për të siguruar kushtet për hapjen e tregut hekurudhor në Kosovë.



Organizimi institucional


4.1. Struktura organizative e ARH-së

Struktura e ARH-së, miratohet nga Bordi dhe përfshinë: Menaxhmentin, Departamentet dhe personelin mbështetës. Struktura organizative e ARH-së në bazë të Ligjit të Hekurudhave dhe Rregullores për Organizimin dhe Funksionimin e Brendshëm dhe Sistemimin e Vendeve të Punës, përbëhet nga:

- a) Bordi Mbikëqyrës;
- b) Drejtori i Përgjithshëm;
- c) Departamenti Ligjor/Licencim;
- d) Departamenti i Sigurisë;
- e) Departamenti i Interoperabilitetit;
- f) Departamenti i Rregullimit Tregut;
- g) Departamenti i Administratës;
- h) Departamenti i Financave;

Në bazë të Rregullores për organizimin dhe funksionimin e brendshëm dhe sistemimin e vendeve të punës figurativisht është paraqitur struktura organizative e ARH-së

Skema organizative e ARH-së





4.2. Bordi mbikëqyrës i ARH-së

Veprimtaria e ARH-së mbikëqyret nga Bordi mbikëqyrës, i zgjedhur nga Kuvendi i Republikës së Kosovës.

Bordi ARH-së përbëhet prej pesë (5) anëtarëve dhe njëri prej tyre zgjidhet Kryesues, anëtari i pestë i Bordit është Drejtori i Përgjithshëm i ARH-së.

Takimet e Bordit drejtohen në pajtim me procedurat e brendshme të miratuara nga Bordi dhe së paku një (1) herë në muaj. Mbledhjet e Bordit nuk mund të zhvillohen nëse nuk ka kuorum. Vendimet e Bordit merren me shumicën e votave. Çdo anëtar i Bordit ka një (1) votë për çdo zgjidhje dhe kur numri i votave në favor të zgjidhjes është i barabartë me numrin e votave kundër, vota e kryesuesit është vendimtare.

4.2.a. Mandati

Kuvendi i emëron katër (4) anëtarë, njëri prej të cilëve emërohet kryesuesi i Bordit të cilët propozohen nga Qeveria me rekomandim të Ministrisë. Çdo anëtar i Bordit emërohet për një mandat pesë vjeçar (5), i cili mund të emërohet më së shumti edhe për një (1) mandat.

4.2.b. Kompetencat

Bordi mbikëqyrës është përgjegjës për mbikëqyrjen dhe shqyrtimin e aktiviteteve dhe vendimeve të ARH-së mbi çështjet administrative, ekzekutive, rregullatore, sic janë: licencimi, siguria, interoperabiliteti si dhe rregullimi tregut dhe aspekteve të menaxhimit financiar, të hyrave dhe shpenzimeve të ARH-së. Bordi i ARH-së, miraton të gjitha aktet nënligjore të departamenteve të cilat janë në kuadër të sajë.

4.2.c. Funksionalizimi

Në muajin tetor të vitit 2016, Kuvendi i Kosovës ka emëruar katër (4) anëtarë të Bordit Mbikëqyrës të ARH-së. Që nga kjo kohë, Bordi Mbikëqyrës i ARH-së është funksional në kryerjen e detyrave dhe përgjegjësi të tij.



4.3. Ekzekutivi

4.3.a. Drejtori i Përgjithshëm i ARH-së

Drejtori i Përgjithshëm është përgjegjës për menaxhimin dhe drejtimin e punëve të përditshme dhe në pajtim me politikat dhe udhëzimet e nxjerra nga Bordi. Drejtori i Përgjithshëm zgjedhet nga Bordi Mbikëqyrës në përputhje me legjislacionin në fuqi për shërbimin civil. Ai që nuk ka të drejtë të shërbejë në Bord nuk do të ketë të drejtë të emërohet as Drejtor i Përgjithshëm.

4.3.b. Menaxhmenti i mesëm

Menaxhmenti i mesëm i ARH-së përbëhet nga Kryesuesit e Departamenteve dhe Menaxherët e zyrave, të cilët janë përgjegjës për veprimtarinë e tyre brenda fushëveprimit dhe kompetencave të tyre të përshkruara në përshkrimet e punës. Drejtori i Përgjithshëm i ngarkon strukturat udhëheqëse me kompetenca të përshkruara sipas rregullores së brendshme dhe mund t'ia delegojë kompetencat e tij apo kompetencat e ARH-së një strukturë apo punonjësi jashtë fushëveprimit të detyrave të kësaj strukture, nëse ai e sheh të nevojshme.

4.3.c. Mandati

Drejtori i Përgjithshëm, është me kontratë punësimi me kohë të caktuar. Zyrtaret që përbëjnë strukturën të ARH-së mbajnë Akte Emërimi me kohë të pacaktuar, ndërsa lloji i emërimit është i karrierës.

4.4. Burimet njerëzore

4.4.a. Numri i punëtorëve

ARH-ja ka 17 punëtorë shërbyes civil të gjithë me Akte Emërimi të karrierës, pa përfshirë katër (4) anëtarët e Bordit të cilët nuk janë shërbyes civil

4.4.b. Nevojat për punëtorë të rinj

ARH ka nevojë për punëtorë të rinj shtesë, në mënyrë që të përmbush mandatin e vet ligjor.



4.4.c. Numri i trajnimeve dhe nëvojat për trajnim

Zyrtaret e ARH –së gjatë vitit 2016 kanë ndjekur trajnime dhe takime të financuara nga donatorët si dhe trajnime të financuara nga buxheti i ARH-së. ARH-ja investon në ngritjen profesionale dhe përditësimin e njohurive të specializuara të personelit të vet, në përputhje me standardet dhe praktikën e rekomanduar ndërkombëtare. Zyrtarët kanë ndjekur trajnimet kryesisht në Autoritetet e Përbashkëta të Hekurudhave, në Institutin Kosovar për Administratë Publike (IKAP), Ministrinë e Administratës Publike dhe Ministrinë e Financave

Konferencat, trajnimet, punëtoritë dhe vizitat studimore janë paraqitur në formë tabelore si në vijim.

4.4.d. Tabela e Stafit të trajnuar dhe lloji i trajnimeve

Tabela 1: Trajnimet, punëtoritë, konferencat gjatë vitit 2016

NR	POZITA	NUMRI I PJESËMARRËSVE	TRAJNIMI	VENDI DHE DATA	INSTITUCIO NI TRAJNUES
1	- Drejtori i Përgjithshëm - Kryesuesi i Departamentit të Sigurisë	2	Konferenca e tretë ndërkombëtare "Hulumtimet në transport dhe transferimi i njohurive në sigurinë rrugore"	Prishtinë 22-23 janar 2016	
2	- Drejtori i Përgjithshëm - Kryesuesi i Departamentit të Sigurisë	2	Grupit punues për përgatitjen e modulit të trajnimit për ERTMS/ETCS	27-31 janar 2016	UIC-Deutsche Bahn
3	Zyrtarja e Administratës	1	Deklarimi i rregullt i Pasurisë	Prishtinë 09 shkurt 2016	AAK
4	- Kryesuesi i Divizionit të Prokurimit, - Zyrtarja Ekzekutive	2	Komunikimi Qeveritar me Publikun	Prishtinë 18-20 shkurt 2016	IKAP
5	- Zyrtari i Lartë i Rregullimit të Tregut - Zyrtarja për Buxhet dhe Financa	2	Menaxhment i Përgjithshëm në temën Sjellje Organizative.	Prishtinë 23 - 24 shkurt 2016	IKAP
6	- Inspektori i Sigurisë - Zyrtarja për Buxhet dhe Financa	2	E-Pasuria	Prishtinë 23 shkurt 2016	MAP
7	Drejtori i Përgjithshëm	1	Takim i Dialogut të Procesit të Stabilizim Asociimit (DPSA) "Infrastruktura" që përfshin sektorët e Mjedisit, Energjisë,	Bruksel 24-27 shkurt 2016	

			Transportit dhe dhe Zhvillimit Rajonal.		
8	Kryesuesi i Departamentit të Sigurisë	1	Vizitë në Drejtorinë e Inspektimit në Durrës.	Shqipëri 24-25 shkurt 2016	
9	- Drejtori i Përgjithshëm, - Kryesuesi i Departamentit të Sigurisë, - Zyrtarja Ekzekutive	3	Eurasia Rail 2016 6th International Rolling Stock, Infrastructure & Logistics	Stamboll 02-06 mars 2016	TCDD
10	- Zyrtari për Interoperabilitet - Asistenti i Departamentit të Sigurisë	2	MICROSOFT VISIO DHE MICROSOFT LYNC	Prishtinë 7-18 mars 2016	IKAP
11	- Zyrtarja Ligjore - Zyrtari për Rregullim të Tregut	2	Përafrimi i legjislacionit vendor me atë Evropian.	Prishtinë 22-25 mars 2016	IKAP
12	Drejtori i Përgjithshëm	1	Pjesëmarrje në Konferencën informuese “ Marrëveshja e Stabilizim Asociimit Kosovë-BE dhe zbatimi i saj”.	Prishtinë 29 mars 2016	MIE
13	Stafi i ARH-së	10	Misioni i Eksperteve Autorizimi për futjen në shërbim.	Prishtinë 30-31 mars 2016	TAIEX -ARH
14	- Kryesuesi i Divizionit të Prokurimit, - Zyrtarja Ekzekutive	2	Lidershipi dhe Menaxhimi	Prishtinë 29-31 mars 2016	IKAP
15	Kryesuesi i Departamentit të Financave	1	Seminar - Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli dhe Roli i ZKF-së.	Prishtinë 06 prill .2016	MF
16	Drejtori i Përgjithshëm	1	Track Access Charges Summit	Bern 11-14 prill 2016	
17	- Drejtori i Përgjithshëm, - Kryesuesi i Departamentit të Rregullimit të Tregut, - Zyrtarja Ekzekutive	3	Takimi plenar i shteteve anëtare të IRG-Rail.	Poloni 2-13 Prill 2016 dhe 26-30 prill 2016	IRG
18	- Kryesuesi i Departamentit të Financave. - Zyrtarja e Administratës	2	Krijimi dhe riorganizimin i strukturave organizative të institucioneve në Administratën Publike	Prishtinë 2-13 prill .2016	MAP
19	- Kryesuesi i Departamentit të Sigurisë. - Inspektori i Sigurisë	2	Rregullat Nacionale të Sigurisë dhe Trajnim për Rregulloren Nr. 402/2013	Francë 12-16 prill 2016	ERA
20	Zyrtarja e Administratës	1	Menaxhimi i dokumenteve arkivor	Prishtinë 26-27 prill 2016	MAP
21	Drejtori i Përgjithshëm	1	Pjesëmarrja në sesionin informativ për instrumentin e Binjakëzimit	Prishtinë 06 maj 2016	

22	- Kryesuesi i Divizionit të Prokurimit, - Zyrtarja Ekzekutive	2	E drejta për qasje në dokumente publike dhe për mbrojtjen e të dhënave personale	Prishtinë 04-05 maj 2016	IKAP
23	Kryesuesi i Departamentit të Rregullimit të Tregut.	1	Working group railway and intermodality (regulatory and competition aspects),	Podgoricë 7-8 maj 2016	SEETO
24	Zyrtari për Interoperabilitet	1	Microsoft Office Power Point dhe Outlook 2010"	Prishtinë 10 - 11 Maj 2016	IKAP
25	- Kryesuesi i Departamentit të Sigurisë. - Kryesuesi i Departamentit të Rregullimit të Tregut	2	Takimi i 41 ^{të} plenarë i Autoriteteve Nacionale të Sigurisë	Francë 18-19 maj 2016	ERA
26	Kryesuesi i Departamentit të Sigurisë	1	Autorizimi për Futjen në Shërbim të mjeteve lëvizëse sipas paketën e 4 ^{të} hekurudhore	Francë 19-20 maj 2016	ERA
27	Kryesuesi i Divizionit të Prokurimit	1	Trajnimi Bazik për Prokurimin Publik - (10 module)	Prishtinë 12-13 maj dhe 23 qershor 2016	IKAP & KRPP
28	- Kryesuesi i Departamentit të Financave. - Kryesuesi i Divizionit të Prokurimit	2	Menaxhimi Strategjik - Trajnim	Prishtinë 24-25 maj 2016	IKAP
	- Zyrtarja Ligjore - Kryesuesi i Departamentit të Rregullimit të Tregut	2	Etika, Integriteti dhe Transparenca në Administratën Publike"	Prishtinë 20-21 qershor 2016	IKAP
30	Drejtori i Përgjithshëm	1	16th International Multidisciplinary Scientific Conferences & EXPO-SGEM 2016	Bullgari 30.06-05.07.2016	
31	Stafi i ARH-së	10	Misioni i Eksperteve „Specifikacionet Teknike për Interoperabilitet (EU Regullorja Nr. 1299/2014 INF): ARH)	Prishtinë 19-20 korrik 2016	TAIEX-ARH
32	Zyrtarja e Administratës	1	SIMBNJ	Prishtinë 2-5 gusht 2016	MAP
33	- Drejtori i Përgjithshëm. - Kryesuesja e Departamentit të	2	Tryeza e rrumbullakët “ Gjendja ekzistuese e Hekurudhave të Kosovës dhe integrimi i tyre në rrjetin hekurudhor Europian”	Prishtinë 26 gusht 2016	Kolegji Tempulli

	Interoperabilitetit				
34	- Drejtori i përgjithshëm. - Kryesuesi i Departamentit të Sigurisë	2	Konferenca ndërkombëtare zhvillimi i Sistemit Hekurudhor në Europën Jug-Lindore.	Prishtinë 15 shtator 2016	
35	- Drejtori i Përgjithshëm - Kryesuesi për Siguri - Zyrtari për Rregullim të Tregut	3	Innotrans 2016	Gjermani 19-24 shtator 2016	Innotrans
36	- Kryesuesi i Departamentit të Sigurisë - Zyrtari për Interoperabilitet	2	Takimin e 42 ^{te} plenarë i Autoriteteve Nacionale të Sigurisë	Francë 27-28 shtator 2016	ERA
37	Zyrtari i Rregullimit të Tregut	1	Propozimi i Masave të Programit të Reformës në Ekonomi 2017-2019 Energjia, Transporti dhe Telekomunikimi	Prishtinë 19-20 tetor 2016	MI
38	- Drejtori i Përgjithshëm - Kryesuesi i Departamentit të Sigurisë.	2	European Network of Rail Regulatory Bodies (ENRRB), Direktoratë- General for Mobility and Transport	Francë 19-22 tetor 2016	ARAFER- DG Move
39	- Kryesuesi i Departamentit të Rregullimit të Tregut. - Kryesuesi i Departamentit të Financave	2	Raportimin Financiar të Organizatave Buxhetore dhe për Planin e Veprimit për Implementimin e Rekomandimeve të Auditorit.	Turqi 21-25 tetor 2016	
40	Kryesuesi i Divizionit të Prokurimit	1	Mbrojtja e të dhënave personale në institucione dhe ndërmarrje publike	Mali i Zi 20-24 tetor 2016	KMI
41	- Kryesuesja e Departamentit për Interoperabilitet - Kryesuesi i Departamentit të Siguri - Kryesuesi i Divizionit të Prokurimit - Kryesuesi i Departamentit të Financave	4	Vlerësimi i ndikimit rregullativ dhe hartimi i Koncepteve të Dokumenteve	Prishtinë 12-14 nëntor 2016	IKAP & Banka Botërore
42	- Kryesuesi i Divizionit të Prokurimit. - Kryesuesi i Departamentit të Sigurisë	2	Partneritetet Publiko Private, Niveli I: Hyrje në PPP	Prishtinë 16-17 nëntor 2016	IKAP & MF

43	- Kryesuesi i Departamentit të Interoperabilitetit - Zyrtarja Ekzekutive, - Zyrtarja e Departamentit Ligjor,	3	Korniza e Përbashkët e Vetë-vlerësimit (KPV) / Common Assessment Framework (CAF)	Prishtinë 24 - 25 Nëntor 2016	IKAP
44	- Kryesuesi i Departamentit të Administratës - Kryesuesi i Departamentit Ligjor - Zyrtari i lartë i Rregullimit të Tregut - Inspektori për Siguri - Asistenti për Siguri	5	Hartimi i Shkresave Zyrtare, Komunikimi, Menaxhimi dhe Qarkullimi i Dokumenteve Administrative, Financiare dhe Implementimi i Prokurimit Elektronik në Kosovë.	Bullgari 18 -24 dhjetor 2016	LMC & ITA
45	Bordi i ARH-së	5	Raportimi Financiar i Organizatave Buxhetore dhe Plani i Veprimit për Implementimin e rekomandimeve të Auditorit	Turqi dhjetor	CDT
46	- Kryesuesi i Divizionit të Prokurimit, - Zyrtarja Ekzekutive	2	Shkolla për Integritet Evropian	Prishtinë	KCSF
47	Stafi i ARH-së dhe pjesëmarrës nga vendet e rajonit	18	Multi-beneficiary Workshop on Market Regulation of Railways	Prishtinë	TAIEX-ARH
48	Bordi i ARH-së.	5	Vizitë nga institucionet relevante në sektorin hekurudhor të Shqipërisë	Shqipëri 2016	

4.5. Asetet

4.5.a. Asetet në posedim të institucionit

ARH-ja ka në përdorim 286 asete me vlere në blerje prej 106,572.95 €. Këto asete janë kryesisht automjete, orendi zyresh dhe pajisje teknologjike. Zhvlerësimi dhe vlerësimi i aseteve bëhet çdo fund vit sipas dispozitave të Rregullores MF-Nr. 02-/2013 për Menaxhimin e Pasurisë jo Financiare në Organizatat Buxhetore dhe sipas Udhëzimit Nr. 01/2012 për Menaxhimin e Pasurisë së ARH-së. Sipas raportit të komisionit të inventarizimit dhe vlerësimit vlera e aseteve në ARH për vitin 2016 sipas rregullave të parapara me rregulloren e lartcekur është 23,145.86€.



4.5.b. Planet për asete të reja

ARH, për nevojat e funksionalizimit, planifikon (varësisht nga mundësitë buxhetore) që të siguroi objekt të përhershëm për zyre. Pasi tani, përveç që objekti që kemi në shfrytëzim nuk i plotëson kërkesat minimale të sipërfaqes për numrin e të punësuarve dhe fushëveprimtarin e vet, është edhe ngarkesë buxhetore qiraja që paguhet.

Investim tjetër i nevojshëm është edhe furnizimi me pajisje të teknologjisë informative. Pastaj investimi në mjete lëvizëse për nevoja të ARH-së, etj.

Zyra e ARH-së është në Prishtinë në Rr. "Rrustem Statovci. nr. 29. Hapësira fizike e institucionit të ARH-së është 250 m². ARH-ja në vazhdimësi bënë kërkesë në Ministrinë e Administratës Publike për t'iu siguruar një objekt qeveritar, meqë objekti i tanishëm është pronë private dhe paguhet me qira nga ARH-ja.

4.6. Pagat e personelit të ARH-së

Autoriteti Rregullativ i Hekurudhave të Republikës së Kosovës ka prioritet mbikëqyrjen dhe sigurinë e sektorit hekurudhore. ARH-ja siguron që operimet hekurudhore në Republikën e Kosovës të realizohen në përputhje me Ligjin e Hekurudhave dhe standardet e BE-së. Për ta arritur këtë, rregullatori i hekurudhave të Kosovës ka nevojë për personel shumë të kualifikuar dhe me përvojë për t'i hartuar standardet, procedurat, rregulloret dhe për të siguruar zbatimin e tyre nga operatorët përmes mbikëqyrjes së vazhdueshme dhe inspektimeve. Përkundër kësaj niveli i pagave të personelit të ARH-së që nga themelimi vazhdon që të jetë mjaft i ulët në krahasim me pagat e personelit të industrisë së hekurudhave dhe Rregullatorëve tjerë të pavarur. Personeli i ARH nuk gëzon asnjë kompensim shtesë përveç pagës bazë nga buxheti i konsoliduar i Republikës së Kosovës. Si rezultat ARH rrezikon humbjen e stafit profesional aq më tepër në këtë kohe kur investimet janë drejtuar seriozisht në këtë sektor.

4.7. Sistemi për menaxhim të cilësisë

4.7.a. Të përgjithshme

ARH-ja ka të ngritur Sistemin për Menaxhim të Cilësisë (SMC), i cili përshkruhet në manualin e cilësisë, për të demonstruar kapacitetet tona për realizim të vazhdueshëm të detyrave në përmbushje të obligimeve tona si rregullator dhe për të vepruar me efikasitet dhe efektshmëri. Sistemi për menaxhim të cilësisë në ARH



e mbështet qasjen ndaj proceseve të punës dhe parimeve që i përmban Standardi ISO 9001:2008 dhe kërkon gatishmërinë tonë të vazhdueshme për përmirësim të këtij sistemi. Sistemi për menaxhim të cilësisë është pjesë e sistemit të përgjithshëm të menaxhimit në ARH, përmes të cilit hartohen dokumente dhe zbatohet politika e cilësisë dhe realizohen proceset e punës për të ofruar shërbime të cilat i përmbushin kërkesat e shfrytëzuesve dhe kërkesat e Standardit ISO 9001:2008.

ARH ka një sistem i cili definon të gjitha proceset e punës, duke përfshirë ato kyçe të menaxhimit si dhe ato ndihmëse. Proceset dhe realizimin e tyre i menaxhojmë duke e definuar saktësisht *inputin*, bartësin e procesit, ndërlidhjen në mes të proceseve si dhe *outputin* e tij. Kjo mundëson arritjen e efikasitetit dhe efektivitetit si dhe sinergjisë së proceseve të punës. Proceset e punës janë proceset të cilat ndërlidhen drejtpërdrejt me shërbimet që ne i ofrojmë. Disa nga proceset kanë të bëjnë me menaxhimin e resurseve, që shërbejnë për të mbështetur proceset kyçe, dhe njihen si procese “mbështetëse”. Proceset e ndërlidhura me “menaxhim” janë proceset që kujdesen për nevojat e veçanta të menaxhmentit drejt realizimit të kërkesave të standardit ISO 9001:2008 dhe kërkesave tjera të aplikueshme për ARH-në si rregullator. Të gjitha proceset e punës janë të përshkruara në manualët e brendshme të ARH-së.

4.7.b. Sistemi dhe struktura e dokumenteve të cilësisë

Dokumentet e brendshme të ARH-së ndahen në tri nivele: Manuali i Cilësisë është dokument i nivelit të parë, manualët e zhvilluara brenda njësive organizative bashkë me proceset dhe procedurat janë dokumente të nivelit të dytë, ndërsa dokumente të nivelit të tretë janë instruksionet e punës, formularët e ndryshëm dhe listat kontrolluese, të cilat për shkaqe praktike, në ARH janë vendosur si shtojca të manualeve të brendshme.

Nivelet e dokumenteve e qartësojnë hierarkinë dhe referimin në rast të mospërputhjes së dokumenteve në mes vete. Në të gjitha rastet, niveli më i lartë i dokumentit e mbizotëron atë të nivelit më të ultë.

4.7.c. Standardet e cilësisë

Dokumenti “ISO 9001:2008, Quality Management System – Requirements” përmban kërkesat në bazë të së cilave janë krijuar themelet e këtij manuali dhe të sistemit tonë për menaxhim të cilësisë.



4.7.d. Politika e Cilësisë

Është politikë e Autoritetit Rregullativ të Hekurudhave që të krijojë, zbatojë dhe mirëmbajë një sistem për menaxhim të cilësisë brenda organizatës, përmes të cilit sigurohet realizimi i plotë i detyrave të ARH-së, me qëllim të garantimit të një ambienti të sigurt dhe konkurrues hekurudhor në Republikën e Kosovës. Për ne shfrytëzuesit e shërbimeve tona janë shumë të rëndësishëm, prandaj ne përpiqemi që të ofrojmë shërbime sa më cilësore, duke matur kënaqshmërinë e tyre, duke përmirësuar vazhdimisht efektivitetin dhe efikasitetin e punës sonë, duke monitoruar performancën tonë kundrejt objektivave të vendosura dhe duke promovuar përfshirjen e punëtorëve në të gjitha proceset e punës.

4.7.e. Manuali i cilësisë

Manuali i cilësisë është njëra ndër kërkesat kryesore të Standardit ISO 9001:2008. Qëllimi i këtij manuali është të vendosë dhe të theksojë politikat e Sistemit të Menaxhimit të Cilësisë në ARH. Këto politika definojnë angazhimet e menaxhmentit për menaxhimin e veprimeve dhe aktiviteteve në pajtueshmëri me ISO 9001:2008. Këto politika të nivelit më të lartë, përfaqësojnë planet ose protokolet për të garantuar zbatimin e detyrimeve të përcaktuara me kornizën ligjore dhe rregullatore të aplikueshme, si dhe për të mundësuar pranimin e shërbimeve kualitative dhe kënaqshmërinë e klientëve. Sipas kërkesës, në manual është përshkruar mënyra se si në këtë autoritet janë rregulluar fusha të ndryshme të veprimtarisë, duke përfshirë edhe mënyrën e menaxhimit të organizatës, politikat e saj, si dhe kapacitetet dhe strukturën e saj organizative.

ARH-ja ka të krijuar strukturë të tillë të dokumentacionit, ku secili departament ka krijuar një dokument, i cili përshkruan detajisht punët, proceset e punës, procedurat dhe të gjitha dokumentet tjera përcjellëse.

Meqenese ISO standardi 9001:2008 eshte ndryshuar me standardin e ri ISO 9001:2015, në periudhën në vijim do te bejme perpjekje që të angazhojmë një kompani konsulente për përditësimin e Menaxhimit të Cilësisë nga ISO 9001:2008 në versionin ISO 9001:2015 dhe të punojmë më shumë rreth aplikimit të versionit të ri dhe të certifikohemi.



Përshkrimi i fushës që e mbulon ARH

5.1. Përshkrim i shkurtër i fushës që mbulon ARH dhe një krahasim me tri vitet e fundit

ARH është organ i pavarur që rregullon dhe mbikëqyrë sektorin e hekurudhave në përputhje me legjislacionin në fuqi në Kosovë dhe me legjislacionin në fuqi të BE-së, të përshtatshëm për Kosovën në këtë sektor.

ARH është organ i pavarur i themeluar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës i cili është i ngarkuar për rregullimin, mbikëqyrjen, organizimin e sektorit hekurudhor në Republikën e Kosovës dhe vepron si organ për: Licencim, Siguri, Interoperabilitet dhe Rregullim të Tregut. ARH ofron shërbime cilësore të sigurt, transparente dhe jo diskriminuese për ndërmarrjet hekurudhore dhe menaxherin e infrastrukturës në sektorin hekurudhor në Republikën e Kosovës dhe kompetencave të tjera të cilat i jepen në bazë të Ligjit Nr. 04/L-063 për Hekurudhat e Republikës së Kosovës i cili është në përputhje të plotë me legjislacionin dhe direktivat në fuqi të BE-së.

Krahasuar me tri vitet paraprake, duhet theksuar se ARH, pasi që nuk është institucion që gjeneron të ardhura, nga aspekti financiar nuk ka se çka të bëjë krahasim. Ndërsa, nga aspekti i angazhimeve në pasurimin e infrastrukturës ligjore, përkunder punës dhe draftimit të shumë rregulloreve, nuk ka pasur një vendim nga Bordi për miratimin e tyre, pasi që Bordi nuk ka qenë funksional prej Marsit 2014 e deri në fund-tetor 2017. Andaj, edhe kjo pikë si njëra nga pikat kyçe të angazhimeve të ARH-së, nuk mund të jetë objekt krahasimi tani.

5.2. Planifikimi dhe realizimi i punës 2016

Plani i Punës shërben për koordinimin e aktiviteteve të ARH-së dhe departamenteve përkatëse të tij, në mënyrë që të mundësohet përmbushja efikase dhe me kohë e synimeve dhe objektivave të përcaktuara. Plani i punës hartohet në



atë forme duke i identifikuar objektivat e nevojshme vjetore për përmbushjen e obligimeve ligjore, të cilat hartohen në nivel të menaxhmentit. Prioritetet dhe synimet operative të përcaktuara me këtë plan janë në konsistencë me misionin e ARH-së dhe përgjegjësitë e ARH-së të përcaktuara me Ligjin e Hekurudhave të Kosovës. Realizimet e Planit vjetore të punës rishikohen nga menaxhmenti i ARH-së.

Plani i punës për vitin 2016 dhe realizimi i tij është paraqitur në formë tabelore

Tabela 18: Planifikimi i punës 2016 dhe realizimi

REALIZIMI I PLANIT TË PUNËS PËR VITIN 2016						
Aktivitetet e planifikuara		Periudha				Statusi
		K I	K II	K III	K IV	
1	Rregullorja për Metodat e përbashkëta të Sigurisë				KIV	Në Proces
2	Finalizimi i draft-rregullores „Nënsistemet hekurudhore dhe kërkesat esenciale,,				KIV	Në Proces
3	Përgatitja e pasqyrave financiare vjetore në bazë të LMFP-së	KI				Përfunduar
4	Rregullore për Raportimin dhe monitorimin e tregut hekurudhorë				KIV	Në proces
5	Përgatitja dhe hartimi i Akteve nënligjore të nevojshme të ARH-së sipas ligjit të hekurudhave në pajtim me parimet e Direktivës të BE-së	KI	KII	KIII	KIV	Në proces
6	Shqyrtimi i aplikacioneve për licenca të makinistëve dhe aplikacioneve për Licencë për operime për kompani ekzistuese dhe të reja		KII	KIII		E përfunduar
7	Inspektimi i makinistëve të licencuar dhe përgatitja e raporteve të inspektimit të makinistëve	KI	K II	KIII	KIV	E përfunduar
8	Rregullat Nacionale të Sigurisë					E pa përfunduar
9	Shqyrtimi i aplikacioneve për certifikata/autorizime, autorizime për futje në shërbim për kompani ekzistuese dhe të reja	KI	KII	KIII	KIV	E përfunduar
10	Mbikëqyrja e implementimit të rekomandimeve nga inspektimi i mjeteve lëvizëse dhe infrastruktura hekurudhore gjatë vitit 2015	K I	KII	KIII	KIV	E përfunduar
11	Mbikëqyrja e implementimit të inspektimit të infrastrukturës hekurudhore pasi janë dhënë raportet me rekomandim për vitin 2015	Ki	KII	KIII	KIV	E përfunduar
14	Regjistrimet e mjeteve të reja për mirëmbajtje pas marrjes së autorizimit për futje në shërbim	K I	K II	K III	K IV	E përfunduar

15	Shqyrtimin e ankesave për tregun hekurudhor në transportin e mallrave si dhe për të drejtat e udhëtareve				KIV	E përfunduar
16	Monitorimi i marrëveshjes për kompensimin e “Obligimeve të Shërbimeve Publike	KI	KII	KIII	KIV	E përfunduar
17	Monitorimi dhe kontrollimi i “Marrëveshjes mbi qasjen” në mes të Sh.a.Infrakos, dhe Sh.a. Trainkos	KI	KII	KIII	KIV	E përfunduar
18	Bashkëpunimi dhe koordinimi i të gjitha marrëveshjeve të nënshkruara me rregullator vendor dhe ndërkombëtar e në veçanti me IRG-Rail të Evropës				K IV	E përfunduar
19	Përgatitja e Barazimeve vjetore si dhe Përgatitja dhe dorëzimi i Qarkores buxhetore	KI	KII	K III	K IV	E përfunduar
20	Zhvillimi dhe menaxhimi i procedurave të prokurimit për të gjitha nevojat e ARH-së, sipas planifikimit të prokurimit	KI	KII	KIII	KIV	E përfunduar
21	Azhurnimi i Regjistrat të Makinistëve të Licencuar	KI	KII	KIII	KIV	E përfunduar
22	Përgatitja e broshurës për vendkalime				KIV	Në proces
23	Rregullore për të hyra dhe gjoba				KIV	Në proces
24	Mbikëqyrja e performances së sigurisë për MI dhe NH		KII	KIII	KIV	E përfunduar
25	Mbikëqyrja e implementimit të SMS- Sistemit për Menaxhimin e Sigurisë-Infrakos-Trainkos	KI	KII	KIII	KIV	E përfunduar
26	Rregullorja për Caqet e përbashkëta të Sigurisë					E pa përfunduar
27	Finalizimi i Specifikacioneve Teknike për Interoperabilitet për Infrastrukturë 2011/275/EU				KIV	Në proces
28	Specifikacionet teknike për Interoperabilitet „Operimi dhe Menaxhimi i Trafikut,, për hekurudhe				KIV	Në proces
29	Përgatitja e dokumentit, „Libri i rregullave për makinistë,,		KII	KIII	KIV	Në proces
30	Përgatitja e dokumentit „Libri i rrugëve,,					Në proces
31	Monitorimin e tregut hekurudhor në Kosovë, dhe përgatitjen e raportit të monitorimit të tregut Hekurudhor	KI	KII	KIII	KIV	E përfunduar
32	Inspektimi i të gjitha kalimeve në nivel dhe vlerësimi i parametrave të sigurisë	KI	KII	KIII	KIV	E përfunduar
33	Rregullorja për Autorizimin për fuqje në shërbim të Infrastrukturës				KIV	Në proces
34	Inspektimi i infrastrukturës hekurudhore		KII	KIII	KIV	E përfunduar
35	Sigurimin se pagesat e vendosura nga Menaxheri i Infrastrukturës janë transparente dhe jo diskriminuese	KI	KII	KIII	KIV	E përfunduar
36	Përgatitja e raportit vjetor të sigurisë			KIII		E përfunduar

37	Inspektimi i Sinjalizimeve në të gjitha linjat ekzistuese hekurudhore të cilat janë në përdorim dhe vlerësimi i parametrevë të sigurisë		KII	KIII	KIV	E përfunduar
38	Listimi i marrëveshjeve kontraktuale për operim dhe mirëmbajtje të kompanive hekurudhore me kompani brenda dhe jashtë vendit	KI	KII	KIII	KIV	E përfunduar
39	Monitorimi i Licencave të lëshuar TRAINKOS-it, NFRAKOS-it, RAILTRANS-it nga ARH, në veçanti sigurimet e kompanive	KI	KII	KIII	KIV	E përfunduar
40	Inspektimi i mjeteve lëvizëse dhe vlerësimi i parametrevë të sigurisë			KIII	KIV	E përfunduar
41	Përgatitja e raporteve të inspektimeve, dërgimi në Infrakos dhe Trainkos				KIV	E përfunduar
42	Organizimi i një workshopi ndërkombëtar për kalimet në nivel ose sinjalizimin					E papërfunduar
43	Shënjimi i VKM në numrit evropian në mjetin lëvizës për mjetet e INFRAKOS-it, TRAINKOS-it dhe FERRONIKEL-it				KIV	E përfunduar
44	Inspektimi i regjistrimit nacional të mjeteve lëvizëse (përputhshmëria e mjeteve lëvizëse operuese me regjistrin nacional të mjeteve lëvizëse)				KIV	E përfunduar

Aktivitet jashtë planifikimit përgjatë vitit 2016

Nr.	Aktiviteti	Shpjegim i përgjithshëm
1	Mjetet me pronësi të pa definuar	Regjistrimi dhe inspektimi i mjeteve me pronësi të pa definuar është realizuar nga grupi punues në përbërje të ARH-TRAINKOS-INFRAKOS. Regjistrimi që ka përfshirë modifikimet e regjistrit 2015 të mjeteve me pronësi të pa definuar është realizuar më datë: 17.06.2016. Procesi i inspektimit të mjeteve lëvizëse me pronësi të pa definuar ka filluar më datë: 28.06.2016 dhe ka zgjatur gjithsej dymbëdhjetë ditë përgjatë 4 muajve dhe ka përfunduar më datë: 14.09.2016. Raporti përfundimtar rreth këtij inspektimi, është dorëzuar në Kuvendin e Kosovës, MI, MZHE, etj.



5.3. Veprimet e ARH-së për përmirësimin/monitorimin e fushës së veprimit

Monitorimi i Tregut Hekurudhor;

Avancimi në aspektet e sigurisë hekurudhore, përmes inspektimeve dhe dhënies së rekomandimeve;

Plotësimi i kuadrit ligjor me aktet nënligjore për përafrim me Direktivat Europiane

Licencimi i makinistëve, dhënia e certifikatave të sigurisë për NH, etj.

5.4. Sfidat e vitit raportues dhe planifikimi për vitin vijues

Përgatitja dhe implementimi i Specifikacioneve Teknike për Interoperabilitet;

Mbikqyrja e procesit të përgatitjes profesionale të makinistëve;

Plotësimi i kuadrit ligjor me aktet nënligjore nga ana e ARH-së, MI-së; dhe Direktivave Europiane

Plotësim\ndryshimi i ligjit të HK-së dhe adaptimi me nevojat dhe kërkesat praktike;



Puna gjatë vitit raportues

6.1. DEPARTAMENTI I LICENCIMIT

6.1.1. Detyrat dhe përgjegjësitë

Bazuar në Ligjin për Hekurudhat e Kosovës Nr. 04/L-063 Departamenti i Licencimit është përgjegjës për:

- | Licencimin e Menaxherëve të Infrastrukturës
- | Licencimin e Ndërmarrjeve Hekurudhore
- | Licencimin e Makinistëve, dhe
- | Amandamentimin, Suspendimin dhe Revokimin e Licencave të lëshuara.

6.1.2. Aktivitetet e Departamentit të Licencimit

Gjatë vitit 2016 Departamenti i Licencimit pranë Autoritetit Rregullativ të Hekurudhave, duke u bazuar në Ligjin e Hekurudhave, akteve nënligjore si dhe planin vjetor të punës ka pasur disa prioritete, siç janë: shqyrtimi i aplikacioneve të reja për licencim të makinistëve, monitorimin e licencave të lëshuara për menaxherin e infrastrukturës si dhe ndërmarrjet hekurudhore, përgjigja në kërkesat për licenca të reja, si dhe inspektimi dhe monitorimi i makinistëve të licencuar nga ARH-ja.

Departamenti i Licencimit për t'i përmbushur këto objekte, ka punuar një agjendë konkrete për realizimin e tyre gjatë vitit 2016.

6.1.2.1. Liberalizimi i tregut

Duke marrë parasysh faktin se Ligji për Hekurudhat e Kosovës ka liberalizuar tregun hekurudhor në Republikën e Kosovës, gjatë vitit 2016 kemi pasur dy kompani të ndryshme, një vendore dhe një ndërkombëtare të interesuara që të pajisen me licencë dhe dokumentacion tjetër përkatës për të operuar në Kosovë.

Më datë 21.01.2016 në Autoritetin Rregullativ të Hekurudhave kemi pritur në takim përfaqësuesit e kompanisë Top Logistic, të cilët kanë qenë të interesuar të informohen rreth kushteve për licencë për transport hekurudhor të mallrave. Në këtë takim, ne si



ARH i kemi shpjeguar në pika të shkurtra rolin dhe misionin e ARH-së, si dhe informacionin e duhur se si është kjo çështje e rregulluar në aspektin ligjor. Po ashtu i kemi informuar rreth procedurave dhe afateve ligjore, përfshirë kushtet e domosdoshme që duhet të plotësohen në mënyrë që të pajisen me licencë. Pas marrjes së informacionit të nevojshëm së bashku me kushtet që Ligji dhe aktet nënligjore kërkojnë për tu pajisur me licencë, kjo kompani nuk ka shprehur interes të mëtejshëm apo të aplikoj formalisht për licencë.

Gjithashtu gjatë vitit 2016 kemi pasur interesim për njohje të licencës Evropiane nga ana e kompanisë Ceke Loko Trans.¹ Më datë 09.05.2016 kemi zhvilluar takim me përfaqësuesit e kompanisë hekurudhore Loko Trans në Autoritetin Rregullativ të Hekurudhave. Përfaqësuesit e Loko Trans kanë qenë të interesuar të dinë procedurat si dhe kërkesat ligjore për licencim për transport të mallrave, veçanërisht procedurat dhe kriteret ligjore për njohje të licencës Evropiane në transport hekurudhor. Nga ana jonë i është dhënë i gjithë informacioni i nevojshëm, bazuar në Ligjin për Hekurudhat e Kosovës, Udhëzimin Administrativ 02/2012 si dhe Rregulloren e Licencimit 01/2012. Meqenëse kompania Loko Trans ka shpreh interesim për njohje të licencës, ne si ARH i kemi informuar se kjo kompetencë nuk është tek Autoriteti por tek Ministria e Infrastrukturës. Neni 10, paragrafi 4 i Ligjit të Hekurudhave e përcakton qartë se njohja e licencave në transport hekurudhor është në kompetencë të kësaj Ministrie.² Bazuar në rekomandimin e ARH-së, përfaqësuesit e kompanisë Loko Trans kanë shpreh interesim në Ministri të Infrastrukturës rreth njohjes së licencës Evropiane. Ministria me anë të një përgjigje të shkurtër të datës 30.08.2016 ka deklaruar se ARH është kompetente rreth licencave në sektorin hekurudhor. Më datë 20.09.2016 kompania Loko Trans ka kërkuar nga ARH sqarim rreth procedurave dhe institucionit kompetent lidhur me njohjen e licencës Evropiane. Pas shqyrtimit të kësaj kërkesë së bashku me përgjigjen e Ministrisë së Infrastrukturës, më datë 10.10.2016 ARH ka dhënë përgjigjen e mëposhtme:

„Pas pranimit të kërkesës nga Loko Trans për sqarim të procedurave dhe institucionin vendimmarrës për njohje të Licencës dhe pjesën A të Certifikatës së

¹ Loko Tran është Ndërmarrje Hekurudhore nga Republika e Çekisë. Kjo ndërmarrje është aktive edhe në Sllovaki, si dhe operon në disa shtete Evropiane dhe më gjerë. Gjithashtu, ka degën e vetë të regjistruar edhe në Kosovë, bazuar në shkresat e kësaj të fundit që ka dërguar në ARH

² Neni 10.4: “Pas konsultimit me organin licencues dhe palët e interesuara, Ministria mund të pajtohet me ministrinë e vendeve tjera për njohjen reciproke të licencave të lëshuara për sektorin hekurudhor.”



Sigurisë, ARH ka analizuar me kujdes kërkesën tuaj dhe kanë ardhur në këto përfundime:

E para, as Ligji për Hekurudhat e Kosovës Nr. 04/L-063 dhe as Udhëzimet Administrative Nr. 02/2012 nuk i kanë përcaktuar qartazi kriteret për njohje të Licencës dhe Pjesën A të Certifikatës së Sigurisë, vetëm e kanë dhënë një mundësi të tillë që këto dy dokumente të jenë të vlefshme edhe në Kosovë, nëse janë në përputhje me legjislacionin e Kosovës.

E dyta, e vetmja dispozitë ligjore e cila i referohet institucionit kompetent për njohje të licencës është Neni 10 paragrafi 4 i Ligjit të Hekurudhave, i cili thotë: *Pas konsultimit me organin licencues dhe palët e interesuara, Ministria mund të pajtohet me ministrinë e vendeve tjera për njohjen reciproke të licencave të lëshuara për sektorin hekurudhor.* Nga kjo dispozitë ligjore e lartcekur, shihet qartazi se është detyrë dhe përgjegjësi e Ministrisë njohja ose jo e licencave në sektorin hekurudhor të lëshuara nga shtetet e BE-së apo ndonjë shtet tjetër. Rrjedhimisht edhe përcaktimi i kriterëve dhe procedurave për njohje të licencave bie mbi këtë institucion.

E treta, Ligji për Hekurudhat e Kosovës i ka dhënë detyra të caktuara organit licencues, e të cilat janë të përcaktuara në nenin 22 paragrafi 1, e që kanë të bëjnë me lëshimin, amandamentimin, suspendimin dhe revokimin e licencave. Po ashtu, edhe neni 92 në mënyrë të njëjtë e thotë se organi licencues bënë lëshimin, ndryshimin, suspendimin dhe revokimin e licencave sipas nevojës. Mirëpo, askund nuk ceket ose epet detyrë dhe përgjegjësi për organin licencues nga ligji në fjalë, njohja e licencave. Normalisht nuk është dhënë një përgjegjësi e tillë për organin licencues, sepse e njëjta ju ka dhënë Ministrisë në bazë të nenin 10 paragrafi 4. Për më shumë, ARH ndër vite ka përcaktuar procedura për licencim, përfshi edhe formularët e aplikimit për licenca të reja, por asnjë hap nuk e ka bërë në këtë drejtim në raport me njohjet e licencave, për faktin se nuk ka qenë kompetencë ligjore e sajë.

E katërta, Udhëzimi Administrativ Nr. 02/2012 për Licencimin e Ndërmarrjeve Hekurudhore dhe dispozitat e tij, duhet parë dhe janë relevante vetëm në kuptimin e nenit 10 paragrafi 4 të Ligjit të Hekurudhave, e që kanë të bëjnë me konsultime në mes të Ministrisë, ARH-s dhe palëve të interesuara, për njohjen ose jo të licencës. ARH është e gatshme të ofroj konsulta dhe bashkëpunim në çdo kohë, nëse një gjë e tillë kërkohet nga ana e Ministrisë. Mirëpo, në fund i mbetet Ministrisë që pas konsultave me organin licencues dhe palët tjera, ashtu siç e përcakton ligji, të vendos për njohjen ose jo të licencës për të cilën është kërkuar njohja”



Pas këtij sqarimi, kemi zhvilluar edhe takime të përbashkëta mes Ministrisë së Infrastrukturës, Autoriteti Rregullativ të Hekurudhave si dhe përfaqësuesit të Loko Trans, ku pas diskutimeve të gjitha palët janë pajtuar se kërkesa për njohje duhet bëhet në Ministri, konform nenit 10 paragrafi 4 të ligjit.

6.1.2.2. Licencimi i Makinistëve

Gjatët vitit 2016 Departamenti i Licencimit ka pranuar disa aplikacione për licencë të makinistëve, të cilat janë vendosur bazuar në dispozitat e Ligjit të Hekurudhave si dhe Rregullores për Licencim të Makinistëve. Konkretisht, në ARH me datë 10.02.2016 nga Trainkos-i kemi pranuar aplikacion me kërkesë për licencim të një makinisti. Shqyrtimi i aplikacionit nga ana e ARH-së është bërë konform procedurave dhe kërkesave ligjore në fuqi, të parapara me Ligjin për Hekurudhat e Kosovës si dhe Rregulloren për Licencimin e Makinistëve Nr .02/2013. ARH gjatë shqyrtimit të aplikacioneve është fokusuar në kushtet të cilat Ligji dhe Rregullorja i obligon që një makinist t'i përmbushë në mënyrë që të marrë licencë. Këto kushte kanë qenë: certifikata e makinistit e lëshuar nga ndërmarrja hekurudhore, ekzaminimi mjekësor konform kërkesave të parapara në Ligj dhe Rregulloren Nr. 02/2013 për Licencimin e Makinistëve si dhe kualifikimin shkollor. Në bazë të dokumentacionit të ofruar nga Trainkos, makinisti i ka plotësuar kriteret bazike për marrjen e licencës për makinistë. Gjithashtu, ARH me datë 31.08.2016 nga Railtrans ka pranuar aplikacion me kërkesë për licencim të makinistëve (dy makinistë). Në mënyrë të ngjashme sikurse aplikacioni i mësipërm edhe aplikacionet e Railtrans nga ana e ARH-së janë shqyrtuar konform procedurave dhe kërkesave ligjore në fuqi, të parapara me Ligjin për Hekurudhat e Kosovës si dhe Rregullores për Licencimin e Makinistëve Nr .02/2013. Në bazë të dokumentacionit të afuar nga Railtrans, makinistët i kanë plotësuar kriteret bazike për marrjen e licencës për makinistë.

Tabela 2: Aplikacionet e makinistëve në vitin 2016

Licenca të Makinistëve	Aplikacionet	Lëshuara	Refuzuara	Revokuara	Viti
Trainkos	1	1	0	0	2016
Railtrans	2	2	0	0	2016



6.1.2.3. Inspektimi i makinistëve

Në mesin e aktiviteteve të parapara për vitin 2016 ka qenë edhe inspektimi i makinistëve të cilët drejtojnë trenat brenda territorit të Republikës së Kosovës. Qëllimi i këtyre inspektimeve ka qenë verifikimi, nëse trenat në Kosovë drejtohen vetëm nga makinistët e licencuar. Nga të gjitha inspektimet e bëra gjatë vitit 2016 përfshirë linjat hekurudhore Prishtinë-Peje, Fushë Kosovë-Hani Elezit etj, kanë rezultuar se trenat janë drejtuar gjithnjë nga makinistë të licencuar nga ARH. Një aktivitet shtesë i cili ndërlidhet me makinistët dhe që është realizuar gjatë vitit 2016 është pranimi i raporteve mjekësore periodike për makinistë mbi moshën 55 vjeçare. Bazuar në Rregulloren për Licencim të Makinistëve, çdo makinist mbi këtë moshë duhet që çdo vit të sjellin në ARH raportin mjekësor me anë të së cilit dëshmohet gjendja e tyre shëndetësore.

6.1.2.4. Regjistri i Licencave

Ligji për Hekurudhat e Kosovës, neni 10.3, 23.4 dhe 92.23 e obligon Departamentin e Licencimit që të krijoj dhe azhurnoj regjistrin e ndërmarrjeve hekurudhore dhe menaxherëve të infrastrukturës të licencuar në Republikën e Kosovës dhe që ky regjistër të jetë i publikuar në ueb faqen e ARH-së. Departamenti i Licencimit ka krijuar dhe azhurnuar regjistrin e ndërmarrjeve hekurudhore dhe menaxherëve të infrastrukturës të licencuara në Republikën e Kosovës. Në këtë mënyrë, është respektuar ligji për hekurudhat e Kosovës dhe gjithashtu çdo person fizik apo juridik i cili ka nevojë dhe interes të ketë informacione për sektorin hekurudhor në Kosovë. Po ashtu Departamenti i Licencimit ka bërë kujdes të shtuar gjatë krijimit të regjistrit në fjalë. Fillimisht ky regjistër nuk përmban të dhëna konfidenciale të subjekteve të licencuara, të cilat mund të keqpërdoren nga rivalët biznesor dhe është konform standardeve ndërkombëtare të përdorura për llojin e këtyre regjistrave.



Tabela 3: Regjistri i Licencave

Nr	Emri dhe adresa e kompanisë	Nr. i Licencës	Data e dhënies së Licencës	Llojet e shërbimeve	Territori	Afati i Licencës prej:	Vërejtje
1	TRAINKOS sh. a. Sheshi i Lirisë p. n 12 000 Fushë Kosovë	KS 01/2012 0001	15.11.2012	Operimi me Trena	Republika e Kosovës	15.11.2012	
2	IINFRAKOS sh. a. Sheshi i Lirisë p. n 12 000 Fushë Kosovë	KS 02/2012 0001	15.11.2012	Menaxher i Infrastrukturës	Republika e Kosovës	15.11.2012	
3	Railtrans LLC Dardania BL9 LB4 p.n 10 000 Prishtinë	KS 01/2014 0001	10.03.2014	Operimi me Trena për Transport Hekurudhor të Mallrave	Republika e Kosovës	11.12.2015	

6.1.2.5. Monitorimi i Licencave

Detyrë e Departamentit të Licencimit është që të rishikoj validitetin e licencave të lëshuara në baza të rregullta së paku në çdo pesë (5) vite, duke u siguruar kështu se ndërmarrjet hekurudhore dhe menaxherët e infrastrukturës të licencuara i plotësojnë obligimet e përcaktuara me ligjin për hekurudhat e Kosovës. Departamenti i Licencimit gjatë vitit 2016 ka monitoruar licencat e lëshuara në harmoni me dispozitat ligjore në fuqi. Kryesisht monitorimi i licencave për vitin 2016 ngjashëm sikurse vitet paraprake është fokusuar në sigurimin adekuat ndaj palëve të treta të subjekteve të licencuara. Në këtë mënyrë ne kemi kërkuar nga ndërmarrjet hekurudhore si dhe menaxheri i infrastrukturës që policat e tyre të sigurimit të ripërtërihen, sepse ato janë me afat një (1) vjeçar. Kjo kërkesë e jona dhe njëkohësisht obligim ligjor është përmbushur nga ana kompanive të cilat janë të licencuara për operim në sektorin hekurudhor në Republikën e Kosovë. Ne këtë mënyrë Departamenti i Licencimit është i përkushtuar që ligji për hekurudhat e Kosovës të zbatohet me përpikëri, dhe në rast të ndonjë aksidenti, ndërmarrja hekurudhore dhe menaxheri i infrastrukturës të jenë të mbuluara me sigurim adekuat.



6.2. DEPARTAMENTI LIGJOR

6.2.1. Detyrat dhe përgjegjësitë e Departamentit Ligjor

Detyrat dhe përgjegjësitë themelore të Departamentit Ligjor janë:

- | Mbështetja e të gjitha departamenteve të ARH-së në çështjet ligjore,
- | Verifikimi i dokumenteve ligjore të lëshuara nga ARH-ja,
- | Pjesëmarrje në grupe të ndryshme punuese për hartim të legjislacionit primar dhe sekondar në sektorin e transportit hekurudhor,
- | Hartimi i akteve nënligjore në kuadër të ARH duke marrë parasysh legjislacionin e BE-së në fushën përkatëse, atëherë kur është e nevojshme dhe e mundur,
- | Përfaqësimin e ARH-së në konteste gjyqësore, etj.

6.2.2. Aktivitetet e Departamentit Ligjor

Departamenti Ligjor gjatë vitit 2016 ka finalizuar draft Rregulloren për Taksa dhe Gjoha të ARH-së. Kjo draft Rregullore i ka kaluar të gjitha fazat e konsultimeve brenda institucionit si dhe konsultimet publike me palët e interesit. Lidhur me draft Rregulloren e larte cekur, brenda afatit të paraparë ligjorë për palët e interesit, Infrakos ka dhënë disa komente dhe gjithashtu ka kërkuar takim. Duke marrë parasysh kërkesën e Infrakos-it për një takim konsultativ lidhur me draft Rregulloren, një të tillë e kemi mbajtur me datë 22.04.2016, si pjese e procesit të konsultimeve. Në këtë takim të organizuar në ARH, përfaqësuesit e Infrakos-it kanë ngritur si shqetësim taksat e larta të parapara me draft Rregullore, me theks të veçantë në pjesën e sigurisë dhe gjokat e listuara në Aneksin II, veçanërisht pjesën për personat fizik. Gjatë vitit 2016 kjo draft Rregullore nuk është proceduar për miratim për faktin se ka munguar Bordi Mbikëqyrës i ARH-së, si organ kompetent për miratimin e akteve nënligjore të ARH-së. Pasi që Bordi është



emëruar në fund të vitit 2016 dhe ka filluar punën, kjo draft Rregullore është dërguar në Bord për konsultime dhe miratim.

Po ashtu si Departament Ligjor gjatë vitit 2016 kemi përgatitur një kornizë ligjore për ARH-në, qëllimi i së cilës ka qenë pasqyrimi i gjendjes faktike rreth akteve nënligjore në fuqi, atyre të draftuara si dhe akteve nënligjore të cilat pritet që të draftohen. Pjesë e kësaj kornize ligjore ka qenë edhe lista me akte nënligjore specifike të cilat duhet të miratohen sipas prioriteteve si dhe draftimi i atyre që nuk janë përgatitur. Në këtë pikë vlen të theksohet fakti se kemi pasur një sfidë jashtëzakonisht të madhe dhe e cila ka reflektuar edhe në punën e ARH-së sa i përket nxjerrjes së akteve nënligjore, pasi që ka qenë një konflikt i kompetencave mes dy institucioneve se kush ka të drejtë dhe detyrë që të nxjerrë aktet nënligjore. ARH gjithnjë ka insistuar se për fushat që i mbulon e që janë: Licencimi, Siguria, Rregullimi i Tregut si dhe Ineroperabiliteti është detyrë dhe përgjegjësi e ARH-së, bazuar në nenin 38.2 të Ligjit për Hekurudhat e Kosovës.

Ngjashëm sikurse në vitet paraprake, Departamenti Ligjor ka qenë i angazhuar rreth aktiviteteve të ARH-së, të cilat ndërlidhen me procesin e integriteteve Evropiane të Republikës së Kosovës. Këta aktivitete kanë qenë kryesisht të fokusuar në:

- Përgatitja e raporteve tre mujore lidhur me zbatimin e Planit Kombëtar për Marrëveshjen e Stabilizim Asociimit. Obligime të cilat parashihen me këtë marrëveshje në rrugën e Kosovës drejtë integriteteve evropiane;
- Përgatitjen dhe dërgimin e Narrativit për takimin e DPSA-së në Bruksel tek Komisioni Evropian, për raportim të drejtpërdrejtë për sektorin hekurudhor në Republikën e Kosovës;
- Plotësimi i dokumentacionit të nevojshëm që ndërlidhen me Samitin e Vjenës për marrjen e masave të buta në sektorin hekurudhor në Evropën Juglindore, pjesë e së cilës është edhe Republika e Kosovës. Me theks të veçantë kemi shpjeguar bazën ligjore dhe procedurat për njohjen e licencës për Ndërmarrje Hekurudhore, Menaxherët e Infrastrukturës dhe Makinistë. Kjo pasi që një gjë e tillë është kërkuar që të raportohet në Samitin e Vjenës;



- Përgatitja e Narrativëve së bashku me veprimet pasuese për vitin 2016, në kuadër të procesit integrues, të parapara me Marrëveshjen e Stabilizim Asocimit mes Kosovës dhe Bashkimit Evropian.
- Gjithashtu e kemi koordinuar dhe mbikëqyrur masave afatshkurta legislative për vitin 2016 të parapara në Matricën e vitit 2016, ku një gjë e tillë është bërë në koordinim të plotë me Ministrin e Integriteteve si dhe Komisionin Evropian.
- Gjatë gjithë vitit 2016 kemi qenë në kontakt dhe të angazhuar drejtpërsëdrejti lidhur me aktivitetet dhe kërkesat e SEETO-s për sektorin hekurudhor në Evropën Juglindore.

Aktivitet tjetër me rëndësi që Departamenti Ligjor gjatë vitit 2016 ka qenë realizimi, komentimi dhe ofrimi i këshillave ligjore lidhur me draft Rregulloret e Departamenteve tjera profesionale në kuadër të ARH-së. Ndër draft Rregulloret të cilat janë analizuar dhe komentuar gjatë vitit 2016 kanë qenë:

- Draft Rregulloren për Raportim për Monitorim të Tregut;
- Draft Rregulloren për Metodën e Përbashkëta të Sigurisë (MPS) për Vlerësim dhe Llogaritje të Rrezikut; si dhe
- Draft Rregulloren për Ndërtim, Përmirësim, Rinovim, Vlerësim të Konformitetit dhe Autorizimit për Vendors në Shërbim të Mjetit Lëvizës.

Departamenti Ligjor gjatë vitit 2016 ka përcjell me kujdes zbatimin e akteve nënligjore të mëposhtme që ARH ka nxjerr gjatë viteve të mëhershme, siç janë:

- Udhëzimi Administrativ Nr. 02/2012 për Licencimin e Ndërmarrjeve Hekurudhore
- Udhëzimi Administrativ Nr. 03/2012 për Licencimin e Menaxherëve të Infrastrukturës;
- Udhëzimi Administrativ Nr. 04/2012 për Dhënien e Certifikatës dhe Autorizimit të Sigurisë për Ndërmarrjet Hekurudhore dhe Menaxherët e Infrastrukturës Hekurudhore
- Rregulloren Nr. 01/2012 për Licencimin e Menaxherëve dhe Ndërmarrjeve Hekurudhore;
- Rregullore Nr. 03/2012 për Certifikatat e Sigurisë;
- Rregullore Nr. 04/2012 për Autorizimin e Sigurisë;



- Rregullore Nr. 05/ 2012 për Regjistrin Nacional të Mjeteve Lëvizëse Hekurudhore;
- Rregullore Nr. 06/ 2012 për Regjistrimin e Infrastrukturës;
- Rregulloren 01/2013 për Ekspozeun e Rrjetit; dhe
- Rregulloren 02/2013 për Licencimin e Makinistëve.

Departamenti Ligjorë do të vazhdojë përkushtimin maksimal që të sigurojë ligjshmërinë në zbatimin e gjitha akteve nënligjore të nxjerra nga ARH-ja, në mënyrë që sektori hekurudhor në Republikën e Kosovës të rregullohet dhe mbikëqyret konform praktikave më të mira rajonale dhe ato të Bashkimit Evropian. Për vitin 2017 kemi paraparë një agjendë konkrete dhe dinamike në hartimin dhe nxjerrjen e akteve nënligjore të nevojshme për rregullimin dhe mbikëqyrjen e sektorit hekurudhor nga ana e ARH-së. Një gjë e tillë do jetë e mundur meqenëse Bordi i ARH-së si organ kompetent për nxjerrjen e akteve nënligjore është funksional.



6.3. DEPARTAMENTI I SIGURISË

Raporti vjetor i punës i paraqitur në vazhdim është raporti i pestë me radhë i punuar nga Departamenti i Sigurisë. Raporti paraqet aktivitetet dhe të arriturat kryesore gjatë vitit 2016.

Departamenti i Sigurisë hekurudhore duke u bazuar në ligjin Nr. 04/L-063 neni 20, për hekurudhat në Republikën e Kosovës, si dhe Direktivës Evropiane Nr. 2004/49/EC neni 18, Organi përgjegjës për sigurinë hekurudhore, respektivisht Departamenti i Sigurisë ka për detyrë që të përpilojë një raport vjetor të punës së departamentit, ku përshkruhen aktivitetet dhe të arriturat kryesore gjatë vitit paraprak.

6.3.1. Detyrat dhe përgjegjësitë

Sipas Ligjit për Hekurudha Nr. 04/L-06, Departamenti i Sigurisë është përgjegjës për:

- | Autorizimin për futjen në shërbim të nën sistemeve strukturale;
- | Mbikëqyrja nëse përbërësit e interoperabilitetit të nënsistemeve hekurudhore janë në përputhje me kërkesat esenciale të kërkuara nga direktivat për Interoperabilitet;
- | Autorizimin e futjes në shërbim të mjeteve të reja lëvizëse;
- | Lëshimin, përtëritjen, amendamentimin dhe revokimin e certifikatave/ autorizimeve të sigurisë;
- | Monitorimi, promovimi, zbatimi dhe kur është e duhur bërja e propozimeve për të zhvilluar raporte të afërta pune me Ministrinë dhe pjesëmarrësit e tjerë të tregut;
- | Mbikëqyrja se a janë të regjistruara mjetet lëvizëse dhe nëse informacioni që ka të bëjë me sigurinë në regjistrin nacional është i azhurnuar;
- | Mbikëqyrja se a mbahet dhe azhurnohet rregullisht regjistri i pronarëve të mjeteve transportuese hekurudhore;
- | Mbikëqyrja se a mbahet dhe azhurnohet rregullisht regjistri i infrastrukturës;



6.3.2. Aktivitetet e Departamentit të Sigurisë

Departamenti i Sigurisë punën dhe aktivitetin e vet gjatë vitit paraprak e ka bazuar në planin vjetor të përgatitur nga ana jonë, ky plan ka qenë i fokusuar në disa shtylla kryesore të cilat kanë qenë:

- Përgatitja e një pjesë të legjislacionit sekondar (akteve nënligjore);
- Shqyrtimi i aplikacionit për dhënien e certifikatës së sigurisë për operatorin privat Railtrans;
- Organizimi i misionit të ekspertit për shqyrtimin e aplikacionit për certifikatë të sigurisë të kompanisë Railtrans;
- Shqyrtimi i aplikacioneve për dhënien e autorizimit për futjen në shërbim të mjeteve lëvizëse të kompanive Infrakos, Trainkos dhe Railtrans;
- Organizimi i misionit të ekspertëve për procedurat e dhënies së autorizimit për futjen në shërbim të mjeteve lëvizëse dhe infrastrukturës;
- Përgatitja e raportit vjetor të sigurisë për vitin 2015;
- Inspektimi i infrastrukturës hekurudhore në menaxhim të Infrakos-it;
- Inspektimi i mjeteve lëvizëse hekurudhore në menaxhim të Infrakos-it;
- Inspektimi i mjeteve lëvizëse hekurudhore në menaxhim të Trainkos-it;
- Inspektimi i mjeteve lëvizëse hekurudhore në menaxhim të Ferronikelit;
- Pjesëmarrja në trajnime të organizuara nga institucionet vendore dhe nga partnerët evropian;

6.3.2.1. Përgatitja e raportit vjetor i punës

Bazuar në Ligjin Nr. 04/L-063, për Hekurudhat në Republikën e Kosovës, neni 20, paragrafi 1 thotë se: Organi Përgjegjës për Sigurinë Hekurudhore duhet të përpiloj raportin vjetor në lidhje me sigurinë të cilin ia paraqet ARH.

Në raportin e punës për vitin paraprak ne kemi përfshirë pothuajse të gjitha aktivitetet të cilat janë ndërmarrë nga Departamenti i Sigurisë, aktivitetet këto të parapara me planin e punës për vitin për të cilin është raportuar.



6.3.2.2. Përgatitja e një pjesë të legjislacionit sekondar

Detyrë tjetër të cilën jemi munduar që në një masë të konsiderueshme ta plotësojmë është edhe përgatitja e një pjesë të legjislacionit sekondar (akteve nënligjore) gjatë periudhës raportuese. Gjatë kësaj kohe ne duke u bazuar në prioritetet tona kemi arritur të përgatitim dy draft rregullore për të cilat kemi menduar se janë të rëndësishme për funksionimin e sektorit hekurudhor në Kosovë. Këto dy rregullore janë të gatshme për aprovim nga Bordi Mbikëqyrës i ARH-së.

1. Draft Rregullore Nr. xx/2016 Rregullore për Ndërtim, Përmirësim, Rinovim, Vlerësim të Konformitetit dhe Autorizimin për Vendosjen në Shërbim të Mjetit Lëvizës, dhe
2. Draft Rregullore Nr. xx/2016, Metodatat e Përbashkëta të Sigurisë (MPS), për Vlerësim dhe Llogaritje të Rrezikut.

Kurse sa i përket përgatitjes së rregulloreve për rregullat nacionale të sigurisë, ka qenë kërkesë nga takimi i fundit që është mbajtur në Unionin Evropian Agjensionin për Hekurudha, që ata një herë të shqyrtojnë të gjitha rregulloret të cilat janë përdorur në ish Jugosllavi, bazuar në këtë të krijohet një grup punuës nga të gjitha vendet e IPA-s me qëllim të përgatitjes së rregullave nacionale të sigurisë të cilat do të vlenin për të gjitha shtetet të përfshira në programin e IPA-s, kjo pasi që edhe rregulloret të cilat janë në përdorim në këto vende janë afërsisht të njëjta.

6.3.2.3. Shqyrtimi i aplikacionit për dhënien e certifikatës së sigurisë për operatorin privat Railtrans dhe organizimi i misionit të ekspertit për shqyrtimin e aplikacionit për certifikatë të sigurisë të kompanisë Railtrans

Një ndër pikat e agjendës së paraparë për vitin e kaluar ka qenë edhe shqyrtimi i aplikacioneve për marrjen e certifikatës së sigurisë nga ndërmarrjet hekurudhore të cilat posedojnë një licencë valide të lëshuar nga Departamenti i Licencimit. Pasi që ky proces ka zgjatur me tepër se sa që është e paraparë me ligjin Nr. 04/L-063 dhe rregulloren Nr. 02/2012, e shohim të arsyeshme që të sqarohet shkaku i

Railtrans L.L.C me datë: 02.02.2016 ka aplikuar për Certificate te Sigurisë pjesa A dhe B

vonesës në dhënien e certifikatës së sigurisë pjesa A dhe B për kompaninë



Railtrans. Ndërmarrja hekurudhore për transportin e mallrave Railtrans më datë: 02.02.2016 ka aplikuar për certifikatë të sigurisë pjesa A dhe B te Autoriteti Rregullativ i Hekurudhave.

Kompania Railtrans me qëllim të përgatitjes së dokumentacionit për marrjen e certifikatës së sigurisë pjesa A dhe B, ka mbajtur disa takime paraprake me Departamentin e Sigurisë para aplikimit për certifikatë të sigurisë. Këto takime janë mbajtur në ARH më datë: 08.01.2016, 18.01.2016 dhe 01.02.2016, ku i janë sqaruar përfaqësuesit të Railtrans për të gjithë dokumentacionin e nevojshëm i cili duhet ti bashkëngjitet aplikacionit për certifikatë të sigurisë.

Bazuar në Ligjin 04/L-063 për Hekurudhat e Kosovës, në Rregulloren e ARH-së Nr. 02/2012, për Kriteret për Dhënien e Certifikatës së Sigurisë si dhe Direktivës Evropiane me Nr. 2004/49/EU për Sigurinë Hekurudhore, Departamenti i Sigurisë ka filluar me shqyrtimin e dokumentacionit të ofruar nga kompania hekurudhore Railtrans.

Duke e vlerësuar këtë aplikacion si shumë të rëndësishëm dhe si çështje të ndjeshme, pasi që ishte hera e parë që ne kemi një aplikim nga një operator privat, kemi vlerësuar se do të ishte e nevojshme që të bëhet një kërkesë në TAIEK për dërgimin e një eksperti i cili do të na ndihmonte në vlerësimin e këtij aplikacioni.

Më datë: 10.02.2016, kryesuesi i departamenti të sigurisë ka bërë një kërkesë zyrtare në TAIEK, që të kemi një ekspert nga Bashkimi Evropian i cili do të ndihmonte gjatë procesit të vlerësimit të dokumentacionit, me qëllim eliminimin e gabimeve eventuale, si dhe kemi kërkuar që në fund të procesit të kemi një rekomandim nga eksperti për aplikacionin e operatorit privat.



TAIEK Expert Mission on Evaluation of Certificate Application for a New Entrant

Duke parë ndjeshmërinë e aplikacionit dhe nevojën për një vlerësim konform legjislacionit në fuqi në Kosovë si dhe atij evropian, Komisioni Evropian për një afat të shkurtër (15 ditë) ka vlerësuar dhe ka vendosur që ta mbështesë kërkesën e Departamentit të Sigurisë dhe më datë: 24.02.2016 kemi pranuar konfirmimin se kërkesa jonë është pranuar.



Pas disa përpjekjeve të TAIEX që të gjejë një ekspert të cilin e kemi kërkuar ne, më datë: 04.05.2016 kemi pranuar konfirmimin se do të na vijë një ekspert nga Mbretëria e Bashkuar, respektivisht nga ORR (Office of Rail & Road). Ne pas disa përpjekjeve dhe komunikimeve me ekspertin nga ORR kemi arritur që ta gjejmë një datë të përshtatshme për ekspertin e cila është propozuar të jetë 6 dhe 7 qershor 2016.

Më datë: 09.06.2016, draft Vendimi për marrjen e Certifikatës së Sigurisë pjesa A dhe B

Në datat e cekura më lartë kemi pasur ekspertin nga ORR

(Russell Keir), me të cilin për dy ditë me radhë kemi analizuar aplikacionin e operatorit privat Railtrans. Në fund të ditës së dytë dhe pas analizimit të hollësishëm të aplikacionit për certifikatë të sigurisë kemi arritur deri te vlerësimi se operatori privat i ka plotësuar kushtet për marrjen e certifikatës së sigurisë pjesa A dhe B, por të kushtëzuara.

Kompania Railtrans duhet që në afat prej një viti pas fillimit të operimit të sjell në ARH një sistem të përditësuar të SMS (Sistemi për Menaxhimin e Sigurisë), të dëshmojë se kompania është duke e implementuar SMS. Nëse Railtrans dështon në përmbushjen e këtij kushti në një afat prej një viti nga fillimi i operimit, atëherë ARH do të marrë në konsideratë revokimin e certifikatës së sigurisë (pjesa A dhe B).

Në të kaluarën ka qenë praktikë që të gjitha vendimet e departamenteve profesionale për autorizim dhe certifikatë të sigurisë janë miratuar një herë nga Bordi Mbikëqyrës dhe mandej janë nënshkruar nga departamenti. Në rastin tonë ne nuk kishim Bord Mbikëqyrës qysh prej muajit prill 2014, prandaj çështja e dhënies së certifikatës së sigurisë për kompaninë Railtrans dukej më e komplikuar.

Pas opinionit ligjor të zyrës ligjore të ARH-së, lidhur me atë se a kemi të drejtë që ne të japim certifikatën e sigurisë edhe pa miratim të bordit mbikëqyrës, ne vendosëm që të japim vetëm një draft Vendim për marrjen e Certifikatës së Sigurisë pjesa A dhe B.



Në një takim të organizuar me kompaninë Railtrans, i sqaruam në hollësi se si ka ardhur deri te ky draft vendim si dhe arsyen pse nuk kemi një vendim. Duke marrë parasysh seriozitetin e situatës, departamenti i sigurisë propozoi që nëpërmjet drejtorit të përgjithshëm të ARH të kërkojmë interpretim nga zyra ligjore e Ministrisë së Infrastrukturës si dhe nga ajo e Kuvendit të Kosovës, me pyetjen: Çka nënkupton mbikëqyrja e Bordit Mbikëqyrës të ARH-së dhe a mundet Departamenti i Sigurisë pa aprovimin e Bordit Mbikëqyrës të ARH-së të vazhdojë me dhënien e vendimit dhe Certifikatës së Sigurisë për kompaninë Railtrans.

Më datë: 07.09.2016 morëm përgjigje se: Drejtoria e Përgjithshme për Çështje Ligjore dhe Procedurale e Kuvendit të Republikës së Kosovës nuk ka kompetencë të bëjë interpretimin e dispozitave të ligjit.

Më datë: 03.10.2016 nga Ministria e Infrastrukturës morëm përgjigjen se: Autoriteti Rregullativ i Hekurudhave është organ i pavarur i themeluar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës që rregullon dhe mbikëqyrë sektorin e hekurudhave në përputhje me legjislacionin në fuqi në Kosovë dhe me legjislacionin në fuqi të BE-s

i | **Më datë : 04.10.2016 kemi dhënë Certifikatën e Sigurisë pjesa A dhe B për kompaninë Railtrans.**

gjithashtu edhe emërimi i Bordit të ARH-së është i emëruar nga Kuvendi i Kosovës. Andaj interpretimin e kërkesës tuaj ju sugjerojmë që ta adresoni në organin kompetent.

Duke u bazuar në tre interpretimet (opinionet) ligjore të lartcekura, departamenti i sigurisë bazuar në ligjin 04/L-063, nenin 18 paragrafin 3.4 si dhe nenin 104,

Më datë: 06.09.2016 kemi kërkuar interpretim ligjor nga Ministria e Infrastrukturës dhe nga Kuvendi i Kosovës

paragrafin 6 dhe nenin 38, paragrafin 6, mori vendim që më datë: 03.10.2016 të japë Certifikatën e Sigurisë për operatorin privat

Railtrans, sipas kushteve të parapara në draft vendimin e datës: 09.06.2016. Kurse më datë: 04.10.2016 kemi dhënë Certifikatën e Sigurisë për kompaninë Railtrans.



Republika e Kosovës-Republika Kosova-Republic of Kosovo
Autoriteti Rregullativ i Hekurudhave
Regulativni Autoritet Železnica
Railway Regulatory Authority



CERTIFIKATA E SIGURISË-PJESA A

Certifikata e Sigurisë që konfirmon pranimin e Sistemit të Menaxhimit të Sigurisë në përputhje me Ligjin Nr. 04/L-063 për Hekurudhat e Kosovës, udhëzimin përkatës administrativ 04/2012 dhe rregulloren 03/2012, në përputhje me Direktiven 2004/49/KE

Nr. Identifikues: KS 11 2016 0001

1. NDËRMARRJA E CERTIFIKUAR HEKURUDHORE

Emërtimi Ligjor: "Railtrans" L.L.C.	
Emri i operatorit hekurudhor: "Railtrans" L.L.C.	Shkurtesë: Railtrans L.L.C.
Nr. i Biznesit: 70487616	Nr. i Tvsh: 330017469

2. CERTIFIKATA E LËSHUAR NGA INSTITUCIONI

Institucioni: Autoriteti Rregullativ i Hekurudhave	
Shteti: Republika e Kosovës	

3. INFORMATAT E CERTIFIKATËS

Kjo është një:	-Certifikatë e re	☒	
	-Certifikatë e rinovuar	☐	Numri i identifikimit të Certifikatës së më parshme:
	-Certifikatë e ndryshuar	☐	
E vlefshme nga: 04.10.2016	Deri: 03.10.2021		
Lloji i shërbimeve: Transporti i mallrave: Duke përfshirë shërbimet për mallra të rrezikshme (2.10)			
Vëllimi i transportit: Me pak se 500 milion ton-km për vitet (2.12)			
Madhësia e ndërmarrjes hekurudhore: Ndërmarrje e vogël (2.17)			

4. LEGJISLACIONI NACIONAL NË FUQI

Ligjislacioni në fuqi: Ligji Nr. 04/L-063, Udhëzimi Administrativ Nr. 04/2012 dhe Rregullores Nr. 02/2012

5. INFORMATAT SHITESË

Operatori hekurudhor "Railtrans" L.L.C. obligohet që në afat prej 12 muaj, nga data e fillimit të operimeve të punojë dhe sjell në ARH, Sistemin e detajuar për Menaxhimin e Sigurisë (SMS)

Data e lëshimit

04.10.2016

Numri i brendshëm i referencës

CER 01/2016



Kuvendi i Kosovës
Skupština Kosova
Assembly of Kosovo

Rr. Bristem Statistiki nr.29
Prishtinë, Kosovë
Tel:+381 38 22 00 40
Fax:+381 38 22 33 40
www.arh-ks.org



Republika e Kosovës-Republika Kosova-Republic of Kosovo
Autoriteti Rregullativ i Hekurudhave
Regulativni Autoritet Železnica
Railway Regulatory Authority



CERTIFIKATA E SIGURISË-PJESA B

Certifikata e Sigurisë që konfirmon pranimin e dispozitave të miratuara për ndërmarrjet hekurudhore me qëllim përmbushjen e kërkesave specifike për operim të sigurt në rrjetin përkatës në përputhje me Ligjin Nr. 04/L-063 për Hekurudhat e Kosovës, udhëzimin përkatës administrativ 04/2012 dhe rregulloren 03/2012, në përputhje me Direktiven 2004/49/KE

Nr. Identifikues: KS 12 2016 0001

1. NDËRMARRJA E CERTIFIKUAR HEKURUDHORE

Emërtimi Ligjor: "Railtrans" L.L.C.	
Emri i operatorit hekurudhor: "Railtrans" L.L.C.	Shkurtesë: "Railtrans" L.L.C.
Nr. i Biznesit: 70487616	Nr. i Tvsh: 330017469

2. CERTIFIKATA E LËSHUAR NGA INSTITUCIONI

Institucioni: Autoriteti Rregullativ i Hekurudhave	
Shteti: Republika e Kosovës	

3. INFORMATAT E CERTIFIKATËS

Kjo është një:	-Certifikatë e re	☒	
	-Certifikatë e rinovuar	☐	Numri i identifikimit të Certifikatës së më parshme:
	-Certifikatë e ndryshuar	☐	
E vlefshme nga: 04.10.2016	Deri: 03.10.2021		
Lloji i shërbimeve: Transporti i mallrave: Duke përfshirë shërbimet për mallra të rrezikshme (3.10)			

4. CERTIFIKATA E SIGURISË-PJESA A (Pranimi i Sistemit për Menaxhimin e Sigurisë)

Numri i Identifikimit: KS 11 2016 0001

5. LINJAT E OPERIMIT

Te gjitha linjat ekzistuese në territorin e Republikës së Kosovës

6. KUSHTET E VEÇANTA DHE DETYRIMET

Nuk ka

7. LEGJISLACIONI NACIONAL I APLIKUESHËM

Ligjislacioni në fuqi: Ligji Nr. 04/L-063, Udhëzimi Administrativ Nr. 04/2012 dhe Rregullores Nr. 02/2012

Data e lëshimit

04.10.2016

Numri i brendshëm i referencës

CER 01/2016



Kuvendi i Kosovës
Skupština Kosova
Assembly of Kosovo

Rr. Bristem Statistiki nr.29
Prishtinë, Kosovë
Tel:+381 38 22 00 40
Fax:+381 38 22 33 40
www.arh-ks.org



6.3.2.4. Shqyrtimi i aplikacioneve për dhënien e autorizimit për futjen në shërbim të mjeteve lëvizëse të kompanive Infrakos, Trainkos dhe Railtrans

Gjatë vitit 2016 kemi punuar dhe shqyrtuar disa aplikacione për marrjen e autorizimit për futjen në shërbim të mjeteve lëvizëse në pronësi të Infrakos-it, Trainkos-it dhe Railtrans-it. Të gjitha procedurat për dhënien e autorizimit për futjen në shërbim të mjeteve lëvizëse të përshkruara më poshtë janë kryer duke u bazuar në Ligjin Nr. 04/L-063, neni 18, neni 109, neni 110 për Hekurudhat në Republikën e Kosovës, si dhe Direktivat Evropiane: Nr. 2004/49/EU, 2008/57/EU për këtë fushë.

Mjetet lëvizëse të autorizuar për tu futur në shërbim nga Departamenti i Sigurisë gjatë këtij viti kanë qenë gjithsej 10 copë siç janë:

1. Infrakos më datë 15.12.2015 ka aplikuar për marrjen e autorizimit për futjen në shërbim të 5 (pesë) Drezina të lehta, të tipit LMD-9, "Light Track Motor Car", nga prodhuesi MINDIV-Svrljig, të cilat përdoren për transport të punëtorëve dhe mjeteve të punës në vend punime, si dhe për inspektime të cilat kryhen nga Departamenti i Mirëmbajtjes-Infrakos.
2. Infrakos më datë 15.12.2015 ka aplikuar për marrjen e autorizimit për futjen në shërbim të 3 (tre) Valter "ZTK-10", të cilët përdoren për ngarkim, zbarkim dhe transport të shinave nga Departamenti i Mirëmbajtjes-Infrakos.
3. Trainkos më datë: 11.03.2016 ka aplikuar për marrjen e autorizimit për futjen në shërbim të 1 (një) Lokomotive dizel-elektrike për transport të kombinuar udhëtar-mallra.
4. Railtrans më datë: 22.06.2016 ka aplikuar për marrjen e autorizimit për futjen në shërbim të 1 (një) Lokomotive dizel-hidraulike me numër serik 55-230, për transport të mallrave.

Qysh në fillim të vitit 2016 kemi filluar me analizimin e të gjithë dokumentacionit të ofruar nga Infrakos për 5 (pesë) Drezina të lehta, të tipit LMD-9, si dhe pas shqyrtimit të hollësishëm kemi arritur në vlerësimin se të gjitha kërkesat ligjore janë përmbushur, dhe në këtë mënyrë me datë: 26.02.2016, kemi bërë lëshimin e Autorizimit për futjen në shërbim për 5 (pesë) Drezina të lehta, të tipit LMD-9.

Gjithashtu paralelisht kemi vazhduar edhe me vlerësimin e të gjithë dokumentacionit të ofruar nga Infrakos për 3 (tre) Valter "ZTK-10", si dhe pas shqyrtimit të hollësishëm kemi arritur në vlerësimin se të gjitha kërkesat ligjore janë përmbushur dhe në këtë mënyrë më datë: 26.02.2016 kemi bërë lëshimin e Autorizimit për futjen në shërbim për 3 (tre) Valter "ZTK-10".



Pas marrjes së kërkesës nga Trainkos për marrjen e autorizimit për futjen në shërbim për lokomotivën dizel-elektrike më datë: 11.03.2016, e cila parashihet të përdoret për transport të kombinuar udhëtar-mallra, kemi filluar me vlerësimin paraprak të dokumentacionit të dorëzuar nga ana e operatorit me trena Trainkos. Pasi që ne kemi vlerësuar se të gjitha kërkesat ligjore për marrjen e autorizimit për futjen në shërbim të lokomotivës për transport të kombinuar udhëtar-mallra janë përmbushur, më datë: 06.05.2016 Departamenti i Sigurisë ka dhënë autorizimin për futjen në shërbim të lokomotivës së cekur më lartë.

Më datë: 06.05.2016, kemi dhënë Autorizimin për futjen në shërbim për lokomotivën dizel-elektrike

Gjithashtu Departamenti i Sigurisë më datë: 22.06.2016, ka pranuar një aplikacion për marrjen e autorizimit për futjen në shërbim të 1 (një) lokomotive dizel-hidraulike me numër serik 55-230, për transport të mallrave në pronësi të Railtrans-it. Menjëherë pas marrjes së aplikacionit nga kompania Railtrans, kemi filluar me shqyrtimin e të gjithë dokumentacionit të ofruar duke bërë një vlerësim paraprak të aplikacionit dhe kemi kontrolluar të gjithë dokumentacionin e ofruar nga operatori privat. Ne më datë 25.07.2016, kemi kërkuar që të na ofrohet dokumentacion shtesë për disa teste, për të cilat kemi vlerësuar se janë të domosdoshme për përfundimin e vlerësimit të aplikacionit në tërësi. Nga kompania Railtrans më datë: 28.09.2016 kemi pranuar dokumentacionin e kërkuar nga ana e jonë, si dhe pasi që ne kemi vlerësuar se janë plotësuar të gjitha kushtet që të japim autorizimin për futjen në shërbim për lokomotivën dizel -hidraulike në pronësi të operatorit privat Railtrans dhe më datë: 06.10.2016 kemi dhënë autorizimin për lokomotivën e cekur më lartë.

Më datë: 06.10.2016, kemi dhënë Autorizimin për futjen në shërbim për lokomotivën dizel-hidraulike

Më datë: 26.02.2016, kemi dhënë Autorizimin për futjen në shërbim për 3 (tre) Valter "ZTK-10"

Me datë: 26.02.2016, kemi dhënë Autorizimin për futjen në shërbim për 5 (pesë) Drezina të lehta, të tipit LMD-9



6.3.2.5. Organizimi i misionit të ekspertëve për procedurat e dhënies së autorizimit për futjen në shërbim të mjeteve lëvizëse dhe infrastrukturës

Bazuar në nevojën tonë për të pasur njohuri të reja nga personat kompetent (ekspert), ne më datë: 01.09.2015 kemi aplikuar në TAIEK për një mision të ekspertëve duke përfshirë edhe vizitën studimore në njërin nga shtetet anëtare të BE-së me temën „Autorizimi për Futje në Shërbim të Infrastrukturës dhe Mjeteve Lëvizëse„. Kjo kërkesë është mbështetur dhe financuar nga Komisioni Evropian dhe ne më datë: 30-31.03.2016 kemi mbajtur një trajnim dy ditor me ekspertet e misionit të TAIEK-it Pierre Desfray, nga agjensioni i sigurisë hekurudhore (EPSF) si dhe Christian Weber hekurudhat shtetërore të Francës (SNCF). Tema e trajnimit ishte autorizimi për futje në shërbim të infrastrukturës dhe mjeteve lëvizëse, duke u bazuar në praktikën dhe legjislacionin në fuqi në Kosovë si dhe atë Evropian. Temat kryesore të trajtuara në këtë trajnim kanë qenë: Parimet e sigurisë, interoperabilitetit, shembuj praktik të autorizimeve për futjen në shërbim të infrastrukturës dhe mjeteve lëvizëse, ndryshimet në pakon e katërt hekurudhore, sistemet dhe nënsistemet hekurudhore, dokumentet e nevojshme për aplikim për marrjen e autorizimit të futjes në shërbim etj.

6.3.2.6. Përgatitja e raportit vjetor të sigurisë për vitin 2015

Raporti vjetor i sigurisë është një raport i përvitshëm, i cili duhet të përgatitet nga organi përgjegjës për sigurinë hekurudhore. Bazuar në ligjin Nr. 04/L-063, neni 20, paragrafi 1 Organi Përgjegjës për Sigurinë Hekurudhore duhet të përpilojë raportin vjetor në lidhje me sigurinë të cilin ia paraqet ARH.

Gjithashtu sipas ligjit Nr. 04/L-063, neni 103, paragrafi 6 thotë: Çdo vit, të gjithë menaxheret e infrastrukturës (MI) dhe ndërmarrjet hekurudhore (NH) para 30 qershorit duhet të paraqesin raportin vjetor të sigurisë në lidhje me vitin kalendarik të mëparshëm te organi përgjegjës për sigurinë, gjithashtu përgatitja e raportit vjetor të sigurisë është e paraparë edhe në direktivën Nr. 2004/49/EC, nenin 9 paragrafi 4.

Raporti vjetor i përgatitur nga organi i sigurisë hekurudhore bazohet në të dhënat e dorëzuara në raportet e sigurisë të MI dhe NH, si dhe nga aktivitetet e organit të sigurisë nga viti paraprak.

Ky raport përshkruan informatat e sigurisë lidhur me zhvillimet që kanë të bëjnë me sigurinë hekurudhore, ndryshimet në legjislacion, zhvillimet që kanë të bëjnë



me certifikatën e sigurisë dhe autorizimin e sigurisë, raportet nga mbikëqyrja e menaxherit të infrastrukturës dhe të ndërmarrjeve hekurudhore, mirëmbajtjen e infrastrukturës dhe mjeteve lëvizëse etj.

Duke përfillur afatet ligjore të përcaktuara me ligjin për hekurudha si dhe me direktivën e sigurisë, Departamenti i Sigurisë ka përgatitur raportin Vjetor të Sigurisë dhe ka dërguar të Drejtori i Përgjithshëm i ARH-se brenda afateve të përcaktuara ligjore, pra deri më 30.09.2016.

6.3.2.7. Inspektimi i infrastrukturës hekurudhore në menaxhim të Infrakos-it

Inspektimin e infrastrukturës hekurudhore në menaxhim të menaxherit të infrastrukturës hekurudhore Infrakos e kemi filluar në muajin prill dhe kemi përfunduar në muajin nëntor 2016. Gjatë procesit të inspektimit jemi munduar që të përfshijmë pothuajse të gjithë faktorët të cilët direkt apo indirekt kanë të bëjnë me sigurinë në hekurudha. Janë inspektuar Stacionet, Sinjalizimi, Ndërrueset, Traversat, Rampat, Kalimet në nivel (kryqëzimet rrugë-hekurudhë), Urat, Tunelet, Ndriçimin, Balastin, Mirëmbajtja pranë vijës hekurudhore etj. Linjat e inspektuara janë:

Më datë : 30.09.2016 kemi përfunduar dhe dorëzuar raportin vjetor të sigurisë për vitin paraprak

1. Prishtinë-Fushë Kosovë (29.04.2016)
2. Terminali i mallrave në Miradi (05.05.2016)
3. Fushë Kosovë-Magurë (06.05.2016)
4. Fushë Kosovë-Hani i Elezit (30.08.2016)
5. Prishtinë-Podujevë (21.09.2016)
6. Fushë Kosovë-Mitrovicë (23.09.2016)
7. Klinë-Prizren (26.09.2016) dhe
8. Fushë Kosovë-Pejë (21.11.2016)

Pas inspektimit të secilës linjë ne kemi përgatitur nga një raport lidhur me të gjeturat gjatë inspektimit, në raport jemi fokusuar që të evidentojmë jo vetëm mangësitë të cilat ekzistojnë në secilën linjë veç e veç, por kemi evidentuar edhe punët të cilat janë kryer nga ana e kompanisë Infrakos. Sa i përket linjave pjesa e cila ka të bëjë me gjeometrinë e linjës, balastin, ndërrueset, sinjalizimi në stacione dhe traversat kryesisht janë të mirëmbajtura nga ana e Infrakos-it, kurse mbetet të punohet në sigurimin e vendkalimeve të cilat mbetën si me shqetësuese për



sigurinë hekurudhore. Shumë vendkalime shtrihen në vendbanime dhe frekuentimi nga ana e banorëve dhe automjeteve është i madh, por ka mungesa qoftë të sinjalizimit me shenja të komunikacionit rrugor apo sigurimi me semafor apo barriera (rampë) në disa nga pikat me të rrezikshme të identifikuara nga ana e jonë.

6.3.2.8. Inspektimi i mjeteve lëvizëse hekurudhore në menaxhim të Infrakos

Inspektimin e mjeteve lëvizëse hekurudhore në menaxhim të menaxherit të infrastrukturës Infrakos kemi filluar dhe përfunduar në muajin tetor 2016.

Departamenti i Sigurisë në bazë të detyrave dhe përgjegjësisë ligjore dhe konform planit të punës ka paraparë Inspektimin e mjeteve lëvizëse duke u bazuar në Ligjin nr. 04/L-063 për Hekurudhat e Kosovës në neni 104 paragrafi 5.

Gjatë procesit të inspektimit jemi qe të përfshijmë pothuajse të gjithë mjetet lëvizëse të cilat përdorën nga Infrakos siç janë:

- Pllaser&Theurer (6 copë)
- Robeli (1 copë)
- Ekskavatori (1 copë)
- Vagoni Matës (1 copë)
- Atlas 1404ZW (1 copë)
- Iveco Daily Palfinger Kran (1 copë)
- Vagon sallon pune (1 copë)
- Vagon bot cisterna (1 copë)
- Motor i lehtë hekurudhorë-Drezinë (10 copë)
- Vallterë (6 copë) dhe
- Rimorkio (4 copë)

Janë inspektuar këta parametra të sigurisë: Trashësia e rrotave, Dimensionet e profilit të rrotave, Sistemi i frenimit, Papuçet e frenimit, Hapja dhe mbyllja e dyerve, Sistemi i ndriçimit, Buria dhe Radio Lidhja, Lidhëset e ajrit Çengeli etj.

Për të gjitha këto mjete lëvizëse hekurudhore është përgatitur nga një raport, ku kemi paraqitur të gjeturat gjatë procesit të inspektimit. Gjatë vitit 2017, ne do të mbikëqyrim implementimin e rekomandimeve të cilat ne i kemi paraqitur në raporte.



Në vazhdim është paraqitur raporti i inspektimit të dy pajisjeve për mirëmbajtën e linjave hekurudhore.

Të dhëna e paraqitura na janë ofruar nga përfaqësuesit Infracos-it, si dhe nga inspektimi që kemi kryer ne Departamenti i Sigurisë në kuadër të ARH-së.

6.3.2.9. Inspektimi i mjeteve lëvizëse hekurudhore në menaxhim të Trainkos

Inspektimin e mjeteve lëvizëse hekurudhore në menaxhim të kompanisë hekurudhore Trainkos e kemi realizuar gjatë muajve tetor-nëntor 2016.

Departamenti i Sigurisë ka kryer inspektimin e të gjitha mjeteve lëvizëse hekurudhore të cilat janë në Regjistrin Nacional të Mjeteve lëvizëse, në pronësi të Trainkos-it siç janë:

- Lokomotivat (11 copë)
- Lokomotivat Manovruese (17 copë)
- Trenat Motorik (7 copë)
- Vagonët e Udhëtarëve (21 copë)
- Vagonët e Mallrave dhe (6 copë)
- Vagonët e Mallrave jashtë funksionit (45 copë).

Ky inspektim është kryer në përputhje me ligjin Nr. 04/L-063 për hekurudhat e Republikës së Kosovës.

Ne për secilin mjet lëvizës të inspektuar kemi përgatitur nga një raport me të gjeturat gjatë kryesore inspektimit, në raport janë përfshirë vetëm disa nga të gjeturat për të cilat ne kemi menduar se janë me të rëndësishme.

Kemi identifikuar me fotografi dhe komente të gjeturat kryesore si dhe kemi dhënë disa rekomandime (komente) se çfarë duhet të ndërmerret më qëllim të përmirësimit të gjendjes ekzistuese.

Gjatë vitit 2017, ne do të mbikëqyrim implementimin e rekomandimeve të cilat ne i kemi paraqitur në raporte.

Në vazhdim do të paraqesim raportin e inspektimit vetëm për nga një lloji të mjeteve lëvizëse të inspektuara.

Të dhëna e paraqitura na janë ofruar nga përfaqësuesit Trainkos-it, si dhe nga inspektimi që kemi kryer ne-departamenti i sigurisë në kuadër të ARH-së.



6.3.2.10. Inspektimi i mjeteve lëvizëse hekurudhore në menaxhim të Ferronikelit

Inspektimin e mjeteve lëvizëse hekurudhore në menaxhim të kompanisë hekurudhore Trainkos, e kemi realizuar gjatë muajve nëntor-dhjetor 2016.

Departamenti i Sigurisë ka kryer inspektimin e të gjithë vagonëve të mallrave të cilët janë në Regjistrin Nacional të Mjeteve Lëvizëse dhe janë në pronësi të Ferronikelit-it.

Ky inspektim është kryer në përputhje me Ligjin Nr. 04/L-063 për Hekurudhat e Republikës së Kosovës.

Nëpër secilin vagon të mallrave të cilin e kemi inspektuar kemi përgatitur nga një raport me të gjeturat gjatë kryesore inspektimit, në raport janë përfshirë vetëm disa nga të gjeturat për të cilat ne kemi menduar se janë më të rëndësishme.

Me fotografi dhe komente kemi identifikuar të gjeturat kryesore si dhe kemi dhënë disa rekomandime (komente) se çfarë duhet të ndërmerret më qëllim të përmirësimit të gjendjes ekzistuese.

Gjatë vitit 2017 ne do të mbikëqyrim implementimin e rekomandimeve të cilat ne i kemi paraqitur në raporte.



6.4. DEPARTAMENTI I INTEROPERABILITETIT

Për të zhvilluar kornizën nacionale të interoperabilitetit hekurudhor, Departamenti i Interoperabilitetit është angazhuar maksimalisht dhe me përgjegjësi të lartë, në përputhje me Ligjin për Hekurudha dhe Direktivën e Interoperabilitetit. Si rezultat janë realizuar arritje dhe aktivitete të cilat paraqiten në vazhdim të këtij raporti.

Baza ligjore për përgatitjen e raportit vjetor 2016 është dhënë në nenin 29 (6) të Ligjit për Hekurudhat e Kosovës 04/L-063, i cili ka për qëllim të ofrojë një pasqyrë të zhvillimeve në fushën e interoperabilitetit hekurudhore.

Raporti mbulon të dhëna për vitin 2016 në formë të përmbledhur, të aktiviteteve dhe rezultateve që Departamenti i Interoperabilitetit brenda ARH-së ka zhvilluar për këtë periudhë.

Interoperabiliteti

Interoperabiliteti është një iniciativë e Bashkimit Evropian për promovimin e një tregu të vetëm në sektorin hekurudhor. Kjo iniciativë evropiane është e dizajnuar për të përmirësuar pozitën konkurruese të sektorit hekurudhor, kështu që ajo të mund të konkurrojë në mënyrë më efektive me format e tjera të transportit. Këtë e bënë përmes një kuadri rregullator që nxit harmonizimin teknik dhe standardizimin e hekurudhave të Evropës.

→ *Parashikon Standartet e Përbashkëta Teknike të quajtura Specifikime Teknike për Interoperabilitet STI, që të aplikohen në të gjithë sistemin hekurudhor*

6.4.1. Detyrat dhe përgjegjësitë

Në përmbushjen e përgjegjësiave të veta, departamenti udhëhiqet nga korniza ligjore që është përcaktuar me Ligjin për Hekurudhat e Kosovës Nr. 04/L-63 dhe sipas Dispozitave të Direktivës (EU) 2016/797/EU për Interoperabilitet dhe Direktivës 2004/49/EC për Siguri.

Si Departament brenda ARH-së është përgjegjës për t'i përcaktuar kushtet të cilat duhet t'i plotësojë sistemi hekurudhor në Kosovë për të arritur interoperabilitetin me sistemin hekurudhor të BE-së në drejtim të krijimit të hapësirës të interoperabilitetit Evropian, pjesë e së cilës dëshiron të jetë edhe Kosova.



Kushtet në lidhje me interoperabilitetin përmbajnë dizajnin, rindërtimin, futjen në shërbim, modernizimin, përtëritjen, operimin dhe mirëmbajtjen e pjesëve të sistemit e gjithashtu edhe kualifikimeve profesionale dhe kushtet e shëndetit dhe sigurisë së stafit i cili kontribuon në operimet dhe mirëmbajtjen e tij.

Departamenti ka për detyrë të hartojë legjislacionin sekondar në fushën e Interoperabilitetit hekurudhor i cili duhet të jetë në përputhje me standardet dhe rregullat evropiane të përcaktuara nga Direktivat për Interoperabilitet.

6.4.2. Aktivitetet e Departamentit të Interoperabilitetit

Legjislacioni në fuqi kërkon:

Harmonizimin e legjislacionit, rregullave dhe të standardeve në sektorin hekurudhor me ato të BE-së të përshtatshme për Kosovën në fushën e Interoperabilitetit.

Janë këto aktivitete të cilat paraqiten në vazhdim të këtij raporti:

6.4.2.1. Mjetet hekurudhore me pronësi të pa definuar MPPD

6.4.2.1.1. Kontrollimi i regjistrit MPPD dhe regjistrit NVR

Departamenti i Interoperabilitetit në fillim të vitit 2016 ka zhvilluar një kontroll që ka përfshirë regjistrin e mjeteve me pronësi të pa definuar i cili është realizuar në vitin 2015, përfshirë edhe atë të rregullt NVR. Kjo për faktin se Trainkos administron mjete të kategorisë me pronësi të pa definuar, ashtu sikurse Infrakos që për nevoja të kompanisë ka në dispozicion mjete hekurudhore të kësaj kategorie. Kontrolli ka pasur për qëllim përfshirjen e të gjitha mjeteve me pronësi të pa definuar që administrohen nga Trainkos dhe Infrakos në regjistrin e mjeteve të kësaj kategorie. Kontrolli që ka përfshirë edhe krahasueshmërin e dy regjistrave ka bërë që regjistri i mjeteve me pronësi të pa definuar, realizuar në 2015 të ketë nevojë për korrigjime.

ARH ka në dispozicion dy kategori të regjistrimit:

1. Regjistrimin e rregullt NVR realizuar në vitin 2012
 2. Regjistrimin e MPPD (mjeteve me pronësi të pa definuar) realizuar në vitin 2015
-



Duke u bazuar në rezultatet e dala nga ky kontroll (regjistrin NVR dhe regjistrin MPPD), ARH në bashkëpunim me Trainkos dhe Infrakos ka sistematizuar dhe qartësuar pozicionet e mjeteve nga dy kategoritë e lartcekura, për të filluar pastaj me inspektimin i cili duhet të këtë për bazë një regjistër të saktë të mjeteve me pronësi të pa definuar.

Si rezultat, regjistri i mjeteve me pronësi të pa definuar i realizuar në vitin 2015 pëson ndryshime, duke bërë që një numër i mjeteve nga regjistri NVR të bartet në regjistrin e mjeteve me pronësi të pa definuar (MPPB) dhe anasjelltas. Pas procesit të kontrollit të regjistrit të mjeteve me pronësi të pa definuar, përfshirë edhe atë të NVR-së, ARH saktëson sistematizimin e mjeteve hekurudhore dhe numrin e mjeteve për të cilat duhet të aplikohet regjistrimi. Me datë: 17.06.2016 grupi punues i përbërë nga ARH, Trainkos dhe Infrakos ka realizuar regjistrimin/modifikimin e mjeteve me pronësi të pa definuar për një numër mjetesh të kësaj kategorie.

6.4.2.1.2. Procesi i inspektimit të mjeteve me pronësi të pa definuar

Bazuar në regjistrimin e vitit 2015 dhe regjistrimet/modifikimet realizuar në qershor të 2016, Departamenti për Interoperabilitet me datë: 28.06.2016 ka filluar inspektimin e mjeteve të kësaj kategorie, duke përfshirë dhe krahasueshmërinë me regjistrin e rregullt NVR.0

Inspektimi është udhëhequr nga ARH, gjegjësisht Departamenti i Interoperabilitetit, përmes grupit punues i përbërë nga ARH- Trainkos-Infrakos. Procesi i inspektimit të mjeteve lëvizëse me pronësi të pa definuar ka zgjatur gjithsej dymbëdhjetë ditë përgjatë 4 muajve dhe ka përfunduar më datë: 14.09.2016. Gjithsejtë janë të inspektuara **509 mjete lëvizëse me pronësi të pa definuar**, të cilat ishin të sistemuara në lokacioneve të ndryshme brenda territorit të Republikës së Kosovës.

Në forme të përmbledhur tabelare janë paraqitur të gjitha MPPD të inspektuara, përfshirë datën e inspektimit dhe vendndodhjen (**tabela 1**)

**Tabela 1:** Datat e inspektimit dhe vendndodhja

Nr. ditëve	Data e Inspektimit	Sasia	Vendndodhja e ML-se
1	28.06.2016	72	Fushë Kosovë
2	29.06.2016	17	Fushë Kosovë
3	06.07.2016	69	Bardhë i Madh
4	11.07.2016	2	Fushë-Kosovë
5	13.07.2016	114	Miradi
6	15.07.2016	43	Miradi
7	22.07.2016	73	Miradi
8	26.07.2016	41	Miradi
9	15.08.2016	48	Miradi
10	17.08.2016	2 1	Miradi Fushë Kosovë
11	18.08.2016	6 11	Obiliq, KEK Mitrovicë, (Trepçe)
12	14.09.2016	10	Fushë Kosovë
	Total	509	

6.4.2.1.3. Shënjimi i numrit identifikues rendor

Numri i madh i mjeteve me pronësi të pa definuar, vështirësitë e gjetjes së numrit identifikues ka bërë që këtë vit të ndërmerret edhe procesi i mbishkrimit të një numri identifikues në secilin mjet me pronësi të pa definuar. Vlerësojmë se një veprim i tillë do ta lehtësoj inspektimin e mjeteve të kësaj kategorie, njëkohësisht do të jetë me rezultues në saktësi.

Mbishkrimi i një numri identifikues rendor (me ngjyrë të gjelbër) përfshinë secilin mjet që ka pronësi të pa definuar dhe që është pjese e regjistrat të kësaj kategorie (MPPD) (fig.12)



Fig. 1 Numri identifikues rendor

Theks të veçantë duhet vënë në ndikimin negativ në mjedis që kanë mjetet e tilla lëvizëse e të cilat janë jashtë përdorimit. Mjete që janë të ndërtuara në raste të caktuara nga materiale të dëshmuara si kancerogjene, mjete të cilat janë ndërtuar nga materiale jo qartë të definuara si dhe mjete të cilat janë koroduar apo dëmtuar nga faktorë tjerë e të cilat paraqesin rrezik potencial për shëndetin e banorëve të atyre anëve dhe punëtorëve të hekurudhave. Andaj, institucionet përgjegjëse të marrin masa që sa më parë ato mjete të largohen nga ato vende dhe ti bëhet një zgjidhje që do të ishte mbi të gjitha në të mirë të ambientit dhe jetës së njerëzve.

Në bazë të legjislacionit dhe kompetencave që ka, ARH nuk mbanë asnjë lloj përgjegjësie në rast të keqpërdorimit të çfarëdo natyre apo mos veprimit në raport me shqetësimet e ngritura.

Me rezultatet e dala nga Inspektimi MPPD, ARH krijon dhe ka në dispozicion raportin dhe regjistrin e mjeteve për këtë kategori me informacione të mjaftueshme për ta identifikuar secilin mjet. Raporti është dërguar në: Kuvendin e Republikës së Kosovës, Ministrinë e Infrastrukturës, Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik, Infracos dhe Trainkos.

6.4.2.2. Regjistrimi nacional i mjeteve lëvizëse hekurudhor

Sipas Ligjit për Hekurudhat e Kosovës 04/L-063, neni 28 paragrafi 7, ARH respektivisht Organi për Interoperabilitet është përgjegjës për numërimin e mjeteve transportuese të cilat janë në shërbim të Kosovës dhe për mbajtjen e regjistrit ad hoc me të gjitha informatat e kërkuara siç janë përshkruar në ligj, sikurse neni 18 paragrafi 3.6 që obligon ARH për mbikëqyrje se a janë regjistruar mjetet lëvizëse dhe nëse informacioni që ka të bëjë me sigurinë në regjistrin nacional është i azhurnuar.

Përgjatë këtij viti kemi realizuar regjistrimin e mjeteve lëvizëse hekurudhore aplikuar nga Operatori me Trena Trainkos. Mjetet e regjistruara i janë



bashkangjitur Regjistrin Nacional të Mjeteve Lëvizëse (NVR) (tabela 2). Gjithashtu kemi pranuar dhe realizuar aplikimet për modifikimin e një vagoni të udhëtareve dhe dy vagonëve të mallrave aplikuar nga Trainkos (tabela 3). Këtë vit kemi realizuar edhe regjistrimin e parë të lokomotivës së operatorit privat Railtrans me numër evropian 99 00 2740 001-8 (tabela 2).

Në forme tabelore janë paraqitur detajet e mjeteve lëvizëse hekurudhore për të cilat është aplikuar për **regjistrim (tabela 2)**.

Tabela 2: Mjetet lëvizëse hekurudhore të regjistruara në vitin 2016

	Mjeti lëvizës	Kompania	Viti i prodhimit	Numri paraprak	Numri evropian	
1	Lokomotivë	TRAINKOS	1981	98782044010-3	92 00 2620 016-1,	Regjistruar
2	Lokomotivë	RAILTRANS	1988	55230-7	99 00 2740 001-8	Regjistruar
3	Vagonë i mallrave	TRAINKOS	1970	31725952821-2	31 00 59 52 049-7	Regjistruar
4	Vagonë i mallrave	TRAINKOS	1970	82725965808-2	82 00 5965 050-8	Regjistruar
5	Vagonë i mallrave	TRAINKOS	1970	31725959438-8	31 00 5959 051-6	Regjistruar

Tabela 3: Mjetet lëvizëse hekurudhore të modifikuara në vitin 2016

Nr	Mjeti lëvizës	Kompania	Viti i prodhimit	Numri paraprak	Numri evropian	
1	Vagonë i udhëtareve	TRAINKOS	1978	51805940046-6	51 00 5940 021-6	Modifikuar
2	Vagonë i mallrave	TRAINKOS	1960	31721901785-0	31 00 1901 037-3	Modifikuar
3	Vagonë i mallrave	TRAINKOS	1978	31721900388-4	31 00 1900 038-2	Modifikuar

Departamenti i Interoperabilitetit ka shqyrtuar të gjithë formularët e regjistrimit konform legjislacionit në fuqi dhe në afat kohor të përcaktuar në rregulloren e regjistrimit Nr. 05/2012. Regjistrimi i mjeteve lëvizëse duke përfshirë „regjistrimet,” dhe „modifikimet,” rregullohet me Ligjin për Hekurudhat e Kosovës 04/L-063, Direktivën për Interoperabilitet 2008/57/EC dhe Rregulloren 05/2012 për Regjistrimin Nacional të Mjeteve Lëvizëse miratuar nga ARH.



6.4.2.3. Azhurnimi i regjistrit të mjeteve lëvizëse NVR

Departamenti i Interoperabilitet, përveç mbajtjes së regjistrit nacional të mjeteve lëvizëse (NVR), ndër të tjera është përgjegjës edhe për përditësimin e tij. Në vitin 2016 si rezultat i regjistrimeve të reja të mjeteve lëvizëse por edhe modifikimeve kemi azhurnuar regjistrin NVR.

6.4.2.4. Shënjëzimi i Mbajtësit të Mjetit Lëvizës VKM

VKM-ja (Vehicle Keeper Marking) është pasqyrim i emrit të plotë apo shkurtesës së mbajtësit të mjetit lëvizës. Shënjëzimi i mbajtësit të mjetit lëvizës është një kod alfa numerik i përbërë prej 2 deri në 5 karaktere i cila duhet të jetë i mbishkruar në secilin mjet lëvizës hekurudhor, afër numrit të mjetit lëvizës.

ARH-ja përgjegjëse për Interoperabilitet përcakton kodet për VKM-në në marrëveshje me Mbajtësin e Mjetit Lëvizës.

Në vitin 2016 në ARH më datë: 01.11.2016 është pranuar një aplikacion për regjistrimin e kodit të VKM-së nga operatori Railtrans. Në përputhje me Rregulloren e Regjistrimit 05/2012 dhe me Vendimin 2011/314/EU janë zhvilluar procedurat për shqyrtimin e aplikacionit të operatorit hekurudhor Railtrans për kodin e VKM –së. Pa shqyrtimit të aplikacionit më datë: 08.11.2016 Departamenti për Interoperabilitet pranon kodin e VKM-së për Operatorin Hekurudhore Railtrans e cila është shkurtes e kompanisë RT.

Tabela 5: Regjistri alfabetik i Mbajtësve të Mjeteve Lëvizëse (VKM)

	VKM	UNIKE	STATUS		
Sqarime:	Kodi që shihet në mjetin lëvizës	Kontrollimi i kodeve unike	Bllokuar	Në përdorim	Revokuar
VKM	UNIKE	Emri i VKM	Shteti	Statusi	Webfaqja
IHK	IHK	INFRAKOS	KS	Në përdorim	www.kosovorailëay.com
NCF	NCF	NEWCO FERRONIKELI COMPLEX L.L.C	KS	Në përdorim	www.cunicoresources.com
TRKOS	TRKOS	TRAINKOS	KS	Në përdorim	www.trainkos.com
RT	RT	RAILTRANS	KS	Në përdorim	www.railtrans.biz



6.4.2.5. Azhurnimi i marrëveshjeve ndërkombëtare dhe vendore rreth HK-së

Bazuar ne marrëveshjet hekurudhore ndërkombëtare të arritura në mes të institucioneve dhe kompanive në sektorin hekurudhore, ARH ka të krijuar listën e marrëveshjeve ndërkufitare e cila azhurnohet përmes marrëveshjeve të reja ose atyre që pësojnë ndryshime. Në listë janë të përfshira edhe marrëveshjet vendore të Menaxherit të Infrastrukturës dhe ndërmarrjeve hekurudhore mbi operimin dhe mirëmbajtjen. Palët nënshkruese njoftojnë ARH mbi marrëveshjet e nënshkruara, të cilat i bashkëngjiten listës se këtyre marrëveshjeve.

Azhurnimi i fundit është realizuar në muajin mars 2016, si rezultat i nënshkrimit të dy marrëveshjeve në mes të Infrastrukturës hekurudhore të Kosovës INFRAKOS, Operimit me Trena TRAINKOS, Infrastrukturës se hekurudhave të Maqedonisë dhe Transportit të hekurudhave të Maqedonisë.

1. Marrëveshja zbatuese për ndërlidhjen e rrjeteve hekurudhorë ndërmjet Hekurudhave të Kosovës (HK) dhe Hekurudhave Maqedonase (MZ) dhe
2. Dispozitat e Përbashkëta Zyrtare për rregullimin e komunikacionit kufitar hekurudhor në linjën kufitare Hani i Elezit – Volkovë.

Këto marrëveshje janë nënshkruar më 15.02.2016 në Fushë Kosovë si rrjedhojë e Marrëveshjes ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Republikës së Maqedonisë për rregullimin e transportit hekurudhorë kufitar të nënshkruar më dt: 15.09.2011.

Informacione të detajuara mbi marrëveshjet gjinden në tabelën e më poshtme (tabela 6).



Tabela 6: Marrëveshjet ndërkombëtare ndërkombëtare dhe vendore rreth HK-së

Nr.	Marrëveshjet	Palët nënshkruese	Data e nënshkrimit	Komentet
1	Marrëveshja e përkohshme ndërmjet NHT" BEOGRAD" dhe HEKURUDHAT E UNMIK-ut të	HEKURUDHAT E UNMIK-ut - NHT" BEOGRAD"	31.05.2002 (nuk implementohet)	Nuk zbatohet që nga 03 Marsi 2008, si pasojë e masave të ndërmarra nga entitet lokale të pjesës Veriore të vendit pas shpalljes së pavarësisë së Republikës së Kosovës.
2	Marrëveshja e përkohshme në mes HEKURUDHAT MAQEDONE dhe HEKURUDHAT E UNMIKU-ut	HEKURUDHAT E UNMIKU-ut - HEKURUDHAT MAQEDONE	30.08.2002	Transporti hekurudhorë ndërmjet dy shteteve respektive, Republika e Maqedonisë dhe Republika e Kosovës ende bëhet sipas kësaj Marrëveshje. Rezultat i Marrëveshjes kornizë të datës 15.09.2011 është Marrëveshja implementuese për ndërlidhjen e përbashkët të rrjeteve Hekurudhore ndërmjet Hekurudhave të Maqedonisë-Infrastruktura dhe Hekurudhave të Kosovës e nënshkruar me datën 15.02.2016 për të cilën ende nuk është krijuar baza për zbatim.
3	Marrëveshja ndërmjet , Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Republikës së Maqedonisë mbi komunikacionin hekurudhor kufitar	Qeveria e Republikës së Kosovës - Qeveria e Republikës së Maqedonisë	15.09.2011	Kjo është kontratë kornizë dhe bazohet në Traktatin për transport. Pritet finalizimi i marrëveshjeve të palëve në fushat e veçanta: hekurudha, polici, dogana dhe shërbimet fitosanitare.
4	Marrëveshja për mirëmbajtje të binarit industrial	"NEW CO FERRONIKELI COMPLEX LLC" - "INFRAKOS" SH.A.	27.02.2012	Kontrata e nënshkruar më 27.02.2012 ka të precizuar kohën e paralajmërimit të shkëputjes së kontratës dhe është implementuar .
5	Marrëveshja ndërkombëtare për kalimin ndërkufitar ndërmjet "INFRAKOS"SH .A. - Kosovë dhe H.M. "INFRASTRUKTURA" - Maqedoni	"INFRAKOS" SH.A. -H.M. "INFRASTRUKTURA"	Finalizuar	Kjo marrëveshje është finalizuar dhe është nënshkruar nga "INFRAKOS"SH.A. - Kosovë dhe H.M. "INFRASTRUKTURA" - Maqedoni Implementimi i sajë nuk bëhet sepse për implementimin e sajë duhet edhe nënshkrimi i akterëve tjerë si p.sh. : Policisë kufitare, organeve Fito Sanitare te te dyja Shteteve . Me të përmbushjes së këtyre kërkesave ne jemi te gatshëm për Implementim.
6	Marrëveshja ndërmjet TRAINKOS SH.A. dhe INFRAKOS SH.A. për shërbime te përbashkëta,,	TRAINKOS SH.A. -INFRAKOS SH.A.	24.08.2015	Kontrata e nënshkruar më 24.08.2015 ka të precizuar kohën e paralajmërimit të shkëputjes së kontratës dhe mund të shtohet me aneks ndonjë pikë/ çështje e nevojshme.
7	Marrëveshja për qasjen në binarë "IFRAKOS"SH.A.	TRAINKOS SH.A. -INFRAKOS	Pa-finalizuar	Kjo Marrëveshje në kohën e raportimit është në shqyrtim të

	dhe "TRAINKOS" SH.	SH.A.		ndërsjellë për të u nënshkruar së shpejti.
8	Marrëveshja ndërmjet NEW CO FERRENIKELIN COPLEX LLC dhe Hekurudhat e Kosovës për bartjen e xeheve dhe thëngjillit	"NEW CO FERRENIKELIN COPLEX LLC" - Ish-Hekurudhat e Kosovës	E nënshkruar (30.12.2016)	Një kontratë me "New Co Ferronikeli Coplex LLC" është nënshkruar për periudhën Tetor - Dhjetorë 2016. Kontrata për vitin 2017 është nënshkruar për gjashtë muaj, pra për Janar - Qershor 2017 me mundësi vazhdimi varësisht nga rrethanat e krijuara.
9	Marrëveshjen për mirëmbajtjen e mjeteve lëvizëse ndërmjet TRAINKOS SH.A. dhe NEW CO FERRENIKELIN COPLEX LLC	"TRAINKOS" SH.A. - "NEW CO FERRENIKELIN COPLEX LLC"	30.12.2016	Është pjesë e aneksit të kontratës gjashtëmujore të nënshkruar me datën 30.12.2016.
10	Marrëveshja implementuese për ndërlidhjen e përbashkët të rrjeteve Hekurudhore ndërmjet Hekurudhave të Maqedonisë-Infrastruktura dhe Hekurudhave të Kosovës,	H.M. "INFRASTRUKTUR A" H.M. "TRANSPORTI" - "TRAINKOS" SH.A. "INFRAKOS" SH.A.	15.02.2016	Është e nënshkruar mes kompanive relevante hekurudhore të dy shteteve dhe pritet për veprime të mëtutjeshme të koordinuara nga MI-ja.
11	Dispozitat e përbashkëta për rregullimin e Komunikacionit kufitar hekurudhor në linjën kufitare Vollkovë-Hani I Elezit	H.M. "INFRASTRUKTUR A" H.M. "TRANSPORTI" - "TRAINKOS" SH.A. "INFRAKOS" SH.A.	15.02.2016	Është e nënshkruar mes kompanive relevante hekurudhore të dy shteteve dhe pritet për veprime të mëtutjeshme të koordinuara nga MI-ja.

Nga të gjitha këto marrëveshje del që Menaxheri i Infrastrukturës-INFRAKOS dhe Operatori me Trena-TRAINKOS sa i përket operimit dhe mirëmbajtjes përveç marrëveshjeve me institucionet brenda vendit dhe me Maqedoninë nuk posedojnë marrëveshje kontraktuale të tilla me vende të tjera. Marrëveshjet me Maqedoninë të finalizuara apo ato në prag të finalizimit konsiderohen si rrjedhojë e Marrëveshjes ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Republikës së Maqedonisë mbi komunikacionin hekurudhor kufitar të nënshkruar më datë: 15/09/2011.



6.4.2.6. Misioni i Eksperteve për STI Infrastrukturë organizuar nga TAIEX

ARH është përgjegjëse për përgatitjen dhe nxjerrjen e Specifikacioneve Teknike për Interoperabilitet për të gjitha nënsistemet hekurudhore të cilat duhet të kenë për bazë STI e përgatitura në nivel të BE-së. Për ta ndihmuar këtë proces, Departamenti për Interoperabilitet në mars të 2016 bënë kërkesë në TAIEX për realizmin e një misioni të eksperteve i cili do të ndihmoje transpozimin e Rregullores së BE-së Nr. 1299/2014 INF STI për nënsistemin e Infrastrukturës) në legjislacion nacional. Kërkesa është pranuar nga TAIEX në mars të këtij viti.

Misionin i Eksperteve me temë „Specifikacionet Teknike për Interoperabilitet për nënsistemin e Infrastrukturës-mënyra e transpozimit dhe implementimi,, është organizuar në kuadër të Asistencës Teknike dhe Shkëmbimit të Informacionit TAIEX. Misioni u realizua në periudhën prej dy (2) ditësh 19-20/07/2016, udhëhequr nga ekspertë franceze nga SNCF (French Railways Holding) dhe SNCF Réseau (French Infrastructure Manager).

Brenda dy ditëve sa u zhvillua ky mision u dha një kontribut rreth mënyrës së transpozimit të rregullores së BE-së për Specifikacionet Teknike për Interoperabilitet për nënsistemin e infrastrukturës në legjislacionin nacional, gjithmonë duke marre në konsideratë dhe vlerësuar kushtet e sektorit hekurudhore në Republikën e Kosovës. Mundësia e implementimit të Specifikacioneve Teknike për Interoperabilitet STI gjithashtu ka përfshirë një diskutim të hollësishëm duke e konsideruar mëse të rëndësishme. Praktikrat e implementimit të STI në vendet e tjera të prezantuara nga ekspertët ishin një mundësi e mire për ti dhënë më shume qartësi kërkesave të Interoperabilitetit.

Rëndësi e veçante iu dha edhe projektit të modernizimit të linjës së 10 hekurudhore. Zyrtarët e ARH-së prezantuan në forme të përgjithësuar një sfond të projektit, për ta vlerësuar pastaj ndërlidhjen e këtij projekti me STI, sigurisht vetëm në aspektin e diskutimit formal. Ekspertët gjatë prezantimit paraqitën idetë dhe përvojat e tyre në mënyrën më të mire duke i kombinuar ato me shembuj praktik dhe konkret. Idetë dhe përvojat e tilla shpjegonin domosdoshmërinë e implementimit të legjislacionit të BE-së përmes transpozimit në legjislacionin nacional. Kjo do ta bënte më të lehtë ndërlidhjen dhe integrimin e hekurudhës tonë në atë të BE-së.



6.4.2.7. Libri i rregullave për makinistë

Libri i rregullave për makinistë është një dokument në formë manuali në të cilin duhet të përshkruhen në formë të qartë të gjitha informacionet, procedurat dhe rregullat gjatë operimit të trenit dhe të jenë të njohura për makinistin (bazuar në nenin 106 të Ligjit për Hekurudha dhe pikën 4.2.1.2 të Rregullores (BE) 2015/995). Ky informacion duhet të ketë parasysh operimin në situata normale, të degraduara dhe të emergjencës për rrugët gjatë të cilave operohet dhe mjetet lëvizëse të përdorura në këto rrugë.

Departamenti i Interoperabilitetit ka përgatitur informacionin bazë të përgjithshëm në bazë të të cilit duhet përgatitur ky dokument. Përgjegjës për përgatitjen e „Librit të rregullave për makinistë“, është ndërmarrja hekurudhore.

Operatori me Trena Trainkos bazuar në informacionet e përgjithshme të përgatitura nga ARH gjatë muajit mars të vitit 2016 ka filluar përgatitjen e „Librit të rregullave për makinistë“, realizuar përmes grupit punues brenda Trainkos-it, përgjegjës për hartimin e këtij dokumenti.

Me datë: 05.10.2016 nga Trainkos kemi pranuar draftin e parë të „Librit të rregullave për makinistë“, Megjithëse është në formë shume të përgjithësuar ka përmbajtje që i referohet rregullores 2015/995/BE TSI OPE (Operimi dhe Menaxhimi i Trafikut). Duke qenë se është një dokument që po përgatitet për herë të parë, Trainkos kërkon kohë për tu realizuar përgatitja e tij, prandaj mbetet në proces për vitin 2017.

6.4.2.8. Specifikimet Teknike për Interoperabilitet STI

Specifikacionet Teknike për Interoperabilitet janë përgatitur dhe lëshuar në nivel të BE-së, në mënyrë që të përgatitet Hapësira Unike Hekurudhore dhe si të tilla duhet të paraqesin bazën kryesore të sigurisë hekurudhore në Kosovë. Sipas Ligjit për Hekurudha për secilin nënsistem hekurudhorë, Specifikacionet Teknike të Interoperabilitetit në Kosovë duhet të lëshohen nga ARH-ja dhe duhet t'i plotësojnë kërkesat esenciale e në veçanti kërkesat e sigurisë.



6.4.2.9. Specifikacionet Teknike për Interoperabilitet (STI)

6.4.2.9.1. STI për nënsistemin e infrastrukturës

ARH përgjegjëse për fushën e Interoperabilitetit e obliguar për të siguruar përmbushjen e detyrimeve të saj kundrejt ligjit, më datë: 22.09.2016 fillon me përgatitjen e STI për nënsistemin e Infrastrukturës, i cili do të ketë për bazë Rregulloren e BE-së STI INF Nr. 1299/2014. Duke qenë se procedurat për vlerësimin e konformitetit dhe përshtatshmërisë për përdorimin për përbërësit e interoperabilitetit, si dhe procedurat për vlerësimin verifikimit për nënsistemet hekurudhore me rregulloret e STI-ve realizohen nga Organet Njoftuese (në vendet e BE-së) fillimisht jemi duke analizuar me shume kujdes dy alternativat e mundshme të transpozimit.

- Ndryshimi i Rregullores së STI për nënsistemin e infrastrukturës, përshtatur për kushtet e sektorit tonë hekurudhore, ose
- Adoptimi i rregullores së STI për nënsistemin e Infrastrukturës të BE-së Nr. 1299/2014

ARH do ti analizoje në detaje dy alternativat që transpozimi të realizohen në mënyrën më të mirë dhe më të përshtatshme për mundësitë e sektorit tonë hekurudhore.

6.4.2.9.2. Specifikacionet Teknike për Interoperabilitet për nënsistemin e operimit dhe menaxhimin e trafikut.

Në fund të vitit 2016 kemi filluar edhe me përgatitjen e STI për nënsistemin e Operimit dhe Menaxhimin e Trafikut (OPE). Ky akt nënligjor gjithashtu do të ketë për bazë Rregulloren e BE-së TSI Nr. 2015/995 për këtë nënsistem. Forma e transpozimit do të jetë e njëjtë me Rregulloren TSI për nënsistemin e Infrastrukturës.

Përgatitja dhe implementimi i STI të do të kenë rol integruar të sistemit tonë hekurudhore në atë të BE-së, meqë lehtësojnë tranzicionin nga sistemet e vjetra kombëtare hekurudhore të cilat qeveriseshin kryesisht nga rregullat nacionale, në një zonë hekurudhore të përbashkët evropiane që qeveriset kryesisht nga rregullat e përbashkëta të BE-së.



6.4.2.10. Inspektimi i regjistrimit të mjeteve lëvizëse

Organi përgjegjës për çështjet e interoperabilitetit të hekurudhave është përgjegjës për numërimin e mjeteve transportuese të cilat janë në shërbim në Kosovë dhe për mbajtjen e regjistrimit ad hoc me të gjitha informatat e kërkuara siç janë përshkruar në Ligjin për Hekurudhat e Kosovës (neni 28, paragrafi 7)

Bazuar në punën dhe përgjegjësit e veta që ka Departamenti i Interoperabilitetit, ka realizuar inspektimin e regjistrimit të mjeteve lëvizëse (NVR) që janë në pronësi dhe administrim të të gjitha ndërmarrjeve hekurudhore. Qëllimi i inspektimit ishte për të kontrolluar nëse të gjitha mjetet lëvizëse hekurudhore brenda territorit të Kosovës janë pjesë e regjistrimit Nacional të Mjeteve Lëvizëse. Kjo nënkupton përputhshmërinë e mjeteve lëvizëse operuese hekurudhore me NVR. Vlerësojmë që përmes inspektimit të parandalohet operimi me mjete të paregjistruara e cila do të ishte në kundërshtim me rregulloren 05/2012.

Inspektimit të regjistrimit të mjeteve lëvizëse iu nënshtruan mjetet e Infrakos-it (data e inspektimit 26-27/10/2016), mjetet e Trainkos-it (datat e inspektimit 31/10/2016, 01-03/11/2016 dhe 10/11/2015) mjetet lëvizëse të NewCo Ferronikeli Complex LLC (data e inspektimit 21/11/2016) dhe mjeti lëvizës i Railtrans-it (data e inspektimit: 18/11/2016).

Këtë vit inspektimi rezultoi të jetë i suksesshëm, duke qenë se të gjitha mjetet lëvizëse me të cilat operojnë ndërmarrjet hekurudhore ishin pjesë e NVR-së. Me rezultatet e dala nga inspektimi janë përgatitur raportet për katër kompanitë që kanë përfshirë të gjitha mjetet hekurudhore në pronësi dhe administrim të Infrakos, Trainkos, Newco Ferronikeli Complex dhe Railtrans.

6.4.2.11. Shënimi i numrit evropian në mjetin lëvizës

Në inspektimin NVR është përfshirë edhe kontrollimi i shënimit të numrit evropian. Secili mjet lëvizës hekurudhore i cili është pjesë e NVR-së duhet të ketë të shënuar numrin evropian dymbëdhjetë shifror, përmes së cilit identifikohet secili mjet. Shënimi i numrit evropian në mjetin lëvizës kërkohet në Ligjin për Hekurudhat e Kosovës 04/L-063, neni 110, paragrafi 8.1.



Këtë vit inspektimi i shënimi të numrit evropian rezultoi të jetë më i suksesshëm në krahasim me vitet e kaluara, sepse të gjitha mjetet të cilat ishin pjesë e NVR kishin të shënuar këtë numër identifikues të regjistrimit në mjet.

- INFRAKOS ka realizuar procesin e mbishkrimit të numrit evropian në të gjitha mjetet lëvizëse hekurudhore të cilat janë pjesë e NVR-së.
- TRAINKOS ka realizuar procesin e mbishkrimit të numrit evropian në të gjitha mjetet lëvizëse hekurudhore të cilat janë pjesë e NVR-së, me përjashtim të 4 vagonëve të mallrave të cilët iu nënshtruan regjistrimit para se të filloj inspektimit. Trainkos arsyeton kohen e pamjaftueshme për ta realizuar mbishkrimin e numrit evropian edhe në këto mjete.
- NEWCO FERRONIKELI COMPLEX ka realizuar procesin e mbishkrimit të numrit evropian në të gjitha mjetet lëvizëse hekurudhore (vagonët e mallrave) të cilat janë pjesë e NVR-së.
- RAILTRANS ka realizuar procesin e mbishkrimit të numrit evropian në të gjitha mjetet lëvizëse hekurudhore (vagonët e mallrave) të cilat janë pjesë e NVR-së.

6.4.3. Objektivat e Departamentit të Interoperabilitetit

Objektivi i përgjithshëm i Departamentit të Interoperabilitetit mbetet zhvillimi i kornizës nacionale të interoperabilitetit hekurudhor, që nënkupton arritjen e interooperabilitetit brenda sistemit hekurudhore nëpërmjet zbatueshmërisë së Ligjit për Hekurudha dhe Direktivës për Interoperabilitet.

Ndjekja e këtij objektivi duhet të çojë në harmonizimin teknik (STI) dhe të bëjë të mundur përmirësimin dhe zhvillimin e shërbimeve të transportit hekurudhor, duke bërë që transporti hekurudhore të jetë konkurrues me format e tjera të transportit.

Një përkufizim figurativ mbi synimet e Interoperabilitetit do të dukej sikur në figurën e mëposhtme.




Fig.1 Synimet e Departamentit të Interoperabilitetit.



6.5. DEPARTAMENTI I RREGULLIMIT TË TREGUT

Raporti i departamentit të rregullimit të tregut është raporti i përgatitur në përputhje me ligjin 04/L-063, neni 26 paragrafi 11 për hekurudhat e Kosovës.

6.5.1. Detyrat dhe përgjegjësit

Departamenti i Rregullimit të Tregut Hekurudhor ka për detyrë që të bëjë sigurimin e kushteve për hapjen e tregut hekurudhor në Kosovë, në kuadër të kësaj parashtrohen një varg detyrash dhe përgjegjësish ligjore siç janë:

- | Sigurimi që pagesat e vendosura nga menaxheri i infrastrukturës apo organi i vendosjes së pagesës nuk janë diskriminuese.
- | Sigurimi që qasja në binarë, qasja në stacione, qasja në depot e operatorëve që plotësojnë kushtet e domosdoshme të jetë e drejt, transparente dhe jo diskriminuese.
- | Mbikëqyrja e negociimeve ndërmjet aplikuesve dhe menaxherëve të infrastrukturës hekurudhore të shfrytëzimit të përbashkët në lidhje me nivelet e pagesës për infrastrukturë. Ato negociata duhet të lejohen vetëm nëse ato kryhen nën mbikëqyrjen e organit rregullativ të tregut hekurudhor.
- | Intervenimi nëse negociatat e tilla kanë të ngjarë se do jenë në kundërshtim me kërkesat e këtij ligji.
- | Sigurimi se a përmban ekspozë i rrjetit klauzola diskriminuese apo krijon kompetenca diskriminuese për menaxherët e infrastrukturës hekurudhore të shfrytëzimit të përbashkët, të cilat ata mund t'i shfrytëzojnë për t'i diskriminuar aplikantët.
- | Analizimi dhe monitorimi i konkurrencës dhe kualitetit të shërbimeve në tregun e shërbimeve hekurudhore dhe në tregjet e brendshme dhe të jashtme konkurruese. E gjithë kjo të bëhet me iniciativën e tij dhe me qëllim të parandalimit të diskriminimit në mesin e aplikantëve.
- | Vepron si organ për ankesa për tregun hekurudhor, secili aplikant duhet të ketë të drejtë të ankohet nëse beson se ka qenë i trajtuar në mënyrë të padrejtë, i diskriminuar dhe në veçanti kundër vendimeve të miratuara nga menaxheri i infrastrukturës, operatori i pajisjeve për ofrimin e shërbimeve apo kur është e mundur edhe nga ndërmarrja hekurudhore në lidhje me:

Monitorimi i tërë tregut hekurudhor në Kosovë, në këtë drejtim Departamenti i Tregut Hekurudhor duhet të përgatis raportin vjetor të cilin ARH pas miratimit të tijë do ta paraqes në Kuvendin e Kosovës.

Dhënia e kontributit për politikat të cilat ofrojnë zhvillim të qëndrueshëm, shërbime mjedisore të transportit dhe kontribut në zbatimin e tij. Dhënia e kontributit për të zhvilluar sistem të integruar të transportit të udhëtarëve dhe mallrave.

Kontributi në lejin e procesit për të lejuar mbylljen e shërbimeve publike të udhëtarëve të interesit të përgjithshëm ekonomik, mbylljen e binarëve dhe stacioneve.

6.5.2. Aktivitete e Departamentit të Rregullimit të Tregut

Departamenti i Rregullimit të Tregut në kuadër të planit të punës dhe sipas detyrave dhe përgjegjësi ligjore ka realizuar këto aktivitete përgjatë vitit 2015:

- Analizimi dhe organizimi i procesit të konsultimeve për Ekspozeun e Rrjetit,
- Shqyrtimi i ankesave nga operatorët hekurudhore
- Monitorimi i tregut hekurudhor, përgatitja e raportit të monitorimit dhe Përgatitja e draft rregullores për monitorim dhe raportim
- Organizimi i workshopit rajonal për rregullimin e tregut

6.5.2.1. Ekspozeu i rrjetit

Departamenti i Rregullimit të Tregut ka pranuar draft Ekspozeun e Rrjetit nga ana e Menaxherit të Infrastrukturës Hekurudhore Infrakos SH.A, më dt:xxx. Pas pranimit të draft Ekspozeut të Rrjetit, kemi filluar procesin intensiv të konsultimit duke përfshirë të gjitha palët e interesit siç janë: ARH, Infrakos, Trainkos, MI, MZHE.



6.5.2.2. Procesi i konsultimeve për ekspozetën e rrjetit

Departamenti për Rregullimin e Tregut Hekurudhor ka mbajtur një takim zyrtar me Infrakos, Trainkos, MI, MZHE, ku janë zhvilluar konsultime intensive lidhur me draftin e Ekspozetës të Rrjetit. Si temë specifike ka qenë kapitulli i gjashtë (6) i Ekspozetës të Rrjetit me përshkrimin, shërbimet e përfshira në tarifë, principet e llogaritjes së detyrimeve, pra mënyra e llogaritjes së tarifave nga ana e Menaxherit të Infrastrukturës Infrakos.

Ne si Departament për Rregullimin e Tregut pas këtij takimi kemi filluar të punojmë në nxjerrjen e fakteve lidhur me ankesën e paraqitur nga ana e Trainkos, për çmimet e operimit në infrastrukturën hekurudhore si dhe krahasimin me atë të vendeve fqinje siç janë: Maqedonia dhe Mali i Zi. Departamenti për Rregullimin e Tregut Hekurudhor pas një procesi të gjithanshëm të konsultimeve me palët e interesit më datë: 13.06.2016 ka marrë vendim duke e paraqitur opinionin e vet për pika të caktuara nga draft Ekspozetës i Rrjetit siç janë:

- Nëse menaxheri i infrastrukturës ka respektuar procedurat ligjore, gjatë hartimit të Ekspozetës të Rrjetit dhe procesin e konsultimeve.
- Bazuar në ligjin për hekurudha, neni 61.3 i cili ka të bëjë me përcaktimin e tarifave për shërbimet hekurudhore, ARH ka analizuar draft Ekspozetën e Rrjetit, respektivisht kapitullin e 6 i cili ka të bëjë me sistemin e tarifimit, nivelin e përgjithshëm të pagesave për shfrytëzimin e shërbimeve të cilat i ofron menaxheri i infrastrukturës.

ARH ka dalë me rekomandim si në vijim:

„Pasi që nga Infrakos i kërkohet nga neni 7.1 dhe neni 45.5 Ligji për Hekurudhat “ që të veprojnë në baza komerciale sipas kushteve të rrjetit” është e nevojshme që të sigurohet se zvogëlimet e të hyrave që vijnë nga ndryshimet të kompensohen nga të hyra të tjera sipas nenit 45.15 të Ligjit për Hekurudhat. Përveç këtyre kërkesat mund të përmbushen edhe në bazë të nenit 63.3.

Gjatë vitit 2016, ARH, të gjitha ankesave dhe kërkesave që iu janë drejtuar nga operatorët hekurudhor, i ka trajtuar në bazë të kompetencave dhe Ligjit të HK-së



6.5.2.3. Monitorimi i tregut

Departamenti i Rregullimit të Tregut gjatë vitit 2016 në mënyrë permanente ka bërë monitorimin e tregut hekurudhore brenda Republikës së Kosovës. Pjesë e monitorimit të tregut hekurudhorë ka qenë transporti i mallrave të importuara dhe eksportuara përmes transportit hekurudhore si dhe monitorimi i transportit të pasagjerëve. Rezultatet e monitorimit janë raportuar në IRG- Rail, institucion evropian ku ARH është anëtare me të drejta të plota. Po ashtu gjatë vitit 2016 është draftuar rregullore e veçante për monitorimin dhe raportimin e tregut hekurudhore në Kosove.

6.5.2.4. Workshopi për Rregullimin e Tregut Hekurudhor

Autoriteti Rregullativ i Hekurudhave në bashkëpunim me TAIEX-in dhe me mbështetjen e Komisionin Evropian më datë: 29 dhe 30.09.2016 kanë organizuar punëtorinë (workshopin) mbi Rregullimin e Tregut Hekurudhor për Rregullatorët e Tregut të vendeve të rajonit e cila është mbajtur në Prishtinë. Kjo Punëtori është iniciuar me kërkesën e Departamentit të Rregullimit të Tregut në kuadër të ARH-ës të paraqitur tek TAIEXI.

Qëllimi i kësaj punëtorie ishte që të ofrojë këshilla dhe udhëzime për çështje të rregullimit të tregut hekurudhor, kryesisht duke u fokusuar tek të drejtat e udhëtarëve, procesi i shqyrtimit të ankesave, pagesat e qasjes, detyrimet e shërbimit publik (PSO) dhe natyrën e kontratave të shërbimeve publike.

Më datë: 29-30.09.2016 është mbajtur Workshopi mbi Rregullimin e Tregut hekurudhor në nivel rajonal.

Gjatë dy ditëve të punëtorisë u trajtuan tema me interes për çështjet e rregullimit të tregut hekurudhor, kryesisht fokusi ishte në zbatimin dhe implikimet e dy rregulloreve të Bashkimit Evropian (Rregullore Nr 1371/2007 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e 23 tetor 2007 për të drejtat dhe detyrimet e pasagjerëve hekurudhorë si dhe Rregullore Nr 1370/2007 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e 23 tetor 2007 në shërbimet publike të transportit të udhëtarëve me hekurudhë dhe me rrugë) në fushën e rregullimit të tregut dhe sektorin hekurudhor në përgjithësi.



Pikë e veçanet ishte edhe prezantimi i Statusit të Rregullatorëve të Tregut për të gjitha vendet pjesëmarrëse (Shqipëria, Maqedonia, Serbia, Mali i Zi dhe Turqia) ky përfaqësuesit e tyre e paraqiten gjendjen aktuale në të cilën ndodhen rregullatorët e tregut duke përfshirë pozitën ligjore dhe aktivitetet e ndermarrura në fushën e rregullimit të tregut hekurudhor.

Po ashtu u diskutua edhe për ndikimin që mund të ketë paketa e 4 hekurudhore në çështjet e transparencës dhe ndarjes së llogarive të veçanta për PSO-të.

Në cilësinë e Eksperteve të Taixi-t ishin 3 pjesëmarrës, Laurent Monjole, Drejtor për çështje evropiane dhe ndërkombëtare i Rregullatorit Hekurudhor Francez (ARAFER), Carl-Friedrich Keding, nga Agjencia Shtetërore e Hekurudhave në Gjermani (NASA GmbH), si dhe Karol Klosowski, Drejtor i Departamentit për të Drejtat e Udhëtarëve në Zyrën e Transportit Hekurudhor në Poloni (UTK).

Duke parë trendët e zhvillimit të sektorit/tregut hekurudhor kjo punëtori për ne ishte shumë e mirëseardhur. Nga kjo punëtori ARH, konkretisht Departamenti për Rregullimin e Tregut ka përfituar njohuri lidhur me temat e trajtuara, po ashtu edhe një shkëmbim të përvojave nga vendet e rajonit lidhur me fushën e rregullimit të tregut e veçmas në çështjet e të drejtave të udhëtarëve dhe kontratat e shërbimeve publike.

Vlen të theksohet se ky aktivitet i Rregullatorit të Tregut ishte paraqitur edhe në disa media elektronike të vendit.

6.5.2.5. Rekomandimi i Departamentit të Rregullimit Tregut për Ekspozeun e Rrjetit,

Organi për Rregullimin e Tregut në kuadër të Autoritetit Rregullativ të Hekurudhave, në bazë të kompetencave ligjore sipas Ligjit Nr. 04/L-063 nenit 25.1. ka për detyrë që të bëjë sigurimin e kushteve për hapjen e tregut hekurudhor në Kosovë, si dhe ka për detyrë analizimin, monitorimin e konkurrencës dhe kualitetit të shërbimeve në sektorin hekurudhorë të Kosovës, e gjithë kjo bëhet me iniciativën e këtij departamenti.

Ekspozeu i Rrjetit është njeri nga dokumentet e rëndësishme në sektorin hekurudhor i cila ka ndikim në zhvillimin e tregut hekurudhor, sipas nenit 55. Ky nen kërkon që çdo menaxher i infrastrukturës së shfrytëzimit të përbashkët pas konsultimeve me palët e interesit dhe Organin Rregullativ të Tregut duhet të



publikoj Ekspozeun e Rrjetit, sikurse e ka definuar edhe në nenin 58, ku do duhej të publikohet jo më vonë se katër (4) muaj para afatit të fundit për paraqitjen e kërkesave për trasetë e trenit.

Miratimi i ER është i lidhur ngushtë me miratimin e vendosjes së strukturës së çmimeve për shfrytëzuesit e rrjetit hekurudhor. Ligji për Hekurudhat 04/L-063 në nenin 61.3 e ka definuar çart propozuesin si dhe miratuesin e vendosjes së strukturës së çmimeve për shfrytëzuesit e rrjetit hekurudhor, ku thuhet *“Struktura e sistemit të vendosjes së çmimit për shfrytëzuesit e rrjetit dhe niveli i përgjithshëm i pagesave të shfrytëzimit propozohet nga menaxheri i infrastrukturës në pronësi të shtetit dhe e miraton Ministria në bashkëpunim me Ministrinë përkatëse për ndërmarrjet publike. Menaxheri i infrastrukturës në shfrytëzim të përbashkët në pronësi shtetërore cakton pagesat dhe kostot në përputhje me situatën e tregut, duke respektuar parimin e mos diskriminimit”*.

Faza e propozimit të pagesave të qasjes është monitoruar nga Organi për Rregullimin e Tregut Hekurudhor në mënyrë zyrtare dhe sipas proceduarave ligjore (edhe pse kanë kaluar afatet ligjore për përfundimin e kësaj faze për të miratuar draft Ekspozeun e Rrjetit 2017).

Organi i Rregullimit të Tregut Hekurudhor në kuadër të Autoritetit Rregullativ të Hekurudhave si institucioni më i lartë mbikëqyrës i sektorit hekurudhor i fton organet përgjegjëse për miratimin e strukturës së çmimeve për shfrytëzuesit e rrjetit hekurudhor përkatësisht Ministrin e Infrastrukturës dhe Ministrin e Zhvillimit Ekonomik që të miratojnë strukturën e çmimeve për shfrytëzuesit e rrjetit hekurudhor në mënyrë që t’i hapet rrugë publikimit të Ekspozeut të Rrjetit 2017 nga ana e menaxherit të infrastrukturës Infrakos.

Publikimi i Ekspozeut të Rrjetit 2017 do të jepte mundësi operatorëve hekurudhor që të analizojnë kushtet të cilat i ofron Menaxheri i Infrastrukturës Infrakos për qasje në infrastrukturë dhe të futen në marrëveshje mbi qasjen në bazë të kushteve të përcaktuara nga ky dokument.



6.6. DEPARTAMENTI I ADMINISTRATËS

6.6.1. Detyrat dhe përgjegjësitë

Departamenti i Administratës është përgjegjës për menaxhimin dhe mbikëqyrjen e stafit administrativ të ARH-së. Në mënyrë efektive duhet menaxhuar administrimin e aktiviteteve të burimeve njerëzore siç janë: administrimi i kohës dhe prezencës në punë, rekrutimi, vendosja e shpalljeve për punë, vlerësimet e punës së stafit në kuadër të Departamentit, etj. Departamenti i Administratës duhet të ofroj përkrahje administrative sipas nevojës institucionale.

6.6.2. Aktivitetet e Departamentit të Administratës

Departamenti i Administratës ofron mbështetje të gjithanshme për personelin e ARH-së duke përfshirë menaxhimin e burimeve njerëzore:

- Departamenti i Administratës ka luajtur rolin udhëheqës në sigurimin e funksionimit optimal administrativ;
- Ka bartë përgjegjësinë për menaxhimin dhe mbikëqyrjen e stafit administrativ, duke u kujdesur për nevojat e stafit.
- Ka menaxhuar dhe mbikëqyrë, Logjistikën, Personelin, Teknologjinë informative;
- Ka menaxhuar shfrytëzimin efektiv;
- v të inventarit të ARH-së (shënimin e barkodeve, gjurmimin e pronës, transferimin e pronës etj);
- Ka menaxhuar administrimin dhe aktivitetet e burimeve njerëzore siç janë: rekrutimi, vendosja e shpalljeve për punë, trajnimet e stafit, administrimi i kohës dhe prezencës në punë, vlerësimet e punës së stafit të ARH-së;
- Ka shqyrtuar dhe menaxhuar përshtatshmërinë rreth nevojave për hapësira të zyrave;
- Ka mbikëqyrë identifikimin e nevojave teknologjike të zyrave dhe mirëmbajtja e pajisjeve të zyrave;
- Ka ofruar kërkesa, formularë, udhëzime dhe informata rreth ditëve të pushimit për stafin e ARH-se



- Në këtë vit janë zhvilluar procedurat për rekrutimin për Zyrtar të Interoperabilitetit e cila pozite ka qene e lire pas dorëheqjes se punëtorit , ku edhe është bere zgjedhja e kandidatit me kualifikime adekuate për këtë pozite.
- Janë bere edhe dorëzimi i formularëve për aprovimin e pranimit dhe sistemimi në listën e pagave për tri pozitat e Avancimit në Karrierë, si dhe dorëzimin e formularëve për Retroaktiv për tri pozitat e Avancuara ne Karrierë ne Ministrinë e Administratës Publike;
- Departamenti i Administratës gjithashtu këtë vit ka bere edhe përgatitjen e gjitha formularëve për Klasifikimin e vendeve te punës sipas Katalogut te Punës për Shërbyes Civil dhe i kemi dërguar ne MAP për shqyrtim.
- Këtë vit e kemi përgatitë gjithashtu edhe Formularin e Personelit ku i kemi sistematizuar gjithë punëtoreset nga koeficienti ne grada te punës.
- Kemi përgatitë specifikacione teknike për Divizionin e Prokurimit për kërkesat e ARH-se.
- Kemi mbikëqyrë planin e menaxhimit të kontratës për qera për objektin e ARH-së si dhe për sigurim dhe pastrim.
- Këtë vit i kemi përgatitur edhe Kartelat Indentifikuese për gjithë stafin e ARH-së dhe jemi pajisur me ID kartela pa Afat.
- Departamenti i Administratës gjithashtu ka bere edhe evidentimin e pushimeve vjetore dhe mjekësore për stafin e punëtorëve të ARH-së sipas Rregullores për Nëpunësit Civil dhe të gjitha janë vendosur në dosjet e punëtoreset.
- Në këtë vit kemi pasur edhe mjaft trajnime të organizuara nga IKAP-i ku Departamenti i Administratës ka bërë rekomandimet për mbajtjen e trajnimeve për stafin dhe kërkesat për trajnime janë aprovuar nga Drejtori i Përgjithshëm .



6.7. DEPARTAMENTI I FINANCave

6.7.1. Detyrat dhe përgjegjësitë

Duke njohur nevojën për përmirësimin e shpenzimeve buxhetore, kapitale dhe operative, menaxhimit financiar, kontabilitetit, përgjegjësiwe buxhetore dhe sistemit të raportimit financiar, Departamenti i Financave në ARH vepron dhe operon në bazë të: Ligjit Nr.03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë.

6.7.2. Aktivitetet e Departamentit të Financave

6.7.2.1. Pasqyrat financiare

Në formë tabelore janë paraqitur pasqyrat financiare dhe rrjedhshmëria e transaksioneve financiare të ARH-së sipas kategorive buxhetore.

Tabela 14. Pasqyrat financiare për vitin 2016

Përshkrimi	Buxheti i aprovuar-fillestar	Buxheti i aprovuar-final-pas shkurtimeve buxhetore	Shpenzimet	Shpenzimet %
Paga dhe mëditje	167,544.00	124,917.77	124,917.77	100%
Mallra dhe shërbime	114,179.00	72,052.86	70,337.36	97.61%
Shpenzime komunale	11,900.00	6,377.89	5,996.37	94.01%
Gjithsej	293,623.00	203,348.52	201,251.50	98.96%

Për një sqarim të përgjithshëm do të japim një gjendje të përgjithshme financiare dhe një ndarje krahasuese për të gjitha kategoritë buxhetore duke paraqitur të dhënat e vitit paraprak të cilat na japim një pasqyrë më të mirë, më të qartë dhe më me vizion për të ardhmen e ARH-se.

Ndarjet buxhetore në Total nga të gjitha Kategoritë Buxhetore, Varianca dhe Krahasset

Pasqyra e krahasimit të shumave buxhetore dhe aktuale për ARH

Për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2016

		2015			2015	2014	
		Buxheti fillestar (Ndarja)	Buxheti final (Ndarja)	Realizimi	Varianca D=C-B	Realizimi	Realizimi
		A	B	C	D=C-B	E	F
Shënime		€	€	€	€	€	€
Hyrja e parasë së gatshme në llogari të Thesarit							
Tatimet	14						
Të hyrat vetanake	15						
Donacionet	16						
Pranimet kapitale	17						
Fondi i Privatizimit	18						
Huazimet	19						
Tjera	20						
Pranimet totale të mbledhura për FKK-në		-	-	-	-	-	-
Daljet e parasë së gatshme nga llogaritë e Thesarit							
Pagat dhe mëditjet	21	167,544.00	124,917.77	124,917.77	-	123,269.94	117,641.47
Mallrat dhe shërbimet	22	114,179.00	72,052.86	70,337.36	1,715.50	108,659.24	124,747.74
Shërbimet komunale	23	11,900.00	6,377.89	5,996.37	381.52	5,973.68	5,673.57
Transferet dhe subvencionet	24				-		
Shpenzimet kapitale	25	-	-	-	-	-	-
Fondi i privatizimit	26						
Kthimi i huazimeve							
Tjerat	27						
Totali i pagesave të bërë nga BRK nëpërmes LIVTh		293,623.00	203,348.52	201,251.50	2,097.02	237,902.86	248,062.78

Vëmendje: 1/ Ndryshimet buxhetore finale nga këto fillestare janë si rezultat i ndryshimeve buxhetore nga niveli qendror në procesin e rishikimit e si finale mbetet pas shkurtimeve buxhetore nga Qeveria e Kosovës, ku ne si OB kemi pasur shkurtime si nga kategoria e Pagave dhe Mëditjeve (-42,626.23 euro) po ashtu edhe nga Kategoria e Mallrave dhe Shërbimeve (-47,126.14 euro), ndërsa tek kategoria e Shpenzimeve Komunale (-522.11 euro)

**Paga: Kemi një realizim të buxhetit prej 100 %**

Përshkrimi	2016				2015	2014
	GQ €	THV €	GPD €	Totali €	€	€
Pagesat						
Neto pagat		106,109.07	-	106,109.07	104,701.08	99,944.59
Pagesat për sindikata -0.10% te 0.50%						
Pagesa neto për punë jashtë orarit						
Pagesa për punë me orar të shkurtuar						
Pagesa për punë në ndërrim të natës						
Pagesa neto për pushim të lehonisë						
Mëditjet e delegatëve dhe komisioneve						
Punëtorët me kontratë						
Tatimi në të ardhura personale		6,911.76	-	6,911.76	6,828.38	6,492.24
Pagesa e kontributit pensional nga punëdhënësi		5,948.47	-	5,948.47	5,870.24	5,602.32
Pagesa e kontributit pensional nga i punësuar		5,948.47	-	5,948.47	5,870.24	5,602.32
Shujtat						
Gjithsej Pagesat	-	124,917.77	-	124,917.77	123,269.94	117,641.47

Mallra dhe Shërbime: Kemi një realizim të buxhetit prej 97.61 %

Përshkrimi	2016				2015	2014
	GQ €	THV €	GPD €	Totali €	€	€
Pagesat						
Shpenzimet e udhëtimit	16,247.69			16,247.69	28,469.72	35,179.57
Shërbimet e telekomunikimit	6,360.00			6,360.00	5,611.00	5,300.00
Shpenzimet për shërbime	5,302.70			5,302.70	11,114.94	17,902.48
Mobiljet dhe pajisjet nën 1000 Euro	491.70			491.70	40.37	5,876.11
Mobiljet dhe pajisjet tjera 1000 - 5000 Euro						
Blerje tjera të mallrave dhe shërbimeve	3,936.18			3,936.18	10,804.50	13,426.59
Derivatet dhe lëndët djegëse	7,528.94			7,528.94	7,826.53	8,249.40
Shërbimet financiare						
Shërbimet e regjistrimit dhe sigurimeve	7,261.15			7,261.15	6,865.00	9,432.38
Mungesa në arkë-kthimet						
Mirëmbajtja	4,919.97			4,919.97	10,796.70	6,913.71
Qiraja	17,683.33			17,683.33	21,125.00	19,500.00
Shpenzimet e marketingut	462.70			462.70	1,226.30	1,843.50
Shpenzimet e përfaqësimit	143.00			143.00	1,470.30	1,124.00
Vendimet e gjykatave	-			-	3,308.88	
Tatimi						
Servisimi i borxhit						
Gjithsej Pagesat	70,337.36	-	-	70,337.36	108,659.24	124,747.74



Shpenzime Komunale:Kemi një realizim të buxhetit prej **94.01 %**

Përshkrimi	2016				2015	2014
	GQ €	THV €	GPD €	Totali €	€	€
Rryma	3,129.72			3,129.72	2,982.48	2,044.22
Uji						
Telefon	2,866.65			2,866.65	2,991.20	3,629.35
Gjithsej Pagesat	5,996.37	-	-	5,996.37	5,973.68	5,673.57

Të hyrat vetanake

Përshkrimi	Shënime	2016	2015	2014	% e	
		€	€	€	% e totalit	ndryshimit
Të hyrat nga taksat 1 të ARH-së					%	%
Të hyrat nga taksat 2 të ARH-së					%	%
Të hyrat nga dënimet-gjobat 1 të ARH-së					%	%
Të hyrat nga dënimet-gjobat 2 të ARH-së					%	%
Të hyrat nga licencat 1 të ARH-së					%	%
Të hyrat nga licencat 2 të ARH-së					%	%
Të hyrat nga shitja e pasurisë dhe shërbimeve					%	%
Të hyrat nga inspektimi					%	%
Të hyrat nga interesi bankar					%	%
Të hyrat nga ndryshimet e pozicionit të kursit					%	%
Tarifa për akreditim					%	%
Të hyrat nga pasuria e ARH-së					%	%
Pranimet tjera të ARH-së					%	%
Totali		0	0	0	0%	%

ARH ende nuk ka filluar inkasimin e mjeteve përmes Taksave,Gjobave ,Licencave ,Lejeve të Sigurisë dhe pranimet tjera si të Hyra Institucionale.

**Subvencione dhe Transfere**

Përshkrimi	2016				2015	2014
	GQ €	THV €	GPD €	Totali €	€	€
Pagesat						
Subvencionet për entitetet publike						
Subvencionet për entitetet kulturore						
Subvencionet për entitetet jo-publike						
Transfere për qeveri tjera						
Pagesat për përfituesit individualë						
Pensionet bazë						
Pensionet invalide						
Pensionet ose ndihmat sociale						
Pensionet e TMK-së						
Pensionet e kategorisë I (anëtarët e familjes)						
Pensionet e kategorisë II (anëtarët e familjes)						
Pagesat për invalidët e luftës						
Pagesat për invalidët civilë						
Pagesat për familjet e viktimave të luftës						
Pensionet e përkohshme të Trepçës						
Vendimet gjyqësore						
Gjithsej Pagesat	-	-	-	-	-	-

Gjatë këtij viti nga kjo kategori nuk kemi pasur ndonjë përkrahje apo subvencion as nga Qeveria as nga Donatorët apo ndonjë nivel tjetër.

Shpenzimet Kapitale



Përshkrimi	2016				2015	2014
	GQ €	THV €	GPD €	Totali €	€	€
Pagesat						
Ndërtesat					-	-
Ndërtimi i rrugëve					-	-
Kanalizimi					-	-
Ujësjellësi					-	-
Energjia, gjenerimi, bartja dhe furnizimi					-	-
Pajisje mbi 1000 Euro					-	-
Automjete transporti					-	-
Makineria-Blerja e veturës zyrtare	-			-	-	-
Kapitalet tjera					-	-
Toka						
Pasuritë e paprekshme						
Transferet kapitale për entitetet publike						
Transferet kapitale për entitetet jopublike						
Vendimet gjyqësore						
Gjithsej Pagesat	-	-	-	-	-	-

6.7.2.2. Detajet e shpenzimeve nga kategoritë e Pagave, Mallrave dhe Shërbimeve, Shpenzimeve Komunale dhe Shpenzimeve Kapitale për vitin 2016 (Janar-Dhjetor 2016)

Ordinary Income/Expense	Planifikimi/Ndarja fillestare dhe finale		Realizimi
Expense	Fillestare	Finale	
6-11000 · PAGAT & MEDITJET			
6-11110 · Paga Bruto Përmes Payr			106,109.07
6-11115-Pagesa për sindikata			0.00
6-11500-Tat.i ndaluar ne te ardhura personale			6,911.76
6-11600 · Kontributi pensional nga punëtori			5,948.47
6-11170-Kontributi për pension nga punëdhënësi			5,948.47
Total 6-11000 · PAGAT & MEDITJET	Fill/167,544.00	Fin/124,917.77	124,917.77
6-13000 · MALLRAT & SHERBIMET			
6-13100 · Shpenzimet e Udhëtimit	35,165.00		
6-13143 · Shpenz.e udhet.jashte vendit			5,701.71
6-13133 · Shpenz.tjera udhet.zyrtar mbre			0.00
6-13142 · Akomodim gjate udhetimit zyrtar			2,794.95
6-13141 · Meditjet e udhetimit zyrtar			7,751.03
6-13140 · Sh. Udhëtimit Jasht Ven			0.00
Total 6-13100 · Shpenzimet e Udhëtimit			
71706 kthim i mjeteve(avansi)			0.00
71041 kthim i mjeteve(avans regj Pr NLB)			0.00
6-13300 · Sherbimet e Telekomunikimit	11,000.00		0.00

6-13310 · Interneti	3,000.00	0.00
6-13320 · Shpenzimet Tjera Telefo	8,000.00	6,360.00
6-1320A · Mbushje		
6-1320B · Roaming		
Total 6-13320 · Shpenzimet Tjera Telefo		0.00
6-13330 · Komunikimet Tjera		
6-13330 - Dergesat postare		
Total 6-13330 · Komunikimet Tjera		
Total 6-13300 · Sherbimet e Telekomunikimit		
6-13400 · Sherbimet Kontraktuese	46,054.00	
6-13480-Shpenzimet per antarsim		
6-13460 · Sherb.tjera kontr.	8,054.00	1,627.92
6-13450- Sherbime shtypje-jomarketing		473.60
6-13410 · Sh. Arsimit & Trajnimit	30,000.00	2,614.98
6-13430 · Sh.Ndryshme Shendetesor		
6-13440 · Sh.Ndryshme intel,keshilldh	8,000.00	0.00
6-13470 · Sherbimet Teknike		586.20
Total 6-13400 · Sherbimet Kontraktuese		
6-13500 · Blerja e Mobilie. >1000		
6-13501 · Mobilie		0.00
6-13502 · Tel mobil		0.00
6-13503 · Kompjuter		0.00
6-13509 · Paisje Tjera		491.70
Total 6-13500 · Blerja e Mobilie. >1000		0.00
6-13600 · Blerje Tjera	15,513.00	
6-13660 · Akomodim		
6-13610 · Furnizime per Zyre	11,900.00	324.18
6-13620 · Furnizim me ushqim & pi		3,612.00
6-13640 · Furnizime Pastrimi	3,613.00	
6-13650 · Furnizime me veshmbathj		0.00
Total 6-13600 · Blerje Tjera		
6-13700 · Derivate & Lend djegese	6,447.00	
6-13780 · Karburant per Vetura		2,852.12
6-13770 · Karburant per gjenerator		
6-13720 · Nafte per ngrohje		4,676.82
Total 6-13700 · Derivate & Lend djegese		
6-13800 · Llogarit e Avansit		
6-13820 · A. per udhetime zyrtare		
Total 6-13800 · Llogarit e Avansit		
6-13900 · Sherbimet Financiare		
6-13950 · Rexhistrimi i automjeteve		795.77
6-13952 · Taksa komunale e regjistrimit		60.00
6-13951 · Sigurimi i Automjeteve		139.24

6-13953 · Sigurimi I Ndertesave dhe tjera		6,266.14
Total 6-13900 · Sherbimet Financiare		
6-14000 · Mirembajtja		
6-14031 · Mirembajtja e rrugeve regjional		1,258.90
6-14010 · Mir.&Riparimi Autmjeteve		2,438.65
6-14020 · Mir. e Ndertesave		
6-14030 · Mir. Infrastruktures Rr		1,080.00
6-14040 · Mir. Teknologjis Inform		142.42
6-14050 · Mir. Mobilive & Paisjev		
Total 6-14000 · Mirembajtja		
6-14100 · Qiraja		
6-14110 · Ndertesat		17,683.33
Total 6-14100 · Qiraja		
6-14200 · Shpenzimet e Marketingu		
6-14230 · Shpenz.per informim publik		462.70
6-14210 · Reklama dhe Konkurse		0.00
6-14220 · Botime dhe Publikime		
Total 6-14200 · Shpenzimet e Marketingu		
6-14300 · Shpenzimet e Perfaqesim		
6-14310 · Drekat Zyrtare		143.00
Total 6-14300 · Shpenzimet e Perfaqesim		
6-14400 · Shpenzimet per vendim dhe gjyka		
6-14410 · Shpenzimet per vendim te gjykat		0.00
Total 6-14400		
Total 6-13000 · MALLRAT & SHERBIMET	Fill/ 114,179.00 Fin/72,052.86	70,337.36
6-13200 · SHPENZIMET KOMUNALE	Fillestare Finale	
6-13210 · Rryma	2,000.00	3,129.72
6-13220 · Uji		
6-13230 · Mbeturinat	500.00	
6-13240 · Ngrohja Qendrore	5,500.00	
6-13250 · Telefoni PTK	3,900.00	2,866.65
Total 6-13200 · SHPENZIMET KOMUNALE	Fill/11,900.00 Fin/6,377.89	5,996.37
6-20000 · Subvencionet&Transferet		
6-21110 · Su. per Entitetet Publi		
6-22200 · Pag. Perfitues Individu		
Total 6-20000 · Subvencionet&Transferet		
6-30000 · SHPENZIMET KAPITALE		
6-31210 · Ndertimi i Autostrade		
6-31230 · Ndertimi i rrugeve lokale		
6-31220 · Ndertimi i rrugeve regjionale		0.00
6-31700 · Vetura zyrtare		
6-31910 · Avanc per Investime		

Total 6-30000 · SHPENZIMET KAPITALE	0.00	0.00
Total Expense	Fill/293,623.00 Fin/203,348.52	201,251.50

6.8. PROKURIMI

6.8.1. Detyrat dhe përgjegjësitë

Prokurimi në ARH është përgjegjës për planifikimin e aktiviteteve të prokurimit si dhe zhvillimin dhe implementimin e procedurave të Prokurimit për blerjen e mallrave, shërbimeve dhe punëve në bazë të kërkesave të pranuar nga të gjitha departamentet apo njësitë e kërkesës së ARH-së. Bënë zhvillimin e aktiviteteve të prokurimit në të gjitha fazat e prokurimit, duke filluar nga arritja e kërkesës deri në realizimin (përmbyshjen) e plotë të kontratës. Të gjitha aktivitetet dhe funksionimi i Prokurimit si dhe kryerja e procedurave të prokurimit për vitin fiskal 2016 kanë filluar të realizohen sipas Planifikimit të Prokurimit dhe Planit të Punës për vitin 2016, në harmoni të plotë me dispozitat e Ligjit për Prokurimin Publik të Kosovës Nr. 04/L-042 si dhe të rregulloreve të miratuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik. Mirëpo, me ndryshim plotësimin e Ligjit 04/L-042, me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092, Neni 21 A parasheh: *Për Agjencitë e Pavarura të cilat i përgjigjen Kuvendit të Republikës së Kosovës, që kanë më pak se 50 (pesëdhjetë) punonjës, procedurat e prokurimit i kryen Agjencia Qendrore e Prokurimit.*

Nga data 1 Qershor 2016 ka filluar zbatimi i këtij neni, me hyrjen në fuqi të Memorandumit Shpjegues të nxjerrë nga KRPP. Sipas këtij memorandumi,



kompletimin e dokumentacionit dhe kërkesës për inicim të aktivitetit të prokurimit e bëjnë Autoritetet Kontraktuese, ndërsa zhvillimin e procedurave deri në nënshkrim të kontratës e bëjnë AQP, kurse monitorimi dhe menaxhimi i kontratës si dhe të gjitha procedurat tjera deri në përmbyllje të kontratës mbeten përgjegjësi e Autoriteteve Kontraktuese.

Prokurimi i ARH-së në mënyrë të vazhdueshme ka pas një bashkëpunim të ngushtë dhe efikas me Komisionin Rregullativ të Prokurimit Publik, Organin Shqyrtues të Prokurimit Publik dhe me Agjencinë Qendrore të Prokurimit.

6.8.2. Aktivitetet e Prokurimit

Sipas Planifikimit Përfundimtar të Prokurimit për vitin 2016, dokument standard i aprovuar nga KRPP mbi bazën e të cilit janë kryer të gjitha aktivitetet e parapara të prokurimit, janë parapare të realizohen gjithsejtë 10 aktivitete të prokurimit për blerjen e mallrave dhe shërbimeve të nevojshme për ARH-në. Nga të gjitha këto aktivitete të planifikuara, Prokurimi, në bazë të kërkesave për inicim të procedurave nga Njësia e Kërkesës, janë bërë zhvillimi i procedurave të prokurimit për 5 (pesë) aktivitete të parapara sipas Planifikimit të Prokurimit për vitin 2016, aktivitete këto të cilat kanë rezultuar me nënshkrim të kontratave të cilat janë implementuar ose janë në implementim e sipër.

Katër nga këto aktivitete janë kryer me procedurë të hapur (Kuotim i Çmimit), ndërsa një aktivitet është kryer me procedurë Ftesë për kuotim të çmimit me vlerë minimale.

Vlera totale për të gjitha këto kontrata të planifikuara të cilat janë nënshkruar arrin shifrën 12,566.05 €, ndërsa vlera e përafërt e planifikuar për këto kontrata ka qenë 21,500.00 €. Vlera e mjetëve të kursyera përmes zhvillimit të procedurave të prokurimit arrin shifrën 8,933.95 € ose 41.55 % e mjetëve buxhetore të planifikuara.

Ndërsa pas hyrjes në fuqi të Nenit 21A të Ligjit 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092, ne



si Autoritet Kontraktues kemi vazhduar që të bëjmë përgatitjen dhe kompletimin e kërkesave me dokumentacionin përcjellës për të kërkuar nga AQP zhvillimin e procedurave tjera sipas Planifikimit të Prokurimit dhe kërkesave të pranuar nga Njësia e Kërkesës sipas nevojave të ARH-së.

Si kërkesa të dërguara në AQP për zhvillim të procedurave të prokurimit për nevojat e ARH-së kanë qenë gjithsejtë nëntë (9) kërkesa, ndërsa të realizuara nga AQP janë katër (4) aktivitete që kanë rezultuar me kontratë, dy aktivitete janë zhvilluar, por në mungesë të ofertave nuk kanë rezultuar me nënshkrim të kontratës, kurse tri aktivitete tjera nuk janë zhvilluar fare nga AQP.

Vlera e përafërt e mjeteve të planifikuara për aktivitetet e realizuara që kanë rezultuar me kontratë ka qenë 24,940.00 €, ndërsa vlera totale e kontratave për të gjitha këto kontrata ka qenë 20,098.82€

- Përgatitja e Planifikimit Preliminar të Prokurimit për vitin Fiskal 2017
- Përgatitja e Raportit për kontratat e nënshkruara publike gjatë vitit 2016
- Lëshimi i Urdhër Blerjeve të nevojshme për të gjitha mallrat dhe shërbimet sipas përgjegjësisë në bazë të Ligjit për Prokurimin Publik

6.8.3. Aktivitetet tjera në kuadër të përgjegjësisë dhe për institucionin e ARH-së

6.8.3.1. Komunikimi me publikun dhe qasja në dokumente publike

Në kuadër të përgjegjësisë, punëve dhe detyrave të përcaktuara me ligj në Divizionin e Prokurimit, me vendim të Drejtorit të Përgjithshëm të ARH-së më është ngarkuar detyra shtesë si Zyrtar Përgjegjës për Marrëdhënie me Publikun dhe për Qasje në Dokumente Publike, ku sipas përgjegjësisë së caktuar jemi angazhuar edhe në kryerjen e punëve apo detyrave shtesë si në vijim:

Me qëllim të planifikimit dhe koordinimit të Komunikimit me Publikun përmes bashkërendimit të planeve të komunikimit me planin vjetor të punës së Departamenteve të ARH-së, zbatimit të plotë të Ligjit nr. 03/L-215, për Qasje në Dokumente Publike dhe Rregullores Nr. 03/2011 – Për shërbimin e komunikimit qeveritar me publikun, Autoriteti Rregullativ i Hekurudhave është i hapur, transparente dhe me gatishmëri për bashkëpunim me çdo mekanizëm, institucion



apo organizatë që për qëllim ka ngritjen e nivelit të përgjegjësisë në Institucionet Publike.

6.8.3.2. Detyrat dhe përgjegjësitë

- Planifikimi dhe koordinimi i Komunikimit me Publikun i ARH-së përmes bashkërendimit të planeve të komunikimit me planin vjetor të punës së Departamenteve të ARH-së;
- Informimi i publikut lidhur me punën dhe vendimet e ARH-së, përmes zhvillimit të marrëdhënieve me mediet, si dhe organizimit të konferencave për shtyp, njoftimeve dhe intervistave në mediet;
- Përgatitja e materialeve të shkruara dhe elektronike për botim dhe shpërndarje që njoftojnë publikun për aktivitete të ARH-së;
 - Ofrimi i raportimit të sakte medieve nga takimet e Bordit Mbikëqyrës dhe Drejtorit të Përgjithshëm me delegacione të ndryshme brenda dhe jashtë vendit;
 - Përditësimi i ueb faqes së ARH-së dhe publikimi i materialeve sipas nevojës;
 - Pranimi i kërkesave për qasje në dokumentet publike nga personat fizik dhe juridik (kërkuesit) si dhe trajtimi apo shqyrtimi i tyre në bazë të Ligjit për Qasje në Dokumentet Publike Nr. 03/L215;
 - Përgatitja e raporteve të rregullta në baza mujore, 3 mujore dhe vjetore lidhur me kërkesat për qasje në dokumente publike dhe dërgimi i tyre në njësinë përkatëse të Qeverisë së Kosovës/Zyra e Kryeministrit, të cilat përgatit raportin gjithëpërfshirës të institucioneve publike për realizimin e së drejtës për qasje në dokumente publike;

Me qëllim të implementimit të Ligjit për Qasje në Dokumente Publike, ne si ARH i jemi përgjegjës në formën më të mirë të mundshme dhe në harmoni të plotë me ligjin çdo kërkesë që kemi pranuar për qasje në dokumente publike. Marrë për bazë natyrën e veprimtarisë profesionale të ARH-së si dhe kufizimet buxhetore, ne si institucion nuk kemi pas mundësi të bëjmë organizimin e ndonjë aktiviteti i cili ndërlihet direkt me zbatueshmërinë dhe implementimin e Ligjit për Qasje në Dokumente Publike. Me qëllim të rritjes së transparencës dhe për ta bërë më të lehtë komunikimin me publikun ARH ka të caktuar Zyrtarin Përgjegjës për Komunikim me Publikun dhe Qasje në Dokumente Publike, ka ueb faqen zyrtare funksionale në të cilën paraqiten të gjitha aktivitetet e ARH-së, raportet vjetore si



dhe janë të publikuara informata me interes publik të cilat e orientojnë publikun për të drejtat e tij dhe mënyrën për qasje në dokumente publike/zyrtare. Gjithashtu në ueb faqe kemi të publikuara edhe të dhënat e zyrtarit përgjegjës për Komunikim me Publikun dhe për Qasje në Dokumente Publike.

Si institucion nuk kemi pas ndonjë njoftim apo ftesë për pjesëmarrje në ndonjë takim, tubim apo organizim që promovon të drejtën për Qasje në Dokumente Publike dhe implementimin e Ligjit për Qasje në Dokumente Publike.

Natyrisht se sikur në çdo fushë tjetër edhe në këtë fushë ka sfida të ndryshme të cilat paraqiten gjatë implementimit të Ligjit për Qasje në Dokumente Publike, por me një koordinim më të mirë ndërinstitutional dhe me një angazhim më të madh të institucioneve relevante konsideroj se do të tejkaloheshin edhe sfidat të cilat paraqiten gjatë implementimit të Ligjit për Qasje në Dokumente Publike.

Pjesa II: Të dhënat lidhur me kërkesat

Tabela 1: Numri i kërkesave të pranuara

Numri i kërkesave të pranuara			
Numri total	Qasja e lejuar	E refuzuar	E pjesshme
3	2	0	1

Tabela 2: Qasja e lejuar

Qasja e lejuar	Numri
Në afat, sipas ligjit	3
Me pagesë	0
Pa pagesë	3

Tabela 3: Qasja e kufizuar

Qasja e refuzuar	Numri
E plotë	0
E pjesshme	1
Pa përgjigje	0

Tabela 4: Kërkesat për rishqyrtim

Kërkesat për rishqyrtim	Numri
Numri total i rishqyrtimeve	1
E lejuar	0
E refuzuar	1
E pjesshme	0

Numri i aktvendimeve të lëshuara për refuzim: 1

Tabela 5: Refuzimet dhe qasjet e kufizuara

Refuzimet dhe qasjet e kufizuara	Numri
1. Përjashtimet nga neni 12 : (specifikoni cila pikë, nga lista e mëposhtme)	
1.1. sigurisë kombëtare, mbrojtjes dhe marrëdhënieve ndërkombëtare;	
1.2. sigurisë publike;	
1.3. parandalimit, hulumtimit dhe ndjekjes së aktiviteteve penale;	
1.4. hulumtimeve disiplinore;	
1.5. inspektimit, kontrollimit dhe mbikëqyrjes nga institucionet publike;	
1.6. privatësisë dhe interesave të tjerë legjitim privat;	x
1.7. interesave komerciale dhe të tjera ekonomike;	x
1.8. politikave ekonomike, monetare dhe këmbimore të shtetit;	
1.9. barazisë së palëve në procedura gjyqësore dhe administrimin efikas të drejtësisë;	
1.10. mjedisit, apo,	
1.11. diskutimeve brenda apo ndërmjet institucioneve publike lidhur me shqyrtimin e ndonjë çështjeje.	
2. Neni 10. (Pa përgjigje)	
3. Dokumentet e klasifikuara	
4. Të dhënat personale, sipas Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale	
5. Arsye tjera të refuzimeve, (ju lutem specifikoni)	



Raportimi rreth adresimit të rekomandimeve të zyrës së auditorit të përgjithshëm

Zyra e Auditorit të Përgjithshëm (ZAP) ka kryer auditimin e pasqyrave vjetore financiare të ARH-së për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2015. Ky auditim është fokusuar në pasqyrat vjetore financiare, menaxhimin financiar dhe kontrollin e brendshëm.

Në qershor të vitit 2016 ka publikuar Raportin e Auditimit (nr. dokumenti 24.22.1-2015-08) për pasqyrat financiare të ARH-së për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2015. ZAP si konkluzion të përgjithshëm ka paraqit se disa aspekte të qeverisjes brenda ARH-së mund të përmirësohen, veçanërisht në lidhje me menaxhimin e rrezikut dhe cilësinë e raportimit menaxherial.

Shtojcat

SHTOJCË I

Korniza ligjore e BE-së e aplikueshme për sektorin e Hekurudhave

Licencimi:

- Direktiva e BE-së 91/440 për Zhvillimin e Hekurudhave të BE-së,
- Direktiva e BE-së 95/18 për Licencimin e Ndërmarrjeve Hekurudhore,
- Direktiva e BE-së 2007/59 për Licencimin dhe Certifikimin e Makinistëve.

Siguria:

- Direktiva e BE-së 2004/49 për Sigurinë e Hekurudhave,
- Rregullorja e BE-së 653/2017 për Procedurat e Marrjes së Certifikatës së Sigurisë.

Rregullimi i Tregut:

- Direktiva e BE-së 2011/14 për Çmimet dhe Qasjen në Binarë,

- Direktiva e BE-së 2012/34 për Krijimin e Hapësirën Unike Evropiane të Transportit Hekurudhor,
- Rregullorja e BE-së 1370/2007 për Kontratën e Shërbimeve Publike.

Interoperabiliteti:

- Direktiva e BE-së 2008/57 për Interaporabilitet,
- Specifikacionet Teknike për Interoperabilitet STI.

Harta e Hekurudhave të Kosovës





Mars, 2016